


Shejkh Muhamed El-Gazali



E Vërteta e Hidhur



المكتبة الإسلامية الألبانية
دار الفتا - مدينة شوشور
KOMITETI MUSKON (SHQIPTAR)
MYFTINIA SHKODER

Muhamed El-Gazali

€ VËRTETA € HIDHUR



الجمعية الإسلامية الأمامية
دار الإفتاء - مدينة شوش
Kongresi Mullahan i Shqipërisë
MYFTINIA SHKODËR

Titulli në arabisht:

El-Hakk el-mur'r

Autor:

Muhammed El-Gazali

E Vërteta e Hidhur

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

Redaktor:

Edlira Boriçi

Design & Kopertina

L.Hamja

Boton:

Myftinia Shkodër

ISBN 978-99943-50-76-6

Sh.B.Arbëria

Shkodër, Mars - 2014

"Është detyrë e myslimanit të jetojë në vendin e tij sipas parimeve të fesë dhe ta ndërtojë shoqërinë sipas kontureve, të cilat ia paraqet Islami për ndërtimin e jetës së përgjithshme.

Islami nuk është vetëm besim (akide), ai është besim dhe sheriat (legjislacion)!

Nuk është vetëm adhurim, ai është adhurim dhe ndërveprim.

Nuk është vetëm bindje personale, ai është sistem shoqëror krahas së cilit është edhe besimi individual.

Ai është, ashtu si është e përhapur shprehja: "Din dhe Davlet" (Fe dhe shtet)".

PËRMBAJTJA

• Parathënia	6
1. Të kuptuarit e Kur'anit	9
2. Dynjaja që i shërben të vërtetës është fe	12
3. A ka kontradiktë mes Kur'anit dhe Sunetit?	15
4. Nijeti i singertë	23
5. Zemrat e mëdha	27
6. Rreziku i ndryshimeve dytësore	30
7. Hadithi i dobët	33
8. Vendi i gruas në Islam	38
9. Trullosja në debat të zë mendjen dhe fenë	41
10. Rreth fytyrës së femrës	44
11. Rrëshqitja në debat dhe përçarja e auditorit	47
12. Përçarja	50
13. Nevoja jonë për bashkëpunim dhe vëllazërim	54
14. Allahu i do punët e larta	57
15. Sëmundjet e zemrës	60
16. Vlera e burrave dhe e popujve	63
17. Refuzoj muzikën	66
18. Guximi i atyre që sulmojnë selefët	69

19. Edukata ndaj dijetarëve	72
20. Konceptim i rremë për Islamin	75
21. Dituria e rreme lëkund ymetin dhe i shërben kolonizatorit	78
22. Fillimi i muajve hënorë	85
23. A do të mësojnë ndonjëherë thirrësit?!	88
24. Duhet ushtri prej thirrësish	91
25. Si pësuan disfatë arabët	94
26. Përse e urrejnë shtetin islam	96
27. A janë fetarë njerëz të tillë?	99
28. Fjalëshumë për Islamin pa punë frutdhënëse	102
29. Akoma në gjumë prej sëmundjes	105
30. Njerëz pa dinjitet...	109
31. Nuk është përhapur e kota, përveç se në mungesë të së vërtetës	112
32. Një vështrim i zgjuar rreth haditheve të trazirave	115
33. Rrethi i shpëtimit	118
34. Kërkesat e besimit	122
35. A ka pendesë?	125
36. Pasuria është pjesë e shëndetit	128
37. Këshillë e sinqertë	131
• Thënie të Shejkh Muhamed El-Gazali	134

PARATHËNIA

Këto janë disa fjalë të shkurtra, apo shkëndija të shpejta që përmbajnë çështje dhe dispozita, të cilat mund të jenë ndreqje të një gabimi të përhapur. Ringjallje të një të vërtete të braktisur, koment i një ngjarje historike, apo bashkëkohore, pohim i një ideje të vyer, ose nxitje të energjive drejt një qëllimi të ndershëm.

Mendja besimtare është observator kuptimi që mbledh çdo gjë që prek Islamin, qoftë nga afër apo nga larg.

Ashtu siç ekzistojnë matës të fuqisë së tërmeteve, gradës së nxehtësisë, lagështisë dhe ndotjes, në një mënyrë të tillë janë edhe të interesuarit për çështjet e Islamit, të cilët vrojtojnë ato çfarë prekin vërtetësinë e mesazhit, rrugëtimin e thirrjes, problemet e ymetit të tij, faktorët e shtrirjes e të tkurrjes, të zgjimit e të hutimit dhe në fund paraqesin një përlllogaritje të saktë të asaj që kanë vrojtuar.

Kjo përlllogaritje është rreze për rrugën dhe sqarim për ata, të cilët nuk i kanë të qartë gjërat. Kjo mund të kërkojë libra të tërë të shkruar, por ne këtu u mjaftuam me disa shkëndija të shpejta duke u bazuar në ndikimin e atyre që tërheqin vëmendjen dhe lëvizjen e lexuesve.

Dihet që lexuesi i sotëm zakonisht mjaftohet me pëlqimin e artikujve të shkurtër, krahas atyre të gjatë, apo shumë të gjatë. Kryesorja është që ta shfrytëzojmë këtë dëshirë për të vendosur te lexuesi në mënyrë të shpejtë, fakte nxitëse dhe udhëzime serioze.

Nga këtu them se, fjala jonë me tematika të ndryshme që frymëzohet nga rreshtat e realitetit dhe mbështetet në nxitjen e vetëdijes së fshehur, në zemrat e besimtarëve është mjaftuese të jetë dritë e vetëtimës që çan errësirën dhe ndriçon rrugën.

Këto janë fjalë të shkurtra, por janë çelësa të shkëndijave të shumta për njerëzit xhelozë të fesë dhe të ymetit të tyre. Nganjëherë trajtojnë tema të besimit, të moralit, të historisë dhe të fikhut (jurisprudencës) dhe nganjëherë zhyten në realitetin tonë të gjallë për t'i vënë në lëvizje punëtorët e rrugës së Allahut, për të vendosur të drejtën dhe për të shkatërruar të shtrembrën.

Në kohën e sotme populli mysliman ka nevojë për këto gërshetime, sepse ngjarjet e tyre edhe pse kanë kaluar, ato sërish përsëriten me kalimin e kohës deri në atë mënyrë sa që ato, të cilat i lind e nesërmja janë pamje të së djeshmes. Mendo pak rreth këtij ajeti: "Kështu kanë thënë edhe ata që ishin përpara tyre, të njëjtën gjë sikur ata. Zemrat janë bërë identike. Ne i kemi qartësuar argumentet për popullin që është i vendosur."¹

Në këtë rrugë kam pasuar Ibn Xhevziun, sepse libri i tij "Sajdul Khatir" përmban shkrime të shkurtra, por ato janë shumë të dobishme, madje ndoshta janë më të mira se sa temat e gjata.

Unë në këtë libërth kam mbledhur tema të ndryshme

1. Bekare: 118

nën titullin “E Vërteta e Hidhur”², të cilat m’i botonte revista “El-Muslimun” që dilte në Londër.

Duke parë se një pjesë e madhe e lexuesve nuk u mbërrinin këto numra reviste, me gjithë dëshirën e madhe të tyre për t’i lexuar, si edhe vetë interesi im islam, vendosa t’i bashkoj në një vend të vetëm.

Një mendim kalimthi mund të jetë më i qëndrueshëm duke parë rëndësinë e tij në heqjen e pengesave, rizgjimën që lë, dyshimin që fshin dhe udhëzimin që ngulitë.

Fjala jonë, me mbarësinë e Allahut, do të mbesë shkëndijë që vetëton me iman dhe avokate e hakut (së vërtetës).

Allahu e di qëllimin tonë.

Muhamed El-Gazali

2.Libri “E Vërteta e Hidhur” i autorit Muhamed El-Gazali ka gjashtë vëllime në gjuhën arabe. Në këtë përkthim kam sjellë vetëm disa tema nga vëllimi I, II dhe III, të cilat kam menduar se janë më të dobishme dhe më të përputhshme me realitetin shqiptar. Lexuesi i këtyre rreshtave gjatë leximit do të vërë re vërtetësinë dhe sinqeritetin e autorit në ato çfarë ka shkruar, të cilat edhe pse datojnë në vite më përpara, janë akoma aktuale pasi autori sjellë realen, të cilën e ka mësuar nga praktika e fjalës së Allahut (xh.sh) dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij (a.s). (L.Hamja)

TË KUPTUARIT E KUR'ANIT

Të lexuarit pa e kuptuar është një sëmundje që i ka goditur myslimanët që herët, duke e bërë lidhjen e tyre me shpalljen hyjnore sipërfaqësore dhe të padobishme. Ata mjaftohen me leximin e ajeteve dhe dëgjimin e tyre. Nganjëherë nëpër mendjen e tyre ndizet ndonjë shkëndijë udhëzimi, pastaj ato fiken shpejt, herë-herë dhe ngadalë, pa e mbushur shpirtin me bukuri.

Njerëzit e thjeshtë mendojnë se leximi i Kur'anit shkronjë për shkronjë ka fshehtësinë e vet dhe është i mjaftueshëm për t'u kuptuar dhe nuk ka nevojë për ta menduar. Më tërhoqi vëmendjen një sure, që zakonisht lexohet për të vdekurit, ose atyre që janë duke vdekur dhe në këtë sure gjenden dy ajete të tilla:

"Ai nuk është tjetër, përveç se përmendje dhe Kur'an i qartë. Për t'ia tërhequr vëmendjen atyre që janë të gjallë dhe të bëhet fjala realitet për ata që nuk kanë besuar." (Jasin: 69-70)

Ashtu sikurse Allahu i Madhëruar i përshkruan robërit e Tij fatmirë që i përkasin Atij, duke u thënë pas disa përshkrimeve të larta: "Dhe, ata të cilët kur iu përkujtohen ajetet e Zotit të tyre nuk i kalojnë ato si të shurdhër dhe të

verbër." (Furkanë: 73)

Dëgjimi pa kuptuar dhe shikimi pa perceptim janë sëmundje që fshijnë dhuntitë e njeriut dhe e bëjnë atë fantazmë pa shpirt. Dhe, fantazmat nuk bëjnë asgjë në botën njerëzore, me to asnjë popull i botës së tretë nuk përparon për në botën e dytë dhe as që mundet për në të parën...

Përmes ajeteve të shumta kur'anore kam ndjekur fjalën "lexim – tilave" dhe kam gjetur se ajo do të thotë shpalosje e "Mesazhit të fundit", sqarim i mësimëve të saj në përgjithësi dhe dhënie e një pamjeje të përgjithshme të çështjeve dhe qëllimeve. Pra, siç quhet ndryshe në kohën tonë, manual i lëvizjeve, apo metodë pune. Pastaj, pas kësaj vjen studimi, kuptimi dhe mësimi.

Allahu i Madhëruar thotë: "Kështu, Ne të dërguam ty në një popull, përpara të cilit kanë kaluar shumë popuj të tjerë për t'ua lexuar atyre atë, të cilën Ne ta shpallëm ty." (Rad: 30)

Gjithashtu thotë, nga goja e të Dërguarit të Tij: "Me të vërtetë jam urdhëruar të adhuroj Zotin e këtij vendi, të cilin e ka bërë të shenjtë dhe Atij i takon çdo gjë dhe jam urdhëruar të jem prej myslimanëve. Dhe, të lexoj Kur'anin ..." (Neml: 91-92).

Ajetet janë të shumta, të cilat tregojnë se "leximi – tilaveja" është çelësi i informimit të asaj të vërtete dhe drite që Allahu ka vendosur në Librin e Tij. Prandaj, si mund të kthehet leximi i Kur'anit në artikulum dhe melodi fjalësh së bashku me mungesën e perceptimit?

Patjetër që është e vërtetë se fjalët e Kur'anit kanë shenjtërinë e tyre. Kjo sepse Allahu i Madhëruar ka dëshiruar ta mbrojë Kur'anin nga ajo që i ka goditur librat

e mëparshëm, ku si shkak i neglizhencës ndaj përmbajtjes, duke e transmetuar atë sipas kuptimit, jo fjalë për fjalë dhe të përkthyer, ata e humbën gjithë të vërtetën, në formë dhe në përmbajtje, duke mos mbetur asgjë prej trashëgimisë së Pejgamberëve të mëparshëm, që të vërtetojë titullin e shpalljes.

Për këtë arsye, rëndësia e fjalëve të Kur'anit ka qenë shumë e madhe, duke e bërë leximin e tyre adhurim të shpërblyer. Por, kjo gjë nuk e ndryshon situatën. Edhe gurët e çmuar vendosen në kutia të shtrenjta duke treguar shumë kujdes ndaj tyre, por a vlen ndonjë gjë kutia bosh, së cilës i është vjedhur guri i çmuar?! Dhe, a përfitohet prej Kur'anit në qoftë se zbukurohen shkronjat e tij dhe harrohet kuptimi?! Shejtani ta ka vjedhur mendjen ty, ndërkohe që ti je duke lexuar...

"A nuk po e kuptojnë Kur'anin, apo dryna ka në zemrat e tyre?!" (Muhammed: 24)

DYNJAJA QË I SHËRBEN TË VËRTETËS ËSHTË FE

Çfarë do të thotë të preferosh ahiretin ndaj dynjasë? Me këtë pyetje materialistët dhe skllëvërit e jetës tallen, të cilët zgjohen dhe ngrysen e nuk njohin, vetëm se ditën e tyre dhe të nesërmen që do të gdhijë. Kështu që ata përgjigjen "Nuk e ndërroj të prekshmen me imagjinatën dhe e refuzoj meditimn, përveç në tokë dhe ç'ka mbi të".

Kjo përgjigje, për njerëzit e mendjes është e gabuar dhe nuk ka përfundim për të zotin e saj, vetëm se rënie.

Ka edhe ndonjë përgjigje tjetër, e cila për njerëzit duket e saktë, ose siç njihet ndryshe përgjigjja e gjithë besimtarëve që thonë "Jeta e dynjasë është e përbuzur dhe duhet të largohemi prej saj, ashtu siç del shigjeta, për në vendbanimin tonë në xhenetet e Adnit."

Dua të qëndroj gjatë te kjo përgjigje. Çfarë do të thotë ta kalosh jetën pa u lartësuar me diçka prej saj? Krijuesi i kësaj bote ka thënë "Njihni Emrat e Mi të Bukur dhe Cilësitë e Mija të Larta në përbërjen e vendit e të kohës dhe në rrugëtimin e jetës dhe të njerëzve. Ju nuk do ta njihni Madhëstlinë Time në qoftë se ecni nga djepi gjer në varr të verbër ndaj argumenteve të Mia në tokë e në qiell dhe ndaj kadereve (përcaktimeve) në njerëz dhe popuj."

Ai është betuar në diell dhe në hënë, në natë dhe në ditë, në agim dhe në muzg, në fëmijë dhe në prind. Madje është betuar në atë që shikojmë dhe në atë që nuk e shikojmë, sepse shikimi në sipërfaqe nuk të bën dobi pa të shikuarit në thellësi. Është betuar në erërat e forta dhe të lehta, në kuajt luftarakë që nxjerrin shkëndija nga patkonjtë e tyre në betejat e përjetshme mes të drejtës dhe të kotës. Është betuar në të gjitha këto, që ta njohim Atë dhe të jetojmë në krenari e të përfitojmë nga mësimet e Tij.

Si mund të thonë "Unë jam njohës i Allahut, ai që është injorant i jetës, i të fshehtave, i fuqive dhe i thellësive të saj?!"

Disa njerëz e kalojnë jetën ashtu siç kalon pastruesi i rrugëve përpara dyqaneve të floririt, pa i hedhur sytë nga stolitë dhe bizhutë e shndritshme, pasi nuk i interesojnë ato sende, ose siç kalon punëtori me mëditje nëpër arat e mbjella e të mbushura me prodhim dhe fruta plot, që nuk mendon përveç se të marrë vetëm mëditjen e tij.

Kur mohuesit e ringjalljes pyetën "Si do të ndodhë ringjallja?" Erdhi përgjigjja e Kur'anit famëlartë në këtë mënyrë: "A nuk e kanë parë se si Allahu e fillon krijimin, pastaj e rikthen atë? Me të vërtetë kjo për Allahun është e lehtë. Thuaj: "Ecni nëpër tokë dhe shikoni se si ka filluar krijimi, pastaj Allahu e krijon jetën e ringjalljes." Me të vërtetë Allahu për çdo gjë ka fuqi."³

Ecja nëpër tokë për studimin e jetës është rruga e besimit në Allah dhe takimit me Të. Patjetër duhet të notojmë në dallgët e jetës dhe të njihemi me rrymat e saj, baticën e zbaticën, me brigjet dhe shkaqet e mbytjes e të shpëtimit...

Trashësia nuk është besim dhe injoranca nuk është

3. Sureja Ankebutë: 20

devotshmëri. Eksperienca në jetë, aftësia për ta zotëruar atë dhe nënshtrimi i saj në shërbim të Zotit, është besim dhe punë e devotshme.

Sa e ultë është mendja e mpitë, mendimi i ngushtë dhe kultura e cektë. Ka popuj, të cilët i përkasin Kur'anit dhe nuk e dinë se ai është libër jete, nuk përfitojnë prej universit, përveç ashtu siç përfiton i verbëri nga rrezet e diellit. Sa herë që njerëz të tillë i kam takuar në fushat e thirrjes më ngushtohet fryma dhe më vinte keq për fenë dhe të ardhmen e saj, kjo për shkak të injorancës së tyre të thellë, apo asketizmit të tyre të ftohtë.

Thashë: "Do të ketë pasur një arsye që dëshmitarët e Njësimi të Allahut të jenë engjëjt dhe njerëzit e ditur".⁴

4. Shiko ajetin 18 të sures Ali Imran (L.H)

A KA KONTRADIKTË MES KUR'ANIT DHE SUNETIT?

A ka kontradiktë mes Kur'anit dhe Sunetit? Kemi lexuar disa hadithe të cilat tregojnë se Islami thërret për vrasjen e njerëzve në qoftë se ata nuk bëhen myslimanë, duke ditur se Kur'ani thotë: "Nuk ka dhunë (imponim) në fe". Në disa hadithe përmendet se varfëria është e lavdëruar, ndërsa pasuria është e përçmuar. Si t'i kuptojmë këto hadithe me kuptimin e ndryshëm të Kur'anit?⁵

Bismilahi Rrahmani-Rrahim

Falënderimi i takon Allahut, pagja dhe bekimi qoftë mbi të dërguarin e Tij, Muhammedin (a.s)

Fillimisht dua të them që nuk ka kontradiktë mes Kur'anit dhe Sunetit, sepse Suneti është plotësues dhe sqarues (komentues) i Kur'anit. Të dy janë shpallje prej Allahut (xh. sh). Kush dëshiron të kuptojë Kur'anin dhe Sunetin, patjetër duhet të zotërojë bagazh të mjaftueshëm të urtësisë kur'anore, shije artistike dhe njohuri të thella rreth natyrës njerëzore, dukurive të shoqërive dhe studime të thella për

5. http://www.islamonline.net/servlet/Satellite?pagename=IslamOnline-Arabic-Ask_Scholar/FatëaA/FatëaA&cid=1122528616540

Sunetin e pastër, sepse nuk mjafton në këtë drejtim vetëm leximi i një libri apo mësimi përmendësh i disa haditheve.

Fetvaja (përgjigjja) e Shejkh Muhammed El-Gazaliut

Asnjëherë nuk mund të ketë kontradiktë mes hadithit (Sunetit) dhe Kur'anit. Ajo që për momentin duket si një kontradiktë, vjen nga fakti i moskuptimit të saktë dhe jo prej asaj që është e vërtetë. Kjo si p.sh. te hadithi: "Nuk do të hyjë në xhenet askush me punën e tij" dhe fjala e Allahut në Kur'an: "Hyni në xhenet për atë që ju keni punuar" (Nahl: 32).

Kuptimi i saktë i gjithë kësaj çështjeje është se patjetër njeriu duhet që të punojë për të kënaqur Zotin dhe për të merituar mëshirën e Tij. Xheneti nuk është për përtacët dhe njerëzit e ultë. Puna e çdo njeriu duhet të jetë e shoqëruar me modestinë ndaj Allahut (xh.sh), si dhe me mohimin e egos së tij. Përpara Zotit të botrave nuk mund të fshihet asnjë e metë e njeriut.

Në këtë mënyrë ai që punon thjesht sa për të paraqitur punën e tij dhe në të njëjtën kohë është mendjemadh, nuk mund të pretendojë xhenetin nga Allahu (xh.sh). Ky njeri është i mashtruar dhe prej tij nuk pranohet asgjë, prandaj nuk mund të hyjë në xhenet.

Ndërsa ai që vjen me frikë, me respekt, i nënshtrohet dhe ndjen pafuqinë e tij përpara Krijuesit, ai po, e meriton xhenetin. Argumentet për këtë gjë janë të shumtë dhe nuk i kupton kush vetëm njerëzit e ditur.

Suneti është një det me valë të ndryshme dhe nuk e kupton kush atë, përveç se ai që është ekspert, i cili arrin të kuptojë të gjitha nënkuptimet dhe kuptimin e vërtetë që

ka pasur për qëllim të transmetojë. Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të), qëndroi duke u folur njerëzve për rreth 23 vite me rradhë, gjatë së cilës u përball me situata, njerëz dhe çështje të ndryshme.

Të përdoret një hadith (sunset) për atë qëllim dhe situatë që është transmetuar është çështje e fukahave (ekspertëve), sepse në të kundërt i ndryshohet drejtimi i kuptimit të fjalëve të Pejgamberit (a.s).

Ajo që të hidhëron është se disa njerëz që nuk kuptojnë (nuk janë ekspertë) e ngarkojnë veten me gjëra që nuk dinë t'i bëjnë, si interpretimi i gabuar i suneteve dhe fetvave me të. Ata tashmë bëhen pengesa më e ngurtë në rrugën e Thirrjes Islame.

Disa prej tyre kuptuan se Islami nxit luftën dhe i kap njerëzit në befasi pa u bërë thirrje për në fe.

Disa kuptuan se e ardhmja e Islamit është në humbje, sepse çdo ditë që vjen është më e keqe se ajo që ka kaluar.

Disa kuptuan se pasuria është e kundërta e devotshmërisë, se varfëria është motra e bindjes dhe rruga e ahiretit.

Dhe disa të tjerë kuptuan se kaderi është shndërrim i imponuar për njeriun nga rruga e suksesit për në rrugën e humbjes (dështimit), ose e kundërta, se dituria hyjnore i ka paraprirë kësaj gjëje!

Shkaku i gjithë kësaj rastësie (të paqëllimshme) vjen nga studimi i tyre mbi Sunetin, pa patur bagazhin e duhur të urtësisë kur'anore. Arsye të tjera, të cilat lidhen me këtë rastësi janë gjithashtu moszotërimi i shijes artistike të letërsisë arabe, mosnjohja në hollësi të natyrës, dukurive, tipareve njerëzore, apo edhe të vetë shoqërisë njerëzore. Një tjetër arsye është mosdallimi mes asaj që është zakon

(adet) dhe asaj që është adhurim (ibadet), si dhe mos studimi me hollësi të historisë së Pejgamberit (a.s), ku gjatë një çerek shekulli pati shumë ngjarje të mëdha e të hidhura.

Ajo që unë mendoj është se Suneti është shtylla e Islamit pas Kur'anit, por nuk duhet të punojë kush në këtë fushë, përveç fukahave (ekspertëve) dhe atyre të cilëve u nevojitet kjo fushë, siç mund të përmendim: drejtuesit, gjykatësit, thirrësit islam dhe specialistët në çdo fushë qofshin ata, të cilëve u nevojitet të hyjnë në të tilla hollësira. Ndërsa njeriut kalimtar, apo njeriut të zakonshëm, u mjaftojnë dyzet hadithe për t'i ditur dhe zbatuar. Sidoqoftë nuk lejohet për një njeri që nuk e njeh Kur'anin t'u flasë apo t'u japë fetva njerëzve për çështjet e tyre!

Ne i marrim dhe i mbështesim shtyllat e Besimit, të Islamit, moralit dhe ndërtimin e marrëdhënieve mes njerëzve nga Kur'ani dhe Suneti së bashku. Suneti i vepruar (ameli), i cili na është transmetuar me rrugë të përcaktuar (kat'ij), është komentim bindës (i saktë dhe i sigurtë) për vetë Kur'anin. Duke u nisur nga ky parim ne falim pesë kohët e namazit, kryejmë haxhin dhe njohim mënyrën e kryerjes dhe të veprimit të këtyre obligimeve përmes Sunetit të vepruar (ameli). Ka shumë dispozita dytësore për të cilat ka konsensus të fukahave (ekspertëve) dhe nuk ka asnjë besimtar që të dalë prej këtij konsensusi.

Ndërsa ku nuk ka konsensus (ka mendime të ndryshme), çështja ka hapësirë të mjaftueshme për secilin mysliman, që të marrë atë mendim që i pëlqen pa u qortuar për zgjedhjen e bërë.

Fukahatë (ekspertët) kanë thënë se: "Suneti meshhur" (Suneti që njihet në masë prej njerëzve) specifikon përgjithësimin kur'anor. Kështu, fëmijët trashëgojnë nga

baballarët e tyre me anë të këtij ajeti kur'anor: "All-llahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimisë) fëmijët tuaj: për mashkullin pjesë sa për dy femra" (Nisa'ë: 11). Në Sunet është transmetuar se në qoftë se djali vret babain, ai nuk trashëgon prej babait të vrarë, ashtu siç ka ardhur përsëri në sunet se mosbesimtari nuk trashëgon nga babai i tij besimtar.

Gjithashtu Suneti ka kufizuar ajetin e Kur'anit Famëlartë i cili ishte i pakufizuar. Ajeti në fjalë ndalon (e konsideron të njëjtë në ndalim) nënën e qumështit sikur nënën biologjike, kështu edhe për motrat biologjike dhe ato të qumështit. Allahu (xh.sh) thotë në Kur'an: "U janë ndaluar juve (të martoheni me): ...nënat tuaja që ju kanë dhënë gjë, motrat nga gjiri,..." (Nisa'ë: 23)

Ndërsa në Sunet ka ardhur se kjo nuk ka kuptimin e pakufizimit, kështu që një gjidhënie, ose dy nuk të ndalojnë, madje disa dijetarë janë të mendimit se më pak se pesë gjidhënie nuk të ndalojnë. Imam Ebu Hanife dhe Imam Maliku janë të mendimit se ndalimi i gjidhënies është i pakufizuar⁶)! Unë anoj nga ajo që amësia nuk formohet prej gjidhënies së shumtë, ndërsa ajo që ka ardhur në Sunet, se kufiri minimal për këtë çështje është pesë gjidhënie, ose dhjetë gjidhënie sipas mendimit të disa dijetarëve të tjerë. Ky është një përkufizim i cili meriton vëmendje!

- Në Kur'an thuhet: "...kjo masë e dënimit është jetë për ju..." (Bekare: 179), por Suneti ka sqaruar se nuk dënohet "trungu" për "degën", që do të thotë se, nëse babai vret djalin, ai nuk dënohet me vdekje. Shkaku është se kjo vrasje është përjashtim prej praktikës së baballarëve, të cilët sakrifikojnë jetën për fëmijët e tyre dhe jetojnë duke

6. (pra edhe një gjidhënie e vetme, të ndalon, (sh.p)

u përpjekur që jetën e fëmijëve të tyre ta bëjnë të lumtur.

Kjo vrasje patjetër duhet të jetë shoqëruar me ndonjë arsye, jo për arsye kriminale dhe se është ndodhur nën një presion çmendurie të jashtëzakonshëm.

Malikitë mendojnë se nuk ka "kisas" (dënim me vdekje) për rastin në fjalë, përveçse në qoftë se hetimet zbulojnë se babai është njeri brutal (kafshëror), pa ndjenja dashurie prindërore, i cili ka gjykuar dhe menduar për ndonjë qëllim të ultë. Disa dijetarë janë të mendimit se "kisasi" (dënimi me vdekje) është i anuluar, duke u nisur nga pakufizimi i Sunetit.

Ky specifikim, ose kufizim është komentim i shpalljes rreth qëllimit hyjnor dhe kujt i takon më tepër se sa Pejgamberit (a.s) të komentojë Kur'anin! Kjo nuk quhet kontradiktë (kundërshtim) i Kur'anit, por sqarim dhe qartësim i tij.

Suneti mund të vijë edhe i pavarur duke sjellë dispozita të reja, përveç dispozitave që ka sjellë Kur'ani, por çfarë dëmi ka këtu?

Psh: Një ndër rregullat e abdesit është dhe larja e këmbëve, por në sunet është transmetuar që në situata të caktuara mund të përdoret dhe fshirja mbi meste, gjithashtu në sunet është e ndaluar dhe përdorimi i arit dhe mëndafshit natyror tek burrat, etj.

Studimet e hollësishme tregojnë se dispozitat e vendosura prej Sunetit janë të gjitha brenda hapësirës së Kur'anit Famëlartë dhe argumentimeve të tij të afërta apo të largëta. Unë jam i mendimit se fshirja mbi meste nuk është dispozitë e Sunetit, por ajo është kuptimi i një kiraeti (leximi të Kur'anit) të konfirmuar "femsehu biruusikum ve erxhulikum ilel kabejni" me leximin me "i" (kesre) të "lamit"

duke e lidhur me atë që është përpara saj. Përshkrimi është figurativ, siç thonë dijetarët e shkencës së retorikës, sepse përmendet gjendja duke pasur si qëllim vendin!

Ndërsa ndalimi i arit dhe i mëndafshit natyror, ka ardhur si rezultat për të mbyllur derën e shpërdorimit dhe tepërimit (israfit).

Mendoj se ndalimi për përdorimin e ziles ka ardhur si mbrojtje e shqisë së dëgjimit, sepse për ndryshe nuk ka pengesë për përdorimin e saj si lajmërim (tërheqje vëmendje) në orët me zile, telefona apo të vendosura te kafshët.

Fukahatë (ekspertët) hanefi për këtë çështje kanë mendimin e tyre se obligimi (farzi) dhe ndalimi (harami), patjetër duhet që në konfirmimin e tyre të ketë argument të pakundërshtueshëm (kat'ij). Kuptimi i kësaj është se "haberi vahid" (një lajm ose një hadith) nuk mund të ngrihet në pozicionin e konfirmimit të ndalimit (haramit) apo të obligimit (farzit). Kjo do të thotë që dispozitat ligjore (ahkam sheria) kanë dy më shumë se sa ato për të cilët dijetarët e tjerë kanë vendosur!

Dijetarët thonë: "Vaxhib (detyrë) është ajo gjë për të cilën vepruesi i tij shpërblehet, ndërsa mosvepruesi ndëshkohet. Ndalimi (harami) është e kundërta, vepruesi i tij ndëshkohet, ndërsa mosvepruesi shpërblehet. E pëlqyeshmja (mendubi) vepruesi i saj shpërblehet, ndërsa mosvepruesi nuk ndëshkohet për moskryerjen e saj. E papëlqyeshmja (mekruhu) mosvepruesi i saj shpërblehet, ndërsa vepruesi nuk ndëshkohet për veprimin e saj. E lejueshmja (mubahu), te kjo vepër barazvlerësohet veprimi me mos-veprimin."

Hanefitë janë të mendimit se ajo që është urdhëruar me

“hadith ahad”⁷ (hadith njësh) nuk arrin gradën e obligimit (farzit). Kjo gjë tek ata quhet “vaxhib” (detyrë), urdhërohet të veprohet dhe qortohet mos-veprimi me të. Ajo që është e ndaluar (haram) me anë të “hadithit ahad” (hadith njësh) nuk arrin gradën e ndalimit (haramit-muhar’rem), por madje urdhërohet të mosveprohet dhe qortohet veprimi me të, prej së cilës merret vendimi “kerahijetun tahrimijetun” (e papëlqyer afër ndalimit-haramit).

Këta (hanefitë) e japin këtë vendim për dispozita që Suneti i ka vendosur të veçuar nga Kur’ani, si p.sh ndalimi i veshjes së mëndafshit natyror dhe arit për burrat. Te hanefitë nuk ka obligim (farz) përveç se me argument të pakundërshtueshëm (kat’ij) dhe nuk ka ndalim (haram) përveç se me argument të pakundërshtueshëm (kat’ij). Lajmet (hadithet) “njëshe” (“haberet ahad”) te masa e dijetarëve (xhumhur) konsiderohen si “dhanni ilmij” (jo të pakundërshtueshëm). Disa hanbeli kanë dalur jashtë këtij vendimi dhe transmetohet nga imami i tyre (Imam Ahmed) se këto lajme konsiderohen si të pakundërshtueshme (kat’ije), por ky mendim është i refuzuar.

Allahu e di më së miri.

7. Hadith ahad - hadith i transmetuar nga një person, ose më shumë por që nuk ka të plotësuar kushtet e diturisë së saktë, d.m.th mund të ketë edhe kundërshti. (L.H)

NIJETI I SINQERTË

Zemra e bindur tek Allahu dhe e prehur tek Ai meriton suksesin dhe udhëzimin në rrugën e drejtë. Allahu i Madhëruar thotë: "Kush beson në Allah, ia udhëzon zemrën..."⁸, ndërsa zemra bosh, pa Zotin e saj, e mbushur me epshe rrëshqet në jetë e shkapërderdhur dhe këtë e vërteton edhe fjala e Allahut: "Ata të cilët nuk i besojnë ajetet e Allahut, nuk i udhëzon Allahu..."⁹

Njerëzit e thjeshtë e dinë se "nijeti i sinqertë" e shpëton të zotin e saj prej telasheve të ndryshme dhe se, "nijetin jo të pastër" e shoqëron bredhja dhe hallakatja. Allahu u ka premtuar besimtarëve të devotshëm se atyre do t'u bëjë dritë me të cilën do t'ia ndriçojë udhën, prandaj kush preket prej rrezeve të këtij nuri, në dritë do të ecë gjithmonë për në rrugën e drejtë dhe do të jetë i mbrojtur prej rrëshqitjeve të frikshme "dhe kujt Allahu nuk i bën dritë, ai asnjëherë nuk do të ketë dritë."¹⁰

Pejgamberi (a.s) e ka bërë të qartë se besimtari i mirë ndriçohet nga brendësia e tij, ku thotë: "Devotshmëria është këtu", duke bërë me shenjë nga kraharori i tij, d.m.th se devotshmëria nuk është llafe goje, apo lojë aktrimi dhe as

8. Tegabun: 11

9. Nahl: 104

10. Nur: 40

pretendim pa fund, por ajo është zemër e bindur, e drejtuar tek Allahu dhe e kapur për Të.

Një pjesë e njerëzve dinë ta luajnë mirë imitimin e veprave të mira dhe perfeksionimin e mënyrës së kryerjes së tyre, por ata janë të privuar prej kuptimit dhe ndikimeve të tyre të mira. Shkak për këtë është ashpërsia e zemrës dhe zënia e saj me punë të tjera.

Largohesha shpejt prej atyre njerëzve që në zemra kishin ashpërsi dhe në moralin e tyre kishte vrazhdësi edhe n.q.s dinin të bënë mirë disa farze, detyra, sepse zbukurimi i jashtëm nuk i bën dobi pastërtisë së brendshme dhe ndriçimit të saj.

Duke medituar, ndjej se disa politikanë dhe udhëheqës e adhurojnë vetën e tyre edhe pse shfaqen si adhurues të Zotit. Ndoshta mund të vërtiten rreth këtij pretendimi kur kanë bërë ndonjë punë, por ky qëllim mashtrohet pas gjithë atyre gabimeve të mëdha, bën që barrën e tyre ta paguaj populli.

Ebu Xhehli mund të ishte kthyer me popullin e tij pa e zhytur atë në humbjen e madhe të Bedrit, sepse kjo betejë nuk kishte kuptim, pasi karvani për të cilin kishin dalë ta shpëtonin, kaloi. Animi i Ebu Xhehlit për t'u shfaqur si udhëheqës dhe mburrja për t'u dukur, e bëri atë të thotë se, nuk largohemi pa pirë verë, pa therë devetë dhe pa kënduar e kërcyer valle. Ishte kjo arrogancë, e cila e shtyu atë dhe popullin e tij drejt humbjes.

Pa dyshim që shumë prej cytjeve egoiste pushojnë pas rrugëve ogurzeza dhe vendimeve të përgjakshme. Sikur çdo njeri të përpiquej për rregullimin e brendësisë së tij dhe pastrimin e saj prej sëmundjeve të fshehta, apo prej shirkut të fshehtë siç ka ardhur në disa transmetime, do të kishin

shpëtuar njerëzit dhe shumë toka prej tragjediave të mëdha.

Dihet mirë që Allahu tek njeriu shikon ndërgjegjen, brendësinë dhe jo pamjen e jashtme. Vendi i rob-it përcaktohet dhe varet prej pjesës së fshehtë, dëlirësisë së zemrës dhe sinjeritetit të marrëdhënieve të tij me Zotin: "Apo, atij që Allahu ia ka hapur krahërorin me Islam, ai është në dritë prej Zotit të tij. Mjerë për ata që i kanë zemrat e ashpra në përmendjen e Allahut. Të tillët janë në humbje të qartë."¹¹

Meditova ajetet e mëposhtme për këtë ajet dhe gjeta se ato bënin thirrje për butësinë drithëruese, për ndjenjat mëshironjëse dhe për njeriun që lëviz me frikën e Allahut dhe larg ndikimeve dhe dashurisë së nxitimit: "Allahu zbriti fjalën më të bukur, librin më të përputhshëm e harmonizues, prej të cilit rrënoqethen lëkurat e atyre që i frikësohen Zotit, pastaj lëkurat dhe zemrat e tyre zbuten nga përmendja e Allahut."¹²

M'u kujtuan dy njerëz, të cilët dolën në një duel. Njëri ishte i mprehtë dhe me mendje filozofi, por që ishte egoist lakmitar, ndërsa tjetri që nuk ishte aq i zot, por i qeshur dhe tolerant!

Thashë: "Do të humbë mprehtësia dhe do të tresë filozofia me ngushtimin e zemrës dhe vrazhdësinë. Do të triumfojë modestia me fytyrën e qeshur dhe shtrirjen e dorës, tolerancën."

Në betejën e besimit me mohimin vërej se disa klerikë janë sakrifikues dhe se disa dijetarë janë egoistë, kështu që dëshpërohem prej përfundimit të keq dhe e di se rezultati do të sillet përreth hakut.

11. Zumer: 22

12. Zumer: 23

Feja është gjëja e vetme, e cila qëndron më larg se askush tjetër nga vrazhdësia, ashpërsia, mendjemadhësia dhe lakmia. Këto cilësi sa herë që vihen në kupën e peshores e fundosin atë. Kur mendoj për jetën e Pejgamberit (a.s), shikoj trupëzimin e modestisë dhe bamirësisë, të mëshirës dhe drejtësisë dhe dashurinë e çdo gjëje. Me të vërtetë "Atij i vjen rëndë për gjendjen tuaj dhe kujdeset për ju. Për besimtarët është i butë, i mëshirshëm." Atëherë, a e marrim shembullin e mirë prej njeriut të plotë, për të cilin është thënë: "Me mëshirën prej Allahut u bërë i butë ndaj tyre. E sikur të kishe qenë i ashpër dhe zemër vrazhdë do të ishin larguar prej teje"¹³?

13. Ali Imran: 159

ZEMRAT E MËDHA

Sa e bukur është puna e shoqëruar me gëzim dhe kënaqësi. Njeriu e realizon atë dhe ndihet rehat. Çdo fazë të saj e përcjellë me krahë hapur dhe vështirësitë i tejkalon me vullnet të hekurt. Ndërsa punën e neveritshme, njeriu e kryen me mërzi, e lehta i bëhet e vështirë dhe mezi ç'pret ta mbarojë atë punë.

Kërkuesi i njohurive lexon me dëshirë dhe zemra e mendja i marrin pjesë në kuptim e përfitim, ndërsa i detyruari që mëson pa dëshirë, e hedh librin sikur ai të ishte armik i betuar i tij.

Asnjë punë e madhe nuk plotësohet, përveç në qoftë se është e shoqëruar me dëshirë, sinqeritet dhe qasje të fuqishme, atëherë do të presësh qëndrime heroike dhe do të shikosh triumfin mes vullnetit të fortë dhe qëllimit të largët, duke u bërë realitet thënia e Ebu Tajjibit:

Kur janë të mëdha zemrat,

Trupat lodhen në kërkimin e tyre.

Edukatorë të mëdhenj janë ata, të cilët pas çdo përgjegjësie krijojnë një emocion të sinqertë dhe pas çdo detyre krijojnë një motiv të gjallë.

Allahu (xh.sh) justifikoi për detyrën e hixhretit (emigrimit), të dobëtis prej burrave, grave dhe fëmijët. Çfarë të bëjnë? Nuk mundën të manovrojnë dhe as të udhëtojnë, prandaj le të qëndrojnë në shtëpitë e tyre. Por, fuqia e bindjes i krijon idenë njeriut se ai mund të bëjë çfarë nuk ka mundësi dhe se ai është i aftë të emigrojë, me gjithë dobësinë dhe paaftësinë e tij. Këtu, ai projektonte planin e vet, sikur të ishte i fortë e i shëndoshë dhe refuzon t'i dorëzohet sëmundjeve të trupit të tij.

Ibn Abasi (r.a) tregon: "Një njeri nga Beni Lejth dëgjoi se Allahu i ka justifikuar të dobëtis duke i përjashtuar prej obligimit të hixhretit (emigrimit). Njeriu ishte i moshuar dhe i sëmurë, e megjithatë tha: -Pasha Allahun, unë nuk jam prej atyre që Allahu i ka përjashtuar. Unë kam mundësi të manovroj dhe kam pasuri sa të më çojë deri në Medinë, bile edhe më larg saj. Pasha Allahun, nuk ka për të më zënë nata në Mekë, prandaj më nxirrni që këtu. E nxorën jashtë duke e mbajtur mbi shtrat, derisa arritën në Ten'im, në një vend larg Mekës. Aty u sëmur rëndë dhe pa se vdekja i është afruar".

Entuziazmi i fortë nuk arriti ta mposhtë sëmundjen e fshehur. Njeriu besimtar ndjeu se po vdiste pa arritur të realizonte ëndrrën e tij, pa kënaqur Zotin, pa ndihmuar të Dërguarin dhe pa iu bashkangjitur vëllezërve të tij muhaxhir (emigrues). Çfarë të bëjë?

Dorën e djathtë e vendosi mbi të majtën në formë të besës, pastaj iu drejtua Zotit duke thënë: -O Zoti im, kjo është për Ty dhe kjo është për të Dërguarin Tënd. Ta jap besën Ty për atë që ta ka dhënë i Dërguari Yt dhe vdiq.

Ky ishte mudi i njeriut dhe kjo ishte fuqia e tij duke e shprehur besimin e vet të fshehur me lëvizjen e dorës

së djathtë mbi të majtën, ndërkohë që ishte në shtratin e vdekjes. Lajmi arriti te Pejgamberi (a.s) dhe zbriti ajeti fisnik: "Kush del prej shtëpisë së tij muhaxhir (emigrues) për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, pastaj atë e arrin vdekja, patjetër që shpërblimi i tij ka rënë tek Allahu. Allahu është Falës, Mëshirues".¹⁴

Çfarë do të kishte bërë ai, sikur të kishte mbetur gjallë e të plotësohej hixhreti (emigrimi) i tij? Do të kishte rënë shehid (dëshmor) në luftë me jehuditë arrogantë, të cilët nuk kishin dhënë asnjë kontribut në luftë ndaj idhujtarisë, apo fshirjes së injorancës, por u munduan me të gjitha forcat të parandalonin Islamin dhe të luftonin akiden (besimin) e teuhidit. Ose mund të vritej në kolonizimin romak, i cili e poshtëroi njeriun, i deformoi të vërtetat e besimit dhe përhap brutalitetin në çdo vend.

Vula hyjnore e Mesazhit të fundit, (paqja dhe bekimi qoftë mbi të), arriti të prodhojë burra të lartë dhe heroizma të rrallë sepse ai pati sukses, siç nuk pat askush tjetër në formulimin e zemrave të pastra dhe natyrave të qeta. Ai u bë ngjyra e qytetërimit të ri, i cili i nxori njerëzit nga errësira në dritë dhe e lidhi botën me Allahun e Plotfuqishëm.

14. Sureja Nisa, ajeti: 100

RREZIKU I NDRYSHIMEVE DYTËSORE

Isha dëshmitar i një grindjeje të zjarrtë mes dy grupeve njerëzish, njëri mendonte se duhet të thuhet pa zë "Amin" pas imamit, ndërsa grupi tjetër kishte mendimin se duhet të thuhet me zë të lartë "Amin".

Dikush kishte propozuar që të vinin tek unë për gjykimin e çështjes dhe të vendosja kufirin e kësaj grindjeje...

Thashë: -Të thuash "Amin" është dua (lutje). E rëndësishme në të është që të përgjërohesh dhe të lutesh. Në qoftë se prekesh gjatë lutjes dhe e ngre zërin, apo nëse përgjërohesh dhe nuk flet, është e njëjta gjë...

Njëri prej dëgjuesve, ndërkohë që sytë po i nxirrnin flakë tha: - Nuk kuptuam asgjë.

I thashë: -Po, se të tillë jeni. Ju prisni një përgjigje që do të kënaqë shejtanin e kryeneçësisë, i cili fryhet shumë në kësi lloj debatesh të nxehta dhe duke ju bërë armiq të urryer të njëri-tjetrit. Në qoftë se nuk ekziston mundësi tjetër veçse një përgjigje juridike, atëherë ta dini se ngritja e zërit në "Amin" është medhheb, por edhe heshtja në "Amin" edhe ajo është medhheb dhe që të dyja janë të transmetuara e inshaAllah kanë shpërblimin e tyre.

Të dy grupet u larguan prej meje të ngushtuar dhe ndjeva një si rehati, sepse ata ikën nga unë. Madje, kuptova varfërinë e këtyre njerëzve për një edukator me vizion të largët, për t'i ngritur në një nivel më të lartë se sa kjo mendjelehtësi, e cila i ka bllokuar prej shpirtit të adhurimit dhe edukatës së namazit.

Ky ndryshim i fikhut juridik, është shembull i dhjetëra e dhjetëra shembujve të tillë që zënë kohën dhe kokën e njerëzve bosh, ndezin fitne (trazira), zhvlerësojnë moralin dhe këpusin çfarë Allahu ka urdhëruar të mbajnë lidhur.

Mua më përfytyrohet sikur këto ndryshime dytësore përngjasojnë me format e baktereve, të cilat na tregohen nëpër librat e mjekësisë, ku poshtë tyre shënohet: "mikrob", filan sëmundje e zmadhuar 1000 herë...

Zmadhimi i këtyre formave për t'i njohur është i kuptueshëm, por çfarë kuptimi ka zmadhimi i këtyre ndryshimeve në mesin e mendimeve dhe opinioneve të disa dijetarëve, derisa ato të duken sikur janë të vërteta të popujve të zhdukur? Rezultatet e tyre kanë qenë problem shqetësues për shoqërinë tonë fetare, sepse ky hiperbolizim i fabrikuar mbuloi fusha të gjera, të cilat duhej të lëvizeshin prej moralit që asnjë popull nuk ngrihej, përveçse me to. Kështu që, në vend që t'i zëmë njerëzit me formimin e virtyteve të larta, sinqeritetin, besnikërinë, mbajtjen e premtimit, turpin etj, i kemi zënë me diçka që mendojmë se ka më shumë shpërblim dhe dobi.

Ky është një iluzion i largët, sepse mungesa e moralit do të thotë përhapje e hipokrizisë, fesadit (shthurjes) dhe humbjes së popujve...

Në vete kam mendimin se, ndezja e fanatizmit të medhhebeve ka qenë plan dredharak për largimin e

vëmendjes së opinionit prej kritikave politike dhe ndjekjes së gabimeve, të cilat e varrosën që moti, për së gjalli shtetin islam. Siç duket plani akoma është aktiv dhe vazhdon ende të zbatohet ...

HADITHI I DOBËT

Një lexues më pyeti: -Përse, nganjëherë në librat e tu transmeton disa hadithe të dobëta?

Iu përgjigja: -Sepse unë kam shembuj, apo argumente të tjerë të sakta, të cilat e forcojnë hadithin dhe ia largojnë dobësinë.

P.sh merr hadithin: "Duajeni Allahun për shkak se Ai ju furnizon me të mira, më doni mua për hatër të dashurisë që keni për Allahun dhe duajeni Ehli Bejtin (familjen time), për hatër të dashurisë që keni për mua." Këtë hadith e ka dobësuar Albani, por unë nuk kam rënë dakord.

Le të shikojmë së bashku fjalinë e parë të hadithit. A vihet në dyshim dashuria ndaj Allahut? Ai njeri, i cili të mirat e Allahut i pret me mosmirënjohje, ai është njeri i ulët. Pastaj, kë të duam, n.q.s harrojmë Allahun?

Tani, le të shikojmë dashurinë për të Dërguarin. Cili është sekreti? Pa dyshim, ai na tregoi rrugën për tek Allahu, na e zbardhi Madhështinë e Tij dhe e përsosi lavdërimin dhe Njësimin me fjalët dhe veprat e Tij. Unë jam më shumë se i bindur se, nuk gjendet njeri në botë, që nga fillimi e deri në fund të saj, që të jetë sprovuar, siç është sprovuar i

Dërguari (a.s) në njohjen e Krijuesit, për krijesat dhe pasimin e tyre në rrugën e tij.

Për këtë Allahu i Madhëruar thotë: "Thuaj: Në qoftë se jeni që e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë mëkatet tuaja..." (Ali Imran: 31)

Pra, dashuria për të Dërguarin buron nga dashuria jonë për Allahun.

Ndërsa për Ehli Bejtin e tij (familjen)?! Njerëzit nga lindja deri në perëndim i nderojnë personalitetet pas vdekjes së tyre. A nuk keni vënë re se të gjitha qeveritë i nderojnë zyrtarët e tyre kur vdesin duke iu garantuar familjeve mbrojtje dhe ndihmë sociale?! Prandaj edhe ne, për hatër të Pejgamberit e duam familjen e tij, Ehli Bejtin dhe u dërgojmë përshëndetje (salavat) si vlerësim dhe falënderim për mirësitë që na ka dhuruar.

Zemra më copëtohet kur lexoj vargjet poetike, të cilat përshkruajnë shtëpinë e të Dërguarit të Allahut pas vdekjes së tij:

Shkolla e ajeteve zbrazur prej leximit

Dhe shpija e Shpalljes tokë e shkretimit

Vajzat e Jezidit në kështjella të fortifikuara

Dhe vajzat e Dërguarit të Allahut në kasolle të rrënuara

Përse ta dobësoj këtë hadith e të përpiqem të hedhë akuza ndaj zinxhirit të transmetimit, ndërkohë që përmbajtja (meteni) nuk ka kurrfarë problemi?!

Merr hadithin e mësimi përmendësh të Kur'anit Famëlartë, të cilin e transmeton Ibn Abasi prej Ali ibn Ebi Talibit. Tre fjalitë e para që janë në fillim të hadithit, për mua ato janë prej argumenteve të pejgamberllëkut, që janë: "O Allah, më mëshiro duke u larguar prej gjynaheve sa të kem

frymë në këtë botë. Dhe, më mëshiro që të mos ndërhyj në atë që nuk më takon e më jep shikim vetëm në atë që Ti je i kënaqur me mua.”

Me të vërtetë, fuqia e përmendësit (zakirit) nuk arrihet, veçse përmes këtyre tre gjërave, ndërsa gjynahet e shkapërderdhin mendjen.

Ndërhyrja në çdo punë dhe send e ndalon aftësinë dhe mundësinë e zënies përmendësh, ndërsa vlerësimi i gabuar për atë që kënaq Allahun të çon drejt ndalimit të mirësive të Tij...

Hadithi është i gjatë dhe unë e kam provuar, si dhe kam përfituar prej tij. Për këtë, Pejgamberi (a.s) ka thënë për Aliun, pasi zbatoi porosinë e tij: “Besimtar, pasha Zotin e Qabes, o babai i Hasanit (o Ali)...”

Diturinë fetare, Allahu nuk ia dhuron njerëzve ekstremistë dhe të ulët, por ua dhuron dhe ua shton atyre që punojnë me të dhe janë të sjellshëm ndaj saj. Ndërsa, diturinë e jetës së kësaj bote e shfaq për nevojtarët.

Këtë që po them, e kanë thënë përpara meje edhe dijetarë të tjerë, që hadithin e dobët, kur e mbështesin argumente dhe shembuj të fortë, e pranojmë dhe nuk e refuzojmë.

Kritikët kanë rënë dakord se trashëgimia e Muhammedit (a.s) është mbrojtur dhe ruajtur si asnjë trashëgimi tjetër njerëzore në këtë botë, që në ezel (zanafillë) e deri në exhel.

Lënda e Islamit ka qëndruar e pa cenuar, e pastër dhe e plotë në gjithë rrjedhjen e kohës dhe në çdo vend. Kjo, sepse Allahu e ka marrë përsipër ruajtjen e kësaj feje, ndërkohë që librat e tjerë i ka përshkuar deformimi, nga rrënja deri në majë.

Nuk jam prej dijetarëve të seleksionimit dhe redaktimit (xherh ve tadir), megjithëse do kisha dëshirë të isha prej tyre, sepse disa transmetime në të cilat kam shfaqur dyshimet e mia, më kanë rezultuar se vargu i transmetimi të tyre ishte i futur dhe kritikët përpara meje i kanë mohuar ato.

Problemi, fatkeqësia vjen prej transmetuesit me kuptim të paktë, ose prej hadithologut që nuk ka dituri në Usul, sepse e gjithë dituria fetare plotësohet dhe mbështetet me njëra-tjetrën, duke plotësuar mangësitë e tyre.

Dikush më tha: -Ebu Hamid El-Gazali ka përdorur dy hadithe të dobëta për zgjedhjen e bashkëshortes.

I thashë: - Cilat janë ato dy hadithe?

Përmendi hadithin: "Largohuni prej "gjelbërimit të prishur". I thanë: -Kush është "gjelbërimi i prishur?" Tha: "Gruaja e bukur prej origjinës së keqe." Ndërsa hadithi tjetër: "Zgjidhni me kujdes se me kë martoheni, sepse raca ndërfitet".

I thashë: -Ndoshta vargu i transmetimeve të këtyre haditheve mund të jetë i dobët, por për to dëshmon thënia e Pejgamberit (a.s) në një hadith tjetër, për të cilin nuk ka kundërshtim në saktësinë e tij: "Njerëzit janë sikur xeherorët (mineralet), më i miri prej tyre para Islamit është më i miri i tyre në Islam, në qoftë se e kupton saktë", për këtë arsye unë nuk e quaj gabim Ebu Hamid-in në citimin e tij të këtyre dy haditheve.

Prej Enes ibn Malikut transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Zebanitët (rojet e xhehenemit) janë më të shpejtë ndaj të shthururve të Kur'anit se sa ndaj adhuruesve të idhujve. Thonë: -Fillohet me ne, përpara adhuruesve të idhujve? Atyre u thuhet: -Nuk janë të njëjtë ata që dinë me ata që nuk dinë."

Këtë hadith, të shumtë janë ata që e kanë dobësuar, por Hafidh Mundhiri u ka pranuar dhe ka thënë: "Për këtë hadith dëshmon hadithi i Muslimit në librin e tij të saktë, që zjarri i xhehnemit në ditën e Kiametit do të ndizet me tri lloje njerëzish, ndër të cilët do të jetë personi i cili ka mësuar Kur'an sa për t'u dukur, ose për t'i treguar të tjerëve që është hafiz.

Dhe, prej gjërave të bukura të Mundhiriut është se ai në kapitullin e asketizmit transmeton prej Sehl ibn Sead se ka thënë: "Një njeri erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s) dhe i tha: -Më trego për një punë, të cilin po qe se e punoj do të më dojë Allahu dhe do të më duan njerëzit. Ai (a.s) i tha: "Hiq dorë nga dynjaja dhe do të të dojë Allahu dhe hiq dorë nga ajo që njerëzit kanë në dorë dhe do të të duan njerëzit."

Mundhiri u ka cilësuar këtë hadith të manipuluar dhe e ka refuzuar vargun e transmetimit të tij. Pastaj, ka thënë: "Por, ky hadith ka shkëlqim prej dritave të pejgamberllëkut. Të heqësh dorë nga dynjaja është e refuzuar, kur ajo shërben si ndihmë për fenë, mbrojtje për nderin dhe pavarësi ndaj njerëzve, sepse nuk ka ekzistencë të fesë, po nuk e mbrojt dynjaja. Por, në qoftë se dynjaja vjen në shërbim të dhunës dhe për refuzimin e të vërtetës, atëherë jo.

Dijetarët që veprojnë në fushën e thirrjes e dinë mirë qëllimin e fjalëve. Pasi, ndryshimi i vendndodhjes së fjalëve është problem i madh.

VENDI I GRUAS NË ISLAM

Znj. Fazla erdhi tek unë dhe m'u ankua për një hatib xhumaje, të cilin e kishte dëgjuar duke thënë "Rahmet pastë ajo kohë kur gruaja nuk dilte, vetëm se tre herë: Në dynja, kur nëna e lindte, kur martohej, nga shtëpia e babait të saj për te burri dhe prej dynjasë, nga shtëpia e burrit për në varr."

Tha: -Kjo është mënyra, me të cilën Islami sillet ndaj nesh? Iu përgjigja duke i thënë: -Hatibi ka rënë nën presionin e shtypjes së fesadit (shthurjes), të cilin e ka sjellë qytetërimi i ri, prandaj ka thënë atë që ka thënë, por pa patur sukses, sepse devijimi nuk mjekohet me devijim.

Pa dyshim, gruaja ka të drejtë të dalë në xhami për pesë kohët e namazit, ka të drejtë të dalë në treg dhe nëpër qendrat tregtare për nevojat e saj. Ajo mund të marrë pjesë edhe në ushtri n.q.s ka talent ushtarak, mjekësor, apo inxhinjerik. Koha për të cilën çojmë rahmet, apo ne marrim prej saj, është koha e peygamberllëkut. Ajo, pa dyshim është koha më e mirë, ndërsa koha e shthurjes, apo e injorancës, nuk duhet të merret si krahasim dhe as të na vijë keq për të.

Hatibi në fjalë ka parë shkatërrimin e familjes në

Perëndim, humbjen e fëmijëve dhe përhapjen e veprave të ulëta, prandaj ka thënë atë që ka thënë.

Më e mirë se thënia e tij do të kishte qenë një shpjegim me besnikëri i gjendjes së gruas myslimane ashtu siç e ka formësuar Kur'ani, apo sqaruar Suneti i pastër i Pejgamberit (a.s).

Prijësi i madh i selefive, Abdulhamid ibn Badis¹⁵ shkruan duke treguar për Rebia bint Muavidh: "Ajo mori pjesë në Besën Ridvan dhe ishte luftëtare me Pejgamberin (a.s) së bashku me gra të tjera, të cilat i shërbenin ushtrisë duke u dhënë ujë ushtarëve, duke mjekuar të plagosurit e duke i transportuar ata për në Medinë".

Pastaj Ibn Badisi, pasi shpjegon qëndrimin e fesë ndaj gruas thotë: "Patjetër duhet patur parasysh çfarë Islami i urdhëron ato në mënyrë që të jenë të ruajtura, të mos ekspozohen dhe të mos përzihen me meshkuj të huaj. Asnjëherë nuk do të plotësohet jeta e ymetit, përveçse me jetën e dy pjesëve të saj, meshkujve dhe femrave".

Ky dijetar zbulon vlerën e asaj që Tabarani transmeton nga Aisheja (r.a) për çështjen e grave: "Mos u jepni vende të larta dhe mos i mësoni shkrimin, por u mësoni atyre punën e dorës dhe suren Nur", duke sqaruar se ky hadith është trillim...

Ndërsa ne të gjorët kemi treguar se ky hadith i trilluar ka sunduar përgjatë shekujve shoqërinë islame.

Sunetet Mutevatire, të sakta dhe të mira, kanë qenë të ngurosura në mënyrë të habitshme. Prandaj edhe

15. Abdulhamid ibn Badis, dijetar prej dijetarëve të shquar dhe kryetar i dijetarëve të Algjerisë në vitin 1926 ... i cili i bëri rezistencë të madhe kolonizatorit francez duke i shkaktuar humbje të mëdha. Shejkh Abdulhamid ishte prej atyre burrave me peshë të madhe në rezistencën ndaj pushtimit kulturor francez.

myslimanët u rrokullisën në botën e tretë, duke u shtyrë në bisht të karvanit njerëzor për shkak të humbjes së edukimit të saktë, sepse nuk ka edukim me injorancën e gruas dhe largimin e saj prej botës së shkencës e të adhurimit, prej thirrjeve drejt të mirës dhe problemeve të myslimanëve.

Një sqarim edhe më të mirë. Njeriu mund të thotë për veten e tij "Unë nuk shkoj nëpër kafene dhe bare, jeta ime është mes punës dhe shtëpisë." Konteksti i kësaj fjale është i njohur, por ajo asnjëherë nuk do të thotë se ai nuk shkon në xhami, apo nuk del nëpër tregje. Kështu është edhe puna me qëndrimin e gruas në shtëpi. Ajo është rendje drejt punës së saj të qëndrueshme, zonja e shtëpisë dhe shtylla e familjes, por kurrë nuk do të thotë se ajo është e burgosur dhe nuk duhet të dalë, veçse për në varr... apo për te burri i saj kur të martohet.

TRULLOSJA NË DEBAT TË ZË MENDJEN DHE FENË

Hyra në një tubim ku debati kishte shpërthyer. Pashë se një djalë i ri kishte shpërvjelur krahët me plot seriozitet për t'u zhytur në betejën e ashpër të humbjes, apo të triumfit, sikur fitorja dhe dështimi në këtë tubim, sipas perceptimit të tij, të jetë jetë a vdekje.

Disa të pranishëm menduan të isha unë gjykuesi për të mbyllur situatën, por isha asket në dëgjimin e palëve konfliktuese dhe nuk e pëlqeja dhënien e një vendimi për të përcaktuar gabimin, ose saktësimin e njërës, apo të tjetrit.

Nga panorama që vura re, isha i bindur se triumfi i egos ishte më i shtrenjtë se sa njohja e të vërtetës. Poshtërimi i gabimtarit ishte qëllim i rëndësishëm në vetve. Krenaria e qëlluesit ishte objektivi i kërkuar dhe se shejtani ishte zotëria i situatës.

Kujtova një hadith, të cilin e transmeton Ebu Seid El-Khudrij duke thënë: "Ishim ulur te dera e Pejgamberit (a.s) duke biseduar, njëri sillte një ajet dhe tjetri një ajet tjetër. Kur na dëgjoi Pejgamberi (a.s) doli i skuqur, sikur t'i kishin shpërthyer në fytyrë kokrrat e shegës,. Fytyra e tij ishte e ndezur nga zemërimi i fortë dhe tha: "O ju njerëz! Për këtë jeni dërguar?! Apo, për këto jeni urdhëruar?! Mos u ktheni

pas meje mohues, duke mbytur njëri-tjetrin.”¹⁶

Betejat e debateve janë beteja me pasojat më të këqija, me përfundimet më të rënda dhe largimi prej tyre është më e ndershme për mendjen dhe më e sigurt për fenë.

Një djalë më ndoqi nga pas duke më kërkuar të përcaktoj të vërtetën shkencore, larg nga atmosfera e debatit, ndërkohë që unë i thashë: “Disa njerëz njohin një pjesë të së vërtetës e janë të panjohur për pjesën tjetër të saj dhe atyre u përshtatet shprehja:

“Thuaj atij që pretendon se njeh të vërtetën

Ke mësuar një gjë dhe të mungojnë shumë gjëra...”

Patjetër që unë e vlerësoj shqyrtimin e gjithë të vërtetës, por dua të ndryshoj metodën që po përhapet dhe t’u tregoj këtyre djemve të rinj, që ta ndjejnë se Islamit nuk i shërbehet me këto metoda. Përse fetarizmi duhet të ketë shumë ose pak fjalë?! Përse fetaristët të mos u drejtohen skutave të thella të shoqërisë, në mesin e së cilës mund të zbulojnë dhe të kërkojnë të metat e saj për t’i rregulluar apo për t’i zgjidhur siç duhet?! Brenda saj mund të gjesh gjithashtu dhe ndonjë turp për ta mbuluar, ndonjë mosmarrëveshje familjare që duhet pajtuar, ndonjë sëmundje për t’u shëruar, apo ndonjë krizë e cila duhet tejkaluar...

Me të vërtetë ne kemi trashëguar një ymet, të cilin e kanë kapluar shumë humbje dhe e kanë mbizotëruar tradita të ulëta, por reformimi ka nevojë për zgjuarsin, këmbëngulje dhe sinqeritet, jo për llafe e kryeneçësi.

Fetarizmi negativ në kohën tonë është plaçkë pa vlerë dhe prej Allahut nuk merr asgjë, përveç urrejtjes. Por, që besimtarët t’i bëjnë mirë fesë së tyre duhet të mblidhen

16. Hadith i Saktë - Transmeton Buhariu, Muslimi, Imam Ahmedi etj.

rreth studimit të rrethanave në të cilat jetojnë e të nxitojnë për shpëtim të çdokujtë që është duke e pritur atë, prej të pafuqishmëve dhe të braktisurve.

Mendo pak rreth këtij përshkrimi për sjelljen e besimtarit ku Pejgamberi (a.s) thotë: "Çdo mysliman e ka për detyrë të japë sadaka." Dikush tha: - Po në qoftë se nuk gjen? Iu përgjigj: "Punon me duart e tija, i bën dobi vetes dhe jep sadaka!" Thanë: -Po në qoftë se nuk mundet? Tha: "Ndhmon një nevojtar!" Dikush tha sërish: -Po në qoftë se nuk mundet? Tha: "Urdhëron për mirësi, ose bamirësi!" Thanë: -Po në qoftë se nuk vepron kështu? Tha: "Të ndalet nga e keqja, sepse edhe kjo është sadaka për të."¹⁷

Negativizmi është paaftësi e qartë, ndoshta i bie të jetë më afër hipokrizisë se sa imanit.

17. Hadith i Saktë nga Ebu Musa (r.a) - transmeton Buhariu, Muslimi, Imam Ahmedi dhe Nesaiu në Sunenin e tij.

RRETH FYTYRËS SË FEMRËS

Një burrë rreth të dyzetave vjen dhe më takon duke folur sikur të ishte një djalë pa përvojë. Me zë të përçartë më tha: -A jeni ju që jepni fetva se fytyra e femrës dhe zëri i saj nuk janë auret¹⁸?

Me qetësi i thashë: -Po.

Tha: -A nuk e ke frikë Allahun?

I thashë: -Të këshilloj ty dhe vetëm time, ta kemi frikë Allahun.

Tha: -Ti je gabim për atë që u thua njerëzve, prandaj duhet të pendohesh.

I thashë: -Nuk jam i vetëm në këtë qortim, sepse mufesirinët (komentuesit) e mëdhenj më kanë paraprirë në këtë gabim. Ashtu si më kanë paraprirë në të edhe dhjetë transmetues të haditheve të sakta. Gjithashtu janë pjesëmarrës në këtë gabim edhe imamët e katër medhhebeve, si dhe një numër tjetër i shkollave juridike.

Të tërë këta njerëz, prej të cilëve kam nxjerrë thënien time, apo i kam pasuar në gabimin e tyre, nëse nuk ndjej

18. Auret: në këtë kontekst do të thotë: Fytyra e saj nuk lejohet të shikohet nga njerëzit e huaj dhe as zëri të mos dëgjohet prej tyre (L.H).

asnjë faj është, sepse të gjithë janë bashkautorë të një akuze të vetme.

Burri, i çuditur më tha: -Çfarë po thua, të gjithë këta kanë dhënë fetva se fytyra e femrës dhe zëri i saj nuk janë auret?!

I thashë: - Po, por ju ndikoheni prej traditave të përhapura dhe kapeni prej mendimeve më pak të sakta.

Po..., le të supozojmë sa për debat, ta zëmë se rreth kësaj çështje ka dy mendime dhe unë kam zgjedhur njërin prej tyre, atëherë përse irritimi, fajësimi dhe fyerja? A e keni dëgjuar hadithin e Selmanit me Ebu Derdan?

Tha: -Jo!

Atëherë i thashë: - Dëgjo... Transmeton Buhariu nga Ebu Xuhajfe duke thënë: "Pejgamberi (a.s) vëllazëroi mes Selman El-Farisiut dhe Ebu Derdas ... Selmani i shkoi për vizitë Ebu Derdasë dhe kur shikoi Umu Derdan me rroba të vjetra dhe jo të bukura i tha: -Çfarë ke? Përse kjo pamje? Tha: -Vëllai yt, Ebu Derda nuk ka nevojë për grua(!).

Erdhi Ebu Derdaja dhe i përgatiti ushqimin, pastaj i tha Selmanit: -Ha, sepse unë jam agjërueshëm¹⁹. Selmani i tha: -Në asnjë mënyrë nuk do të ha derisa të hash edhe ti. Ai e çeli agjërimin për të përmbushur të drejtën e mysafirit. Pasi kishte rënë nata, Ebu Derdaja filloi të falej, ndërsa Selmani i tha: - Fli. Dhe ai u shtri për të fjetur! Pastaj u ngrit përsëri për t'u falur, por ai i tha: -Fli, dhe ai fjeti. Sapo kishte mbetur fundi i natës, Selmani u ngrit dhe i tha: -Tani çohu. Dhe u falën të dy së bashku.

Selmani i tha: -Ti ke detyra ndaj Zotit, ke detyra ndaj vetes, por edhe ndaj familjes tënde e ndaj gruas, prandaj

19. Agjëronte nafle dhe jo ramazan.

jepi çdokujt të drejtën që i takon.

Ebu Derdaja shkoi te Pejgamberi (a.s) dhe i tregoi çfarë i kishte ngjarë. Pejgamberi (a.s) i tha: "Selmani ka pasur të drejtë."

Ajo që më intereson nga përshkrimi i këtij hadithi është dialogu që bëhet në fillim të tij. Sikur ky dialog të zhvillohej në kohën tonë, vizitori do të rrihej dhe gruaja do të vritej, ndërsa burrit do t'i thuhej: -Çfarë të duhet ty të shikosh rrobat e gruas?! Përse ndërhysh në këto vërejtje? Ndërsa gruas do t'i thuhej: -Si i ankohesh të tjerëve për burrin tënd dhe për sjelljet e tij?!

Por, ndërgjegjja dhe shpirti i pastër në kohën e sahabeve i largon të gjitha dyshimet dhe nuk lë vend për mendime të këqija. Ndërsa, kur njerëzve u prishet ndërgjegjja, atëherë vjen thënia e poetit:

"Kur veprat e njeriut janë të këqija, të këqija janë edhe mendimet

Dhe, beson atë që është mësuar të bëjë prej dyshimeve".

Mbi këtë bazë na kanë gjetur natyrat e sëmura duke e quajtur zbulimin e fytyrës imoralitet dhe ajo është e ndaluar (haram), sepse është derë që të çon drejt mëkateve të mëdha, Allahu na ruajt.

RRËSHQITJA NË DEBAT DHE PËRÇARJA E AUDITORIT

Në një nga derset (ligjëratat) e mija, solla si shembull disa israilijatë²⁰ nga kultura jonë e vjetër dhe solla rastin që është mjaft i përhapur ndër ne, duke thënë "Ithtarët e librit besojnë se tufani i Nuhit (a.s) ka qenë botëror, duke përfshirë gjithë rruzullin, ndërsa studimet tregojnë se ai ka qenë rajonal, pa dalë jashtë banimeve të popullit të Nuhit (a.s)".

Bërtitën disa njerëz "Kjo është e habitshme dhe cili është argumenti i studiuesve"?

Thashë: -Po sjell për ju tre ajete kuranore, të cilat mbështesin mendimin e autorëve se tufani ka qenë rajonal dhe jo botëror.

"Për shkak të gabimeve të veta, u përmytën dhe u hodhën në zjarr dhe për ata nuk do të ketë, përveç Allahut, asnjë ndihmëtarë." (Nuh: 25)

"Dhe spopullin e Nuhit, kur ata përgënjeshtroan profetët, ne i përmytëm dhe i bëmë argument për njerëzit." (Furkan: 37)

20. Israilijatë -Tregime fetare nga Beni Israilët që janë futur në tregimet islame.

“Ne, me të vërtetë e dërguam Nuhin për te populli i vet dhe qëndroi me ta 950 vjet dhe i përfshiu tufani e ata ishin zullumqarë.” (Ankebutë: 14)

Pastaj u thashë: -Vendbanimi i Nuhit (a.s) ka qenë në veri të Irakut dhe kjo gjatë sundimit të shtetit Sumeri, në periudhën e parë të familjes së Faraonëve. Tufani nuk ka mbërritur deri në luginën e Nilit e as në Indi dhe aq më tepër të ketë shkuar edhe më larg, deri sa të mbërrijë të dy Amerikat etj.

Një nga pjesëmarrësit ma ktheu: -Këto fjalë nuk i kemi dëgjuar asnjëherë.

Dikush tjetër tha: -Kjo është dalje prej konsensusit (ixhmasë).

E kështu me rrallë vazhduan reagimet njëra pas tjetrës, derisa disa njerëz filluan të pëshpërisnin për mua dhe autorët e këtij mendimi si jobesimtarë.

E pashë të arsyeshme që të mos vazhdoj më në këtë diskutim dhe të kaloj në një faqe tjetër të bisedës, por vendosa të qetësoj irritimin e tyre dhe ta ndaloj zhytjen e mëtejshme në këtë drejtim.

Thashë me vete “Le të jenë mendimet të çfarëdo lloji në lidhje me këtë çështje, sepse fundi i fundit ato nuk kanë lidhje me besimin (akiden) dhe as me adhurimin (ibadetin), madje as nuk kanë të bëjnë me sjelljen dhe karakterin (veprat) e njeriut. Ato janë komentime të një pjese të historisë, duke u mbështetur në kuptime sipërfaqësore, apo kuptime më të thella të ajeteve.

Me gjithë animin tim se tufani ka qenë rajonal, unë habitem se si mund të lidhet kjo gjë me besimin, apo mosbesimin (iman dhe kufr), me devijimin, apo konsensusin, me zemërimin, apo kënaqësinë dhe me armiqësinë, apo me

pajtimin...! Përse i llogarisni kaq shumë gjërat dhe dëshironi të largoheni prej tubimit të diturisë grupe-grupe të përçarë dhe jo vëllezër të dashur dhe shokë duke qeshur e duke ndihmuar njëri-tjetrin?!

Çfarë është gjithë kjo dëshirë për të prishur rradhët dhe përçarë trupin?!

Një nga pjesëmarrësit ma ktheu: -Këto fjalë nuk i kemi dëgjuar asnjëherë.

I thashë: -Po, kush ka thënë se ju e keni dëgjuar të gjithë diturinë? Le të jetë diçka e re për veshët tuaj dhe le t'ju vijë rëndë, por përse akuzimi i pamenduar? Çfarë do t'ju gjente sikur të kërkonit argumente të tjera nga secili grup dhe ta trajtoni situatën me logjikë dhe gjakftohtësi?

Fatkeqësia e disa njerëzve është se ata nuk kuptojnë, vetëm atë që kanë dëgjuar më parë dhe e bëjnë qimen tra...

PËRÇARJA

Përçarja në jetën e myslimanëve dhe të historisë së tyre, është një sëmundje me virus shumë të keq, me fillim të mbrapsht dhe fund të urryer²¹...

Përpjekjet për ta eliminuar këtë gjë janë detyrë për çdo person të sinqertë për hir të Zotit (xh.sh) e të Dërguarit të Tij (a.s), për çdo këshillues të këtij ymeti dhe për çdo njeri që kujdeset për të ardhmen e këtij populli...

E dimë se ekzistojnë ndryshime mes mendimeve, dispozitave dhe Medhhebeve, që ngjajnë me një ndryshim të natyrshëm mes gjuhëve dhe ngjyrave.

Nga ky ndryshim nuk duhet të shqetësohemi dhe as që duhet të jetë burim shqetësimi. Madje ky ndryshim është prej argumenteve të Zotit (xh.sh) që thërrasin për meditim dhe mahnitje dhe jo për shqetësim e mos përmbajtje.

Poeti vështron fushën për të lexuar nëpër rreshtat e bimëve shenjat e bukurisë, pastaj shpirti i tij noton pas një imagjinate të hollë, të cilën e portretizon me fjalë të ëmbla. Në të njëjtën kohë, biologët shikojnë të njëjtën

21. Ky artikull është marrë nga libri: El-Islamu vet-Takatu el-Muattaletu.

fushë, por asnjëri prej tyre nuk mund ta thotë atë që poeti ka thënë.

Ata janë të zënë me dheun dhe elementet e saj, me sasinë që përbën uji dhe ushqimi, me prodhimin e frutave, me përqindjet e sheqerit, të vlerave ushqyese ... etj.

Zoti (xh.sh) i ka bërë të larmishëm shpirtrat dhe mendimet e njerëzve, aq sa ka bërë të larmishëm edhe trupat e tyre.

S'ka dyshim se ekzistojnë kuptime të përgjithshme në perceptimin e të cilave marrin pjesë të gjithë, por është e kotë të mohohet niveli mendor dhe emocional në natyrën e perceptimit dhe të mënyrave të tij. P.sh për çështjen e robërve në Bedër, gjykimi i sahabeve ishte i ndryshëm, ashtu siç ishin të ndryshme mendjet e tyre të mprehta e të qeta.

Për faljen e namazit në Beni Kurejdha ndryshuan vendimet e tyre sipas qëndrimit ndaj tekstit (hadithit), dikush e mori atë sipërfaqësisht, ndërsa të tjerë morën qëllimin e kuptimit të tij.

I gjithë ky ndryshim ishte diçka që autorët e tij nuk mund të nënvleftësohen e as të paragjykojnë.

Ne nuk frikësohemi nga një ndryshim i tillë, e as që përpiqemi ta ndalojmë dhe nuk pasojmë për të gjurmët e njerëzve në qoftë se lenë gjurmë, por bashkëpunojmë në gjetjen e së vërtetës me aq sa kuptojmë e me aq sa kemi mundësi dhe për këtë Zoti na mjafton.

Ndërsa ndryshimi, të cilin e urrejmë e i kërkojmë Zotit të na ruaj nga ajo e keqe dhe nxisim çdo njeri të devotshëm të shuajë zjarrin e tij, është ndryshimi i cili përzihet me epshin e shoqëruar nga dëshirat që shejtani i fryn. Ndoshta mundësia më e madhe është që ky ndryshim

të jetë i ndikuar nga pushteti ose nga përfitimi prej tij.

Ai, ashtu siç e vumë re, lind për këtë botë, pastaj kërkon të gjej shkaqe e justifikime nga feja, që të bëhet ndryshim islamik dhe jo personal.

Ndoshta ky ndryshim mund të lind islamik që nga djepi i tij, por me kalimin e kohës hynë ngacmimet dhe dëshirat duke e zmadhuar hendekun e tij, shtohet e keqja dhe sipas kësaj vinë rezultatet, të cilat nuk mund të lejohen as në fe e as në mendime.

Në një ditë të vetme ranë 18.000 të vrarë në një betejë mes Shiitëve dhe Sunitëve, era e së cilës ndodhi në Azinë e Vogël.

Pashë Zotin! Përse gjithë ky mal i ngritur nga kufoma të viktimizuara?! Por për gjithë këta të vrarë të pafajshëm, të cilët ranë nga të dy grupet, patjetër që për ta do të pyetën disa udhëheqës tiranë?!

Është e habitshme që të fshihet gjithë kjo grindje politike pas rrobave fetare!

Ç'hyn feja në këtë betejë?

Masa e Shiitëve u mashtruan duke iu thënë "Ehli Suneti urrejnë akrabatë e të Dërguarit (a.s) dhe nuk e duan Ehli Bejtin..."

Por edhe masa e Ehli Sunetit u mashtruan duke u thënë "Shiitët mendojnë se Aliu (r.a) e ka merituar profetësinë më shumë se Muhamedi (a.s) dhe se ata ndjekin një tjetër Kur'an nga ai që kemi në duart tona..."

Të gjitha këto mendime kanë qenë shpifje, sepse për Mus'hafin e madhëruar (Kur'anin) nuk ndryshon shiiti e as suniti dhe nuk ka Mus'haf tjetër në të gjithë vendet Islame, i cili është i ndryshëm nga Kur'ani i parë, deri në

këto ditë.

Vetëm Muhamedi (a.s.) është i Dërguari dhe ai është pa dyshim krijesa më e mirë për myslimanët, askush nuk mund të afrohet në gradën e tij.

Ehlu Bejti janë pikë e krenarisë dhe e dëlirësisë që asnjë mysliman nuk mendon në urrejtjen e tyre.

Po qe se e lëmë këtë lloj përçarje, do të gjejmë mes myslimanëve grindje nacionaliste të tjera që nuk kanë mbështetje përveçse thirrjes së injorancës, sepse Islami nuk njeh dallimin mes bijve të tij, indianë, turq, persianë, arabë, berberë...etj. Megjithatë, personat lakmitar nuk e çajnë kokën, kjo për hir të përçarjes së ymetit të madh, për nxitjen e konflikteve që nuk i shërbejnë masave, fesë dhe as bota nuk ka dobi prej tyre, por ata do të mbeten perde për lëvdata personale dhe budallallëqe raciste.

Të gjitha këto janë ogurzeza që bien mbi kokat e popujve dhe me to përkeqësohet çështja e besimit.

Kur trupi preket nga kanceri i gjakut, mes rruazave të kuqe dhe të bardha, ndodh një luftë e ashpër duke gëlltitur njëra-tjetrën, kjo sjell trupin të marrë rrugën e shpejtë për në varr.

Dhe, kur ymeti preket nga sëmundja e përçarjes, e keqja bie mes tyre, e çdo grup përpiqet për mposhtjen dhe dëmtimin e tjetrit e pastaj e gjithë qenia e tij shkon drejt vdekjes.

S'ka aspak dyshim se pjesa më e madhe e gjërave që të afrojnë tek Zoti, është largimi i myslimanëve prej këtyre katastrofave, afrimi i pjesëtarëve dhe xhematëve, pajtimi mes tyre deri sa të bashkohen për qëllimin e tyre të madh, e të realizojnë për mbarë botën "Mesazhin e tyre islam".

NEVOJA JONË PËR BASHKËPUNIM DHE VËLLAZËRIM

Hatibi i një xhamie m'u ankua se eprorët e tij ia kishin tërhequr vëmendjen duke e kritikuar.

I thashë: -Përse?

Tha: - Sepse unë në hytben e Fitër Bajramit kam dhënë fetva se, nxjerrja e vlerës së zekatit nuk e shlyen detyrimin e zekatit dhe kundërshtova Ebu Hanifen dhe mendimin e tij për këtë çështje.

I thashë: -Përse e ke bërë këtë gjë?

I zemëruar më tha: -Vendosa të ndjek medhhebin e të parëve (selefëve), a është krim kjo gjë?!

Iu përgjigja me qetësi: - Ti, pa dyshim që nuk je më i ditur për medhhebin e të parëve (selefëve) se sa shejkhul islam Ibn Tejmije, i cili e ka lidhur vendimin me përfitimin e fukarasë, duke e lejuar nxjerrjen e vlerës së zekatit, në qoftë se vlera e tij është më e dobishme dhe më e dashur për fukaranë. A e ke lexuar se çfarë ka thanë autori i Fet'hul Barit, Ibn Haxher El-Askalani për këtë çështje?

E kuptova se hatibi i fetvasë nuk ia kishte fort idenë për thëniet e dijetarëve rreth kësaj teme dhe megjithatë ai kishte vazhduar në kundërshtimin e medhhebit Hanefi dhe

Ebu Hanifes.

I thashë: - Në librin "Fikhu Zekat" të Karadavit, gjendet një përmbledhje e gjithë thënieve të transmetuara nga dijetarët tanë të mëdhenj për zekatin, dhënien e vlerës së tij dhe cilën prej tyre duhet zbatuar. Madje, edhe ti mund ta dish se, zekati është urdhëruar për interesin e fukarave, jo për mundimin e tyre dhe se Umer ibn Abdulaziz, i cili është kalifi i V-të rashidinë, ka nxjerrë vlerën e zekatit dhe sharja e tij është e ndaluar. Prandaj, ai dhe Ebu Hanife nuk kanë hapur ndonjë zgavër në fe kur kanë vepruar në këtë mënyrë.

Pastaj, mimberi është për dhikrin, përmendjen e Allahut dhe mbrojtjen e sheriatit të Tij dhe jo për të mbështetur një medhheb të veçantë ndaj një medhhebi tjetër. Çfarë të ka shtyrë e të ka mashtruar të sillesh kështu ndaj Ebu Hanifes e ta zhvlerësosh atë?!

Një koleg i yti në Kajro ka thënë "Shafiu, ai e ka prishur Kajron!" Një tjetër në Algjeri ka thënë "Maliku e ka gabuar Sunetin dhe nuk ka ditur ta ndjekë atë..."

Të katër Imamët e Mëdhenj, ata janë korifenjtë e të parëve (selefëve) dhe kompetentët e fesë. Përse e harroni edukatën ndaj tyre, ndërsa me të tjerët silleni të edukuar?!

Ka shumë prej nxënësve të dijes që sillen keq ndaj të parëve (selefëve) në emër të selefizmit dhe unë për këtë ua tërheq vëmendjen këtyre pseudonxënësve me dije të mangët.

Do të kishte qenë më mirë për këtë folës që ta studionte xhematin e xhamisë, t'i gjente të varfrit, të cilët janë bllokuar në rrugë të Allahut dhe nuk ia shtrinë dorën askujt për të lypur, e t'i orientonte ndaj atyre pasanikët dhe bamirësit, sepse po të japin para në vend të elbit nuk e zhvlerëson

kontributin e tyre dhe nuk e prishin unitetin.

Me të vërtetë kemi korrur përçarje dhe armiqësi prej njerëzve me gjuhë të verbra. Nuk gjej ditë, ku myslimanët të jenë kaq të varfër për bashkëpunim dhe vëllazërim se në këto ditë të turbullta. Prandaj, le ta kenë frikë Zotin hatibë që dëmtojnë më shumë se sa bëjnë dobi dhe le të lexojnë më tepër, pasi kemi dëgjuar se dikur kanë thënë “Dituria është nur, dritë”.

ALLAHU I DO PUNËT E LARTA

Një njeri i mirë më dhuroi një palë tesbih të bukur për t'i përdorur ato pas namazit. I pranova prej tij duke e falënderuar, pastaj u ktheva në shtëpi dhe ia dhurova mbesës time.

Pas disa ditësh burri në fjalë më tha: -Nuk të kam parë duke i përdorur tesbihët që t'i dhurova.

I thashë: -E vlerësoj shumë dhuratën tënde, por dhikret e kërkuara pas çdo namazi, që nuk marrin kohë më shumë se dy-tre minuta, parapëlqej t'i bëj me gishta dhe nuk kam nevojë për numërues.

Aty afrohet një djalë i ri, i cili po e ndiqte këtë bisedë të këndshme dhe më thotë: -Përse nuk i thua se tesbihët janë bidat?!

Iu përgjigja duke i thënë se, ai nuk e konsideron farz të detyruar dhe se, unë nuk jam prej atyre që e zënë kohën me gjëra të vogla.

Më tha: -Cili është mendimi yt për përfundimin e leximit të Kur'anit me fjalën: "Sadakall-Llahul Adhim"?

I thashë: -Lutem për atë që e thotë të jetë i singertë në leximin e saj.

M'u përgjigj: -Nuk të kuptoj, çfarë do të thuash?!

I thashë: -Dikur, besimtarët për punë të rëndësishme dhe çështje madhore thoshin: "Dhe, kur besimtarët i panë grupet (ahzabët) thanë: "Kjo është ajo që na premtoi Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe Sadakall-Llahu dhe i Dërguari i Tij..."²² dhe në një vend tjetër thuhet: "Thuaj: Sadakall-Llah!", shpresoj që lexuesi të ndiejë frikë dhe respekt për Kur'anin, ta vlerësojë udhëzimin, ta njohë fuqinë e mrekullisë së tij dhe ta thotë atë fjalë nga thellësia e zemrës.

Më tha: -Nuk ka asnjë urdhër për këtë gjë.

Iu përgjigja: -Dhe, gjithashtu nuk ka asnjë ndalim për të...

Atëherë m'u përgjigj: - Ti tregohesh i butë ndaj bidatit.

I thashë: -Bile, unë nuk e përfilli aspak zënien me gjëra të vogla... Një njeri, të cilin e shikon duke kërkuar ndihmë për një mizë që e ka sulmuar, ai njeri nuk është me mend në rregull, sepse po të njëjtin e shikon duke ikur kur atij i vërsulet sorra...

I zemëruar vazhdova duke i folur: -Në botë, të mëdhenjtë janë mbledhur për t'i zhdukur të dobëtit, injorantët për t'i groposur dijetarët, të paaftët për t'i poshtëruar vullnetfortit dhe politikanët mundohen që t'ju zënë mendjet tuaja me të tilla llumra. Politikanët e botës e kanë perfeksionuar planin e tyre në asfiksimin e Islamit dhe çrrënjosjen e shtyllave të besimit. Ata kanë depërtuar në tokat islame me qëllim për ta zhdukur Islamin, ndërsa ju, në prag të greminës së shkatërrimit dëshironi që ummetin ta zini me të tilla ndryshime juridike nëpër degët e adhurimeve, apo ndryshimeve leksikore në kuptimin e fjalëve.

22. Ahzabë: 22.

Çfarë jeni ju? Me të vërtetë ju jeni pasardhës të havarixhëve të kësaj kohe pirate?!

Ku janë nyjat e besimit, morali i lartë dhe vendosmëria në punë?! Ku janë të zotët e mendjes?!

Unë i këshilloj thirrësit dhe edukatorët duke iu kujtuar hadithin: "Allahu i do punët e larta dhe i urren punët e pakuptimta."

SËMUNDJET E ZEMRËS

Adhurim i vërtetë ndaj Allahut është të gërmosh në vetvete e të mos lësh gjë të shtrembër, duke e drejtuar atë drejt së mirës, ta largosh të keqen nga ajo, të fshish çdo lloj sëmundjeje kronike e të përkujdesesh për të çdo ditë, gjatë gjithë kohës, duke mos e lënë të vdesë, por ta pastrosh duke luftuar gjithnjë për të mposhtur të keqen ndaj saj.

Vetëkënaqësia është shenjë e të vegjëleve dhe të mbyllësh sytë ndaj saj, ndërkohë që i bën katër ndaj gabimeve të të tjerëve është rrugë e humbjes.

Kam parë disa grupime fetare, të cilët rendin duke numëruar gabimet e të tjerëve, por që në të njëjtën kohë ndaj gabimeve të tyre rrinë shumë larg, pothuajse e konsiderojnë veten të pagabueshëm.

Të krenohesh me të vërtetën është një gjë dhe vetëkënaqësia është një gjë tjetër. Të krenohesh me të vërtetën është ndjesi e mirësisë së Allahut, madhështi e suksesit të dhuruar, dëshirë për të përhapur këtë të vërtetë, në mënyrë që askush të mos privohet nga ajo, por të ndjejë keqardhje ndaj atyre që largohen dhe privohen prej saj.

Ndërsa vetëkënaqësia, është mendjemadhësi ndaj së

vërtetës, ndaj atyre që nuk e njohin dhe kanë dëshirë të çmëndur për t'i shkatërruar ato me plot inat. Ndërkohë që gabimet dhe veprimet e tyre të shoqëruara me epshe fshihen dhe lihen në harresë.

Mendo pak rreth këtij dialogu:

Një njeri i tha një tjetri: - Unë të dua për hir të Allahut.

Tjetri iu përgjigj: - Sikur të dish për mua çfarë unë di për veten time, do të më kishe urreyer për hir të Allahut.

Njeriu ia ktheu: - Sikur të dija për ty çfarë di ti për veten tënde, atëherë unë do të isha i zënë me ato çfarë di për veten time...

Besimtarin e mençur e zënë gabimet e tija dhe nuk merret me të metat e njerëzve. Ai e di se është i nevojshëm për Mëshirën e Lartë dhe në qoftë se ka mirësi më tepër se ata, atëherë kjo i konsiderohet barrë, jo vlerë.

Dituria e tepërt kërkon përpjekje më të mëdha, jo zgjatje ndaj krijesave dhe pusi ndaj tyre, sepse ka ardhur në hadith ku thuhet: "Një njeri tha: - Pasha Allahun, Allahu nuk e falë filanin! Allahu tha: "Kush është ai që ndërhyr në punët e Mia? Unë e kam falur atë dhe ta kam zhvlerësuar punën tënde".

Kujtoj kur një djalë i ri i zemëruar, apo duke më qortuar m'u afrua dhe më tha: - Ti qëndron me studentë me mjekra të rruara dhe studente të pambuluara me shami, njerëzit të shikojnë të buzëqeshur dhe jo të vrenjtur dhe nuk dëgjojnë prej teje asnjë urdhër, apo ndalesë. Përse nuk ka asnjë justifikim ndaj atyre që të urrejnë dhe përçmojnë e ti duke qenë në këtë gjendje?!

Iu përgjigja: - Nuk e besoj që të vrenjturit është prej veçorive të thirrësve. Unë, së pari u shpjegoj gjërat elementare të Islamit, në besim dhe në moral. Në qoftë se

fara është e mirë edhe frutat do të vinë në kohën e tyre. Ditën që njerëzit do ta njohin Zotin dhe lidhen me Të mbi parimin e dëgjimit dhe të bindjes, atëherë ajo çfarë ti kërkon, madje edhe më shumë se çfarë kërkon do të realizohet.

Ndërsa për çështjen e përçmimit tim, nuk di se çfarë të të them. E falënderoj Allahun, i Cili ka lëshuar perden e Tij mbi mua dhe nuk ju ka dhënë mundësi juve për t'më sulmuar.

Ju keni epsh që krijesat të diskreditohen, në mënyrë që të kënaqni veten tuaj dhe ky epsh është sëmundje më e ndytë se sa gjynahet, me të cilat i kritikoni njerëzit.

O biri im, kam frikë se me këto qëllime të errëta do të bëheni një e keqe për të tjerët.

Një gjynahqar zemërthyer është më i ndershëm se sa një predikues që mbikëqyr njerëzit.

VLERA E BURRAVE DHE E POPUJVE

Postet nuk prodhojnë gjeni dhe pasuria nuk krijon burra. Ndoshta një gjeni mund të zërë një post dhe të zbukurohet posti me të, ndërsa ai mund të mos duket mirë në të. Pasuria e madhe në duart e njerëzve është mjet për të bërë mirë e realizim i të drejtave dhe nuk është instrument për të lartësuar të papunët, apo për të mbuluar mendjelehtët.

Bindja m'u shtua për këtë të vërtetë duke vështuar gjendjen shkencore dhe financiare të Japonisë dhe gjendjen e popujve tanë në Lindjen e Mesme. Dheu i tokës japoneze nuk vlen për të prodhuar, nuk ka naftë dhe as hekur. Nuk ka minerale dhe as lëndë djegëse. Por, mineralet njerëzore të njeriut japonez mbizotërojnë mbi gjithë këtë varfëri.

Ata filluan të blejnë naftë nga vendet e pasura, lloje të ndryshme mineralesh për të cilat kishin nevojë në industri dhe filluan të prodhojnë e të prodhojnë, derisa mallrat japoneze pushtuan botën e vjetër dhe të re. Cilësia dhe marka e tyre kishin epërsi ndaj gjithë mallrave derisa tregjet e tjera u mbushën prej këtij pushtimi ekonomik duke i bërë ballë me të gjitha mënyrat. E gjitha kjo ndodh, ndërkohë që ata të cilët zotërojnë tokën e pasur dhe potencialet e mundshme nuk bëjnë asgjë.

Baza e parë për çdo rilindje është njeriu dhe jo ajo që është poshtë këmbëve të tij e as ajo që ndodhet sipër kokës. Prandaj, edhe drejtimi i të Dërguarve, që në ezel (zanafillë) ka qenë për ndryshimin e qenies njerëzore. Janë drejtuar për të rafinuar mineralin e këtyre qënieve e për të ditur aftësitë që kanë dhe kur të arrihet kjo, atëherë t'i lejojnë që mbi këtë sipërfaqe toke të bëjnë mrekullira, duke zaptuar lindjen e perëndimin.

Akoma vazhdoj të hedh vështrimin tim nga thënia e Kur'anit famëlartë në përshkrimin e të Dërguarve të mëdhenj, duke i cilësuar si njerëz të punës dhe të mendjes.²³

Imani është mendja e besimtarit dhe ai nuk ekziston në qoftë se mendja humbet. Ai është dorë e aftë dhe nuk ekziston në qoftë se ajo ndërpritet. Kështu që edhe në popujt islam, kur dituria e tyre pakësohet dhe prodhimi bie, Islami nuk e largon prapambetjen që kanë.

Disa analistë më shqetësuan duke thënë se qytetërimi është transferuar në Lindjen e Largët dhe në Azinë Jugore.

Mendova me vete se përse të mos kthehet aty ku ka filluar, në Lindjen e Mesme dhe në popullin arab? Përgjigjja ishte e trishtueshme, ndoshta dhe poshtëruese... Ne, në pistën e prodhimit jemi dembelë, të tjerët prodhojnë për ne dhe ne nuk prodhojmë për veten tonë. Edhe në fushën e dijes dhe të shkencës, ne jemi sërish importues dhe jo eksportues.

Cila është arsyeja e këtij pozicioni prapambetës?

Arsyeja është se, ne kujdesimi për zbukurimin e jashtëm dhe nuk interesohemi për mbështetjen e të brendshmes, ose që të shprehemi më saktë, ne nuk punojmë për reformimin

23. (Shiko ajetin 45 të sures Sad: "Përkujto robërit tanë, Ibrahimin, Is'hakun dhe Jakubin, të punës dhe të mendjes." (L.H)

e qenies dhe ndryshimin e saj për të pastruar sëmundjet që ka, ndërsa Libri ynë thotë: "Me të vërtetë Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë veten e tyre."²⁴

24. Sureja Rad, ajeti: 11

REFUZOJ MUZIKËN

Kur mbaj ndonjë seminar kërkoj prej auditorit, që pyetjet e tyre të jenë rreth temës, në mënyrë që biseda jonë të mos shpërndahet në shumë drejtime. Megjithatë, pas një seminari me temë: "Mësimet e Mesazhit të fundit" m'u drejtua një pyetje, autori i së cilës me këmbëngulje kërkonte prej meje të jepja mendimin e Islamit për muzikën.

Rrethanat më detyruan t'i përgjigjesha dhe i thashë: -Muzika (kënga) është fjalë, ku e mira është e mirë dhe e shëmtuara është e shëmtuar. Unë mund të dëgjoj një këngë me tekst të poetit Mahmud Taha, me kompozim të Muhamed Abdulvehabit, e cila më prek dhe i përsëris fjalët sipas melodisë. Pastaj, dëgjoj përsëri një këngë tjetër, "Kleopatra" prej të njëjtit poet e të njëjtit këngëtar dhe menjëherë e mbylli radion duke mallkuar tekstin, muzikën dhe radion...

Vazhdova duke thënë: -Sahabet, mes tyre edhe Pejgamberi (a.s), kur marshonin rrugës së luftës për t'u ndeshur me armikun, dëgjonin njerëzit duke kënduar "Pasha Allahun, sikur të mos ishte Allahu ne nuk do të udhëzoheshim, nuk do të besonim dhe nuk do të faleshim, prandaj na zbrit mbi ne qetësi dhe kur të takohemi na jep

fortësi", duke u kthyer kjo këngë ndezës i ndjenjave të tyre dhe lehtësim i vuajtjeve.

Pastaj thashë: -Me të vërtetë që zëri i bukur bën dhe devenë të shpejtojë, e nuk po i bën të lëvizin edhe burrat?! Kryesorja është përmbajtja fisnike dhe realizimi i mirë, ndërsa paturpësia, melodia boshe dhe zëri i zi, të gjitha këto janë mëkat.

U largova nga ai seminar i rëndësishëm, në të cilin derdha mund të madh duke thënë me vete "Ndoshta me këtë gjë Allahu u bën dobi atyre".

Pas disa ditësh më erdhi një person, i cili befas dhe me padurim më pyet: - Ke thënë që muzika lejohet?!

I thashë: -Ku e ke qëllimin?

Tha: -Vij menjëherë pas një simpoziumi fetar, në të cilin u tërhiqet vëmendja njerëzve nga vendimi yt për lejimin e muzikës, duke nxitur zemërimin e njerëzve kundër teje.

Nuk u nxitova t'i jepja një përgjigje të shpejtë, por mendja më shkoi menjëherë te disa zëdhënës islamë dhe tek kaosi i tyre mendor dhe psikologjik, më pas nisa t'iu përgjigjja duke i shpjeguar se çfarë ndodhi në atë fund seminari, i cili qenka harruar dhe e mira e madhe e tij paska humbur.

Atëherë i thashë: - Miku im, këtij folësit kundër meje i mungon amaneti i transmetimit, ose nderi i qëllimit, për këtë, gjykimin e tij ia lë Allahut në dorë. Është e drejta e tij të më kundërshtojë, por pasi të thotë me hollësi pamjen e mendimit të tij. Po, mund të thoshte "Unë e refuzoj komplet muzikën, të mirën dhe të shëmtuarën e saj, prandaj mos besoni asgjë tjetër, përveç kësaj". Por, të japë një imazh të paqartë të mendimit tim e të mbjellë në zemrat e njerëzve se unë nxis daullet e fyellin anembanë shoqërisë, kjo është

turp.

Bashkëbiseduesi më tha: - Do t'ia transmetoj këto që the.

I thashë: -Nuk duhet bërë një gjë të tillë, sepse kështu trumbetojnë disa njerëz, duke i zënë njerëzit me çështje dytësore dhe kanë dëshirë që me këmbëngulje artificiale të arrijnë deri te instancat e sigurimit. Kjo në mënyrë që të mos mbetet kohë për çështjet aktuale dhe të mos gjejnë vend në mendjet e tyre.

GUXIMI I ATYRE QË SULMOJNË SELEFËT

Ka disa njerëz, të cilëve kaderi nuk u ka dhënë ndonjë horizont të madh mendor, madje as edhe ndonjë sjellje të mirë. Ata hynë nëpër rrugët e jetës duke lëshuar bomba, të cilat nuk i zotërojnë vetëm se mendjeshkurtrit, njerëzit me natyra të çuditshme, egoistët, kritikuesit etj.

Gjëja e parë dalluese e këtyre njerëzve është mendimi se, përveç mendimit të tyre tjetër nuk ka. Për të tjerët nuk ka vend dhe në qoftë se ndodh ndonjë përplasje, atëherë vetëm këta duhet të jetojnë dhe mjerë për palën kundërshtare se çfarë i gjen. Ndoshta edhe zbukurohen me lexime dhe me ibadete për t'i ndihmuar në përçmimin e të mëdhenjve dhe zmadhimin e të vegjëleve.

A nuk u vra Umer ibnul Hatabi, udhëheqësi më i drejtë në histori nga njerëz të tillë?!

Transmeton Ibn Merdevejhi nga Mus'ab ibn Sead ibn Ebi Vekas (r.a) duke thënë: "Një njeri prej havarixhëve e vështroi babanë, Sead ibn Ebi Vekas (r.a) dhe tha: -Ky njeri është prej milletit qafir! Seadi i tha: -Gënjeshhtar! Unë kam luftuar popullin mohues! Dikush tjetër i tha: -Ky njeri është

prej më të humburve²⁵. Përsëri Seadi i tha: - Gënjeshhtar! "Ata janë, të cilët kanë mohuar argumentet e Zotit të tyre dhe takimin me Të, prandaj punët e tyre janë të shkatërruara..."²⁶

E vërteta është se mërzitja m'u shtua edhe më tepër duke parë këta mendjelehtë që flasin në këtë mënyrë të ulët për brezat e parë. Nëse është kështu, kjo mënyrë e ulët dhe e pasjellshme e tyrja bën që të sillen dhe të flasin keq edhe për heronjtë e çlirimit dhe atëherë a u mbetet popujve histori?!

A mund të gjejmë në historinë e popujve të tjerë ku një pastrues rrugësh të takojë ndonjë hero të popullit të tij dhe t'i flasë, apo të sillet në këtë mënyrë?! Pasha Zotin, Seadi dhe heronjtë tanë të tjerë kanë më shumë merita në fushën e heroizmit se sa kushdo tjetër, emrat e të cilëve sot shkëlqejnë. Regjistrat e të cilëve janë pastruar prej mangësive dhe krimeve të tyre, ndërkohë që punët e tyre fryhen e zbukurohen, në mënyrë që të shërbejnë si shembuj të mirë për brezat e tyre të ardhshëm.

I dërguari ynë (paqja e Allahut qoftë mbi të) ka përjashtuar prej xhematit të myslimanëve këdo që humb edukatën e duhur me të mëdhenjtë dhe me bindje mundohet t'ia ulë vlerën e tyre duke thënë: "Nuk është prej nesh, ai që nuk nderon të mëdhenjtë tanë, nuk mëshiron të vegjlit dhe nuk ia di vlerën e dijetarit tonë."²⁷

Sa të mira janë ato ndjenja kur nderon një të madh, zbulon kontributet dhe mirësitë e tij dhe i kërkon falje Zotit për ndonjë gabim që mund të ketë bërë. E sa të liga janë ato ndjenja kur nuk ia jep hakun atij që e meriton, madje mundohesh që t'i shtosh edhe gjëra kundër tij.

25. Pjesë nga ajeti kuranor, 103 i sures Keffh.

26. Sureja Keffh, ajeti: 105.

27. Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu duke thënë: hadith i mirë, i saktë.

Unë, i them këto gjëra, sepse kam parë disa grupe njerëzish, të cilët flasin për kolosët tanë, duke filluar që nga brezi i parë e deri në kohët e sotme, duke mos lënë sunet pa zvogëluar dhe gabim të tyre pa zmadhuar me mijëra herë.

Për interes të kujt është e gjithë kjo padrejtësi? Për llogari të kujt ymeti ynë duket i varfër, ndërkohë që në botë të dobët mundohen të shëndoshen?!

EDUKATA NDAJ DIJETARËVE

Prej gjërave të këqija, siç thotë një shprehje e urtë e popullit, është: "Komshiu i keq kur shikon diçka të mirë e varros, ndërsa kur shikon diçka të keqe e përhap atë."

Gjithashtu prej gjërave të këqija është edhe lexuesi i keq, i cili lexon biografite e njerëzve dhe nuk ndalet, përveçse të të metat dhe gabimet që i janë veshur atyre. Ndërsa ndaj lavdërimeve dhe falënderimeve që Zoti u ka dhënë atyre dhe të mirave që ata u kanë bërë njerëzve, ky lexues është indiferent. Më e keqja është se kjo sëmundje shpirtërore përhapet te ne myslimanët.

Për Napolon Bonopartin janë shkruar me dhjetëra libra. Sa libra janë shkruar për Halid ibn Velidin, apo për Salahudin Ejubin?! Napoloni ka qenë njeri i luftës dhe kaq. Ka mashtruar, ka bërë zullum dhe ndonjëherë ka ndërje keqardhje. Ky njeri nga ana e sjelljeve dhe e strategjisë ushtarake është shumë larg rangut të Halid ibn Velidit.

Me gjithë këtë, populli i tij ka ngulitur tiparet më të mira të tij dhe i ka varrosur tipare të këqija. Prandaj, nuk përmendet gjë tjetër rreth tij, veçse që ai ka qenë gjeni me dhunti të mëdha.

Historia jonë është e mbushur me njerëz të mëdhenj në çdo fushë, por ne jemi punësuar të mbulojmë të mirat e tyre. Sikur këta njerëz të mos kishin lënë trashëgimi dhe gjurmë të gjalla, kurrë nuk do të ishin zbuluar prej grumbullit të dheut, i cili u është hedhur për t'u harruar që në kohë të largëta.

E them këtë, sepse unë kam parë burra të mëdhenj, të cilët janë shfaqur në shekullin e fundit, por kritikant dhe sulmet i ndjekin nga çdo anë dhe akuzat ndaj tyre sa vinë e shtohen e mbrojtësit e tyre janë të shqetësuar.

Kam takuar njerëz që janë të vetëkënaqur me njërën prej reformatorëve, të cilët mendojnë se qielli nuk nxë tjetër, përveç tij. Lavdi i qoftë Zotit që qielli është i pafund, por përse përpiqemi të shuajmë të tjerët?!

I thashë një mikut tim: -Kam mësuar dhe akoma vazhdoj të mësoj prej imamëve të ndryshëm. Lexoj prej Ebu Hanifes, imamet të mendimit. Lexoj prej Ibn Hanbelit, imamet të transmetimeve dhe prej Ibn Tejmijes. Lexoj prej Ebu Hamid El-Gazalit dhe Ibn Sinës, njëri filozof dhe tjetri predikues. Lexoj prej Ibn Atailah dhe Ibn Abdulberit. Lexoj në fushën e artit dhe të letërsisë prej Ebi Tajibit, Ebi Atahije, Ukadit dhe Rafiut, me gjithë luhatjet mes të dyve.

Allahu i Madhëruar e ka shpërndarë bukurinë e mendimit, zbatimit, sjelljes dhe moralit te shumë njerëz dhe duhet të përfitojmë prej dhuntive të Zotit nëpër krijesat e Tij.

Kërkimi i zbulimit të të metave dhe gabimeve të njerëzve të mëdhenj, pastaj publikimi i tyre për të ulur dhe çenuar vlerat dhe kontributet e tyre, të gjitha këto nuk më vlejnë, nuk ma largojnë neverinë dhe nuk ma ndreqin shtrembërinë time.

Dëgjova një djalosh duke folur me kritika të ashpra për njërin nga Imamët e mëdhenj. E vështrova me habi, kur ai tha: "Edhe ata njerëz si ne kanë qenë."

I thashë: -Unë ty nuk të besoj të më lexosh saktë një gazetë të ditës, por nga e merr gjithë këtë trimëri të pretenduar? O biri im, edukata e Islamit, siç na ka treguar Pejgamberi (a.s) thotë: "Nuk është nga ne ai që nuk respekton të moshuarin, nuk mëshiron të voglin dhe nuk ia di vlerën dijetarit tonë." Prandaj, le të jemi të edukuar me kolosët tanë...

KONCEPTIM I RREMË PËR ISLAMIN

Disa ajete kërkojnë maturi dhe thellësi mendimi në mënyrë që të qartësohet kuptimi i tyre, veçanërisht në qoftë se gabimi në to përbën rrezik të madh për jetën shoqërore. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "Pasuria dhe fëmija janë zbukurim i jetës së kësaj bote, ndërsa veprat e tjera të vlefshme dhe të mira janë shpresë dhe shpërblim te Zoti yt."²⁸

Ky krahasim nuk është bërë ndërmjet dy të kundërtave përballë njëra-tjetrës, sepse ndoshta i privuar nga pasuria dhe fëmija nuk ka për të ahiret dhe ndoshta i kënaqur me pasuri dhe fëmijëtek Allahu ka gradë të lartë...

Njerëzit e thjeshtë mendojnë se atyre që u është dhënë pasuri dhe fëmijë nuk kanë vend tek Allahu, ose vendi i tyre do të jetë i ultë aq sa u është dhënë mirësi në dynja, sikur varfëria është kusht për të hyrë në xhenet dhe fitore për një përfundim të mirë.

Ky është një konceptim i rremë ndaj Islamit, i cili që përhapur përgjatë disa brezave duke fundosur shtetin e ymetin dhe duke humbur fenë e dynjanë së bashku...

28. Sureja Kehf: 46

Ajo, që Islami refuzon është lakmia, pangopësia e tepruar për këtë jetë, topitja nga ajo që ndodhet pas saj dhe mungesa e përgatitjes për të. Ndërsa në qoftë se njeriu furnizohet me kapital e pasuri dhe me to mbështet pozicionin e ymetit në botën e ekonomisë, kontribuon më shumë se të tjerët duke mbuluar dhe plotësuar nevojat e saj, padyshim që gjithë veprimtaria e tij, gjerë e gjatë llogaritet prej veprave "të tjera të vlefshme".

Një njeri i tillë duhet të merret si shembull, madje shpresë e dëshiruar dhe vend i kërkuar, madje kjo gradë e tij duhet të kihet zili, ashtu siç ka ardhur në hadithin e saktë²⁹...

Ah, sikur myslimanët, një numër i madh i tyre të ishin prej këtyre biznesmenëve të suksesshëm, me të cilët të mbrohet thirrja dhe të mundesh të mbështetesh në kontributin dhe mirësinë e tyre!

Ky lloj i lartë është gjë tjetër ndaj atij lloji, i cili ka ardhur në këtë ajet: "Dhe, mos i hidh sytë tek ata, të cilëve Ne u kemi dhënë kënaqësi palë-palë të zbukurimeve të kësaj bote për t'i sprovuar me to. E, risku i Zotit tënd është më i mirë dhe i përhershëm."³⁰

Të tillë njerëz kanë harruar Allahun dhe takimin e Tij, duke u zhytur në kënaqësitë e dynjasë të përkohshme e duke mos grumbulluar asgjë për të nesërmen e tij. Ndoshta besimtari i varfër e shikon atë dhe mashtrohet prej mirësisë së tij të dukshme dhe fillon e shqetësohet për gjendjen e vështirë që ka. Prandaj edhe është ndaluar të hedhë këtë lloj shikimi të shkurtër dhe i tërhiqet vëmendja prej këtij mashtrimi të papërfillshëm.

29. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nuk lejohet zilija, përveçse në dy gjëra: Personit, të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon atë, ditë natë (në rrugën e Allahut)..."

30. Sureja TaHa: 131

Kam parë disa injorantë, të cilët as që duhet të lejohen të flasin për Islamin, e gurëzojnë shoqërinë me gjurmë që nuk i kanë kuptuar dhe nuk dinë asgjë për ndërlikimet dhe argumentimet e tyre, duke u thënë njerëzve "Banorët më të shumtë të zjarrit janë të pasurit. Gjithashtu edhe femrat janë pjesa më e madhe e banorëve të tij, duke lënë për të kuptuar se pasuria dhe femërorja janë mëkat..."

Këto janë fjalë boshe, me kuptim e ndikim të shëmtuar, por tashmë ka ardhur koha që të distancohemi prej tyre dhe t'i këshillojmë ata që i thonë e i pohojnë, të heshtin e të pendohen.

DITURIA E RREME LËKUND YMETIN DHE I SHËRBEN KOLONIZATORIT

Rilindja bashkohore islame është e kërcënuar nga armiq të shumtë, por e habitshme është se armiku më i rrezikshëm është një lloj mendimi fetar të cilit i vishen rroba selefizmi, ku ata janë më larg se askush tjetër prej selefëve. Ajo është pretendim selefist dhe aspak selefizëm i vërtetë.³¹

Dashuria për selefët konsiderohet fe, ndërsa urrejtja e tyre është hipokrizi.

Ata janë shtyllat e qytetërimit tonë dhe mësuesit e mesazhit. Për këtë ne duhet të sillemi mirë me ta dhe t'i mbrojmë nga çdo gjë që përdhos personalitetin e tyre.

Një ditë isha duke folur për një temë jo të rëndësishme dhe në atë kuvend ndodhej një njeri i cilësuar si selefist. Gjatë bisedës më shpëtoi një fjalë e dyshimtë që nuk kisha për qëllim asgjë... Sillem, kur personi në fjalë po llogariste me veten e tij ecurinë e idesë sime duke parashikuar se unë do ta tejkaloja më shumë atë fjalë të dyshimtë. Mprehu dhëmbët dhe u përgatit për të sulmuar... Por ndodhi që biseda mori drejtim tjetër dhe ndjeva që personit i erdhi

31. Ky artikull është marrë nga libri "Sekreti i prapambetjes së arabëve dhe muslimanëve" botimi IV, viti 2000.

keq që unë shpëtova prej tij.

E thërrita: - O vëllau im!

M'u përgjigj: Çfarë kërkon?

I thashë: - Të vura re që ishe përgatitur për të luftuar, pastaj "Dhe All-llahu ua largoi luftën besimtarëve"... Tha: - Po, mendova se do të thuash atë që unë nuk jam dakord për të...

I thashë: - Ju jeni në pritje të gabimeve për të ngrënë të zotët e tyre e në qoftë se ju shpëtojnë, ndjeni keqardhje. Këto o miku im nuk janë prej moralit të besimtarëve. Tek ju janë mbledhur disa cilësi urrejtjeje, sfide, smire dhe gjurmimi të të metave të pafajshmëve e të gjitha këto janë të refuzuara në fenë tonë...

M'u përgjigj: - Ne mbrojmë sunetet dhe luftojmë gjërat e shpikura, por njerëzit kundërshtojnë dhe marrin bidatet, ndërsa ajo që ne na akuzojnë (gjuajnë) me to, janë të pavërteta...

Atëherë i thashë: - Ah, sikur puna të ishte kështu. Ju sulmoni medhhebet juridike (të fikhut) dhe mohoni vlerat e imamëve, krijoni hendeqe të mëdha mes njerëzve në emër të selefizmit, ndërsa dituria e vërtetë nuk e pranon këtë metodë..

Tha: - Ne refuzojmë pasimin e medhhebeve dhe i mësojmë njerëzve si të marrin drejtpërsëdrejti nga Kur'ani ose Suneti. A e refuzon ti këtë?

I thashë: - Nuk ka mysliman që refuzon lidhjen me librin e Zotit të tij dhe sunetin e Pejgamberit (a.s.) dhe përfytyrimi juaj se fihku i medhhebeve i merr argumentet nga një burim tjetër përveç Kur'anit dhe Sunetit, nuk është i saktë.

Është plotësisht e mundur që dijetarët janë të vendosur

të diskutojnë disa çështje e të njohin ato argumente të cilat kanë ardhur për këtë çështje, të nxjerrin ato dispozita që njeriu qetësohet me to dhe e gjithë kjo brenda rrethit të vëllazërisë, dashurisë dhe të drejtës së krijesave...

Katër dijetarët më të mëdhenj janë shembull i lartë i respektimit të Kur'anit dhe Sunetit dhe asnjë mysliman nuk kritikohet po qe se ndjek ndonjërin prej tyre, ashtu siç edhe ju nuk kritikoheni në pasimin e Shevlanit, Albanit, San'anit ...etj.

Tha: - Këtë e themi edhe ne.

I thashë: - Jo, ju shikoni vetëm mendimin tuaj, të cilin e keni marrë si të saktë dhe e keni pasuar nga "dikush", pastaj filloni sulmin ndaj atyre që e kundërshtojnë atë, duke e konsideruar si të dalur nga Suneti. A thua suneti qëndron vetëm tek ju dhe te askush tjetër?!

Dëshiroj që ta dini se ixhtihadi fikhori (interpretimi i dispozitave), i saktë apo i gabuar, është i shpërblyer e se çështja nuk përmban në vetvete armiqësi e përçarje. Edhe sikur të pranojmë se ajo që ju keni është e sakta, atëherë ata që ndryshojnë nga ju janë të privuar nga shpërblimi i Zotit xh.sh.?! Përse pra dëshironi t'ua vështirësoni dhe t'i nxirrni nga rrezja e selefëve, e të mbetet monopol i juaji? Për mendimin tim tragjedia është "morale" jo shkencore dhe më mirë për ju do të ishte që të përuleni përpara Zotit e të rregulloni nijetin tuaj me Të, t'i besoni vëllezërve tuaj besimtarë dhe të mendoni mirë për ta.

Në qoftë se ju jeni dakord me mendimin tim, atëherë edhe e drejta e të tjerëve është që dhe ata të bien dakord me kundërshtarët e tyre. Nuk ka vend për luftë, goditje dhe as për kontradikta fikhore, e as nuk është problematike. Mëkati qëndron në sektarizmin e ngushtë medhhebi.

Dijetari islam është i gjerë, dhe medhhebi i cili e ngushton atë është një vend që mban edhe të tjerë. Ajo e cila kalon është një kohë që mban edhe kohëra të tjera.

Udhëheqësi i mëparshëm i selefëve në Egjipt, Shejkh Hamid Fekij u betu në Zot se Ebu Hanife është qafir.

Unë në një libër timin kam kritikuar për një seminar që është zhvilluar në lagjen Zejtun të Kajros me temë "Ebu Hamid El-Gazali qafir" dhe vendi në të cilin u zhvillua ky seminar ishte vendodhja e selefizmit.

Studentët selefist këtu, në universitetin "Emir Abdul Kadir" në Algjeri thonë për imam Malik ibn Enes se ai i jep përparësi veprave të banorëve të Medines ndaj hadithit të Pejgamberit a.s.

U thashë atyre se kjo është gënjeshtër, sepse imam Maliku (r.a), ka pasur mendimin se veprat e banorëve të Medines janë më argumentuese sesa suneti i Pejgamberit (a.s), me hadith "ahad" që ndoshta mbahen mend ose harrohen, qëllohen ose gabohen...

Ky qafirizëm i sëmurë e i stërmunduar nuk ka përfundim tjetër përveçse në copëtimin e ymetit që po lëngon prej plagëve e pretendimi se kjo është selefizëm është një lloj mashtrimi dhe guximi...

Tre gjëra të hidhura kam vënë re nga kjo dituri e rreme:

E para: Disa studentë të cilët nuk dinë mirë "I'rabin" (analizën e fjalisë) e thonë për katër imamët: "Ata janë njerëz dhe ne jemi njerëz..."

Thashë: - Populli anglez nuk e përmendin kryeministren e tyre në këtë mënyrë nënvleftësimi...

Ah ndjenjat e mia, po çfarë është kjo sjellje ndaj fjalës të së Dërguarit tonë a.s.: (Nuk është prej nesh ai që nuk respekton të madhin, mëshiron të voglin dhe nuk ia din vlerën dijetarit tonë). (hadith sahih)

E dyta: Disa njerëz punëtorë të thjeshtë ose bujq duke neglizhuar në punët e tyre të zanatit janë mjaftuar për të vërtetuar fetarizmin e tyre me rroba të shkurtra, mjekra të shkujdesura, me bastun (shkop) në dorë ose çallma me bisht, kur "myftinia" u ka dhënë leje mbajtësve të saj...

E treta: Rreziku i saj është më i madh sepse agjentët e Rusisë dhe të Amerikës janë gjithmonë zgjuar në luftë kundër Islamit, të zotë në shuarjen e rizgjimit të ri. Ata përpiqen në shfaqjen e grupeve ekstremiste dhe në anashkalimin ndaj veprimtarive të tyre, sepse ato janë një pamje e ulët për Islamin, thirrje e vërtetë kundër tij, shkatërrim i unitetit dhe formim i grupacioneve...

Për këtë shkak luftojnë mendimin mesatar, ose Islamin e saktë dhe eliminojnë pasuesit e tij, në kohën kur ekstremistët lihen të lirë të nxisin probleme (trazira), duke ndezur luftëra të brendshme që zhdukin Islamin dhe të ardhmen e tij dhe ky është sekreti i përhapjes së tyre në Azi dhe Afrikë.

Ata, në qoftë se triumfojnë, do të zhdukin Islamin në djepin e tij me mendjet e tyre të shkurtra, prandaj le ta lënë realizimin e kësaj gjëje.

Ta kalojmë bisedën rreth fikhut (dispozitave) të çështjeve dytësore, tek një bisedë tjetër me më pak vlerë.

Kam pohuar se hadithet "ahad" (me një transmetues) punohet me to në dispozitat fetare të ngritura mbi bazën e diturisë jo-absolute (ilmun dhannij) ose mendimit të zgjedhur (dhannun raxhih).

Një student më pyeti: - A ngrihet ndonjë punë mbi

bazën e mendimit (dhann)?

I thashë: - Dëgjoje me vëmendje fjalën e Zotit xh.sh.: "E në qoftë se ai (burri) e lëshon atë (për herë të tretë), pas atij (lëshimi) nuk i lejohet më derisa të martohet ajo me një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e lëshon atë, atëherë për ata të dy, po qe se mendojnë se do t'i zbatojnë dispozitat e Allahut, nuk ka pengesa të rikthehen (në bashkëshortësi). Këto janë dispozita të Allahut që ia sqaron një populli që kupton." (Bekare: 230)

Punët dhe gjendjet e njerëzve që kanë lidhje me vendime në pjesën më të madhe ngrihen mbi bazën e zgjedhjes së tyre (terxhih), ashtu dhe hadithet "ahade" që janë konfirmuar në çështjet e gjakut, pasurisë (pronave) dhe moralit janë të ngritura mbi këtë bazë...

Ndërsa bazat e besimit dhe shtyllat e tij burojnë nga argumente absolute si në konfirmim ashtu edhe në argumentim. Me këtë gjë janë në konsensus e gjithë masa e imamëve.

Studenti, që më dukej se ishte selefi, tha: Hadithi "ahad"³² është burim në besim (itikad).

I thashë duke e përmbledhur shkurtimisht: Në fenë tonë nuk ka besim (akaid) që ngrihet mbi bazën e hadithit "ahad".

Besimet tona, të gjitha ato janë të konfirmuara me argumente absolute (të pa kundërshtueshme), që nuk lënë vend për diskutim (debat).

Hanefitë janë të mendimit se hadithi "ahad" nuk mund të shërbejë për të konfirmuar një obligim në veprat dytësore (furu'ë), sepse obligimi tek ata konfirmohet vetëm

32. Hadith ahad - hadith i transmetuar nga një person, ose më shumë por që nuk ka të plotësuar kushtet e ditorisë së saktë, d.m.th mund të ketë edhe kundërshti. (L.H)

me argumente të pa kundërshtueshme (kat'ij) që nuk ka dyshim në të, atëherë si të imagjinojë konfirmimin e tij në besim (akide) refuzuesi i së cilës quhet mohues (qafir)?

Por studenti selefi tha: -Kurtubiu është esh'ari dhe ai është prej mufesirinëve që anojnë nga komentimi (te'vili), ai i ngjan Razit e Gazalit, të cilët janë bidatçi (mubtedi) dhe feja Islame nuk merret prej tyre...

E kuptova se djali ishte i mbushur me injorancë dhe se ai ishte sikur të tjerët prej atyre që pretendojnë selefizmin, ku toka nuk bën me to dhe as për ta...

FILLIMI I MUAJVE HËNORË

Ndryshimi i myslimanëve rreth fillimit të muajve hënorë është kthyer pothuajse në një shfaqje komike. P.sh. ka ndodhur që Fitër Bajrami, në disa vende është festuar në ditën e shtunë, në disa të tjera të dielën, e në disa të tjera ditën e hënë, etj.

Luhatjet në përcaktimin e hënës së re me dy ditë diferencë, apo tre është dhunim ndaj argumenteve dhe ndikimi i saj në unitetin islam nuk mund të mohohet. Neglizhimi i gjithë kësaj është barrë shumë e rëndë...

Lexova se një grup shkencëtarësh kishin llogaritur se hëna e re, shkencërisht do të lind në filan ditë, filan orë dhe se pamja e saj përpara kësaj është e pamundur. Pas shumë pak kohësh lexova se disa dëshmitarë e kishin parë me sy të lirë hënën e re.

Thashë: -Me siguri dëshmitarët duhet të jenë të paqartë, ose astronomët kanë gabuar, pasi nuk ka supozim tjetër të tretë...

Pa dyshim që hëna në orbitën e saj ecë me një shpejtësi precize, e cila nuk rritet dhe as nuk ngadalësohet. Ajo nuk e ulë hapin e shpejtësisë për të pritur ndokënd dhe as nuk e

rrit hapin në padurim të takimit me të. Kjo punë është ashtu siç e ka thënë Zoti ynë: "Ai është, i Cili e bëri diellin dritë dhe hënën shkëlqyese dhe i caktoi asaj fazat që të llogarisni numrin e viteve dhe përlllogaritjen. Këtë Allahu nuk e krijoi, përveçse me saktësi, hak ..." ³³

Fjalja e fundit është vendimtare se lëvizja e hënës kryhet me saktësi e jo në mënyrë të rastësishme. Në qoftë se kjo lëvizje e trupave qiellorë arrihet të zbulohet nga shkenca, me metoda bindëse e të sakta, atëherë nuk ka vend më për debat.

Mund të thuash nga ta marrim këtë bindje dhe siguri? Përgjigjem: -T'i kërkojmë komisionit të zbulimit të vërtetësive që t'i telefonojnë observatorëve në Uashington, Moskë, Londër, Paris dhe të njihet me kohën, në të cilën arrihet bashkimi mes hënës, tokës dhe diellit e të marrim një përgjigje të prerë rreth mundësisë së shikimit të këtij bashkimi. Atëherë, në qoftë se është e pamundur, ne refuzojmë çdo dëshmitar që pretendon se e ka parë hënën e re, duke u bindur se ky njeri ka imagjinuar dhe ka ngatërruar.

Bindja dhe siguria shkencore patjetër duhet të respektohet e çdo gjë krahas saj të mënjanohet. Në të vërtetë, unë ndjej konfuzion kur lexoj nëpër gazeta se astronomët janë të sigurt se është e pamundur të shikohet hëna e re, pastaj dëgjoj pas kësaj, hëna e re është parë në këtë apo në atë vend.

Unë kërkoj një hetim shkencor dhe botëror të kësaj tragjedie, ose të ndryshojmë observatorët dhe shkencëtarët tanë për mungesë vërtetësie, ose të procedojmë dëshmitarët, ku sytë e tyre kanë parë çfarë nuk ka lindur

33. Sureja Junus, ajeti: 5

në horizont meqë nuk vërtetohet ekzistenca e tyre. Heshtja ndaj kësaj kontradikte nuk lejohet.

A DO TË MËSOJNË NDONJËHERË THIRRËSIT?!

Në zyrën time hyri një vajzë, veshja e së cilës që në shikimin e parë nuk më pëlqeu, por në sytë e saj vura re një hidhërim dhe trishtim që më imponuan mëshirë dhe butësi ndaj saj. Vajza u ul dhe filloi të tregonte shqetësimet dhe ankesat e saj, duke shpresuar të gjente tek unë diçka të mirë.

E dëgjova gjatë dhe e kuptova se vajza ishte arabe dhe se ishte arsimuar në Francë e pothuajse nuk dinte asgjë nga Islami. Fillova t'i shpjegoj të vërtetat e fesë një nga një dhe t'ia largoja dyshimet që kishte. I përgjigjesha pyetjeve të saj dhe ia përgënjeshtroja shpifjet dhe gënjeshttrat e orientalistëve dhe të predikuesve, derisa mendova se ia arrita qëllimit, ose të paktën ia arrita asaj që doja. Gjatë bisedës sonë, nuk harroja ta përshkruaja civilizimin modern, i cili femrën e paraqet si një copë mishi përpara syve të uritur dhe se ajo në mjedisin e familjes nuk e njeh dëlirësinë, ngrohtësinë dhe qetësinë. Më pas, vajza më kërkoi leje të largohej, por njëkohësisht të më vizitonte përsëri.

Pas saj hyri një djalë, tek i cili shihej paraqitja e një fetari dhe me ashpërsi më tha: -Çfarë e ka sjellë këtë ndyrësi këtu?!

Iu përgjigja: -Mjeku pranon të sëmurët dhe jo të shëndoshët, kjo është puna e tij.

M'u përgjigj: -Sigurisht, e këshillove për hixhabin?!

I thashë: -Problemi është më i madh se kaq. Fillimisht duhet baza (themeli), pa të cilin nuk mund të vazhdohet më tej. Është besimi në Allah dhe në ditën e Gjykimit, bindja dhe nënshtrimi ndaj asaj që i ka zbritur Pejgamberit (a.s) në Kur'an, Suneti si dhe shtyllat e fesë pa të cilat Islami nuk mund të ekzistojë, si në fushën e adhurimeve, ashtu edhe në ato të sjelljeve dhe moralit.

Më ndërpreu duke thënë: -Të gjitha këto nuk e ndalojnë që ajo të vendosë hixhabin.

Me qetësi i thashë: -Nuk më gëzon fakti që ajo të vijë me rrobat e murgërisë, ndërsa zemra e saj është bosh prej njësimi të Allahut, ku jeta e saj të mos njohë rukunë dhe sexhden. Unë i mësova asaj bazat, të cilat e bëjnë atë vetvetiu të ndikojë në veshje dhe në paraqitjen e saj.

U përpoq përsëri të më ndërpresë, por i thashë prerazi: -Unë nuk di ta tërheq Islamin prej bishtit, ashtu siç veproni ju. Unë siguroj shtyllat së pari, mbi të cilat nis të ndërtoj, më pas me urtësi arrij atë që dëshiroj.

Pas dy javësh, vajza erdhi përsëri me rroba më të hijshme, madje mbi kokë kishte vendosur një vello të lehtë. Filloi pyetjet e saj dhe unë përgjigjet e mia, më pas nga fundi i bashkëbisedimit i drejtoj unë një pyetje: Përse nuk shkon në xhaminë më afër shtëpisë suaj?

Vajza m'u përgjigj: -Unë i urrej burrat fetarë dhe nuk kam dëshirë t'i dëgjoj ata.

E pyeta: Përse?

Tha: -Janë të ashpër dhe me zemër të vrazhdë. Ata sillen

me mua me përbuzje e ashpërsi.

Nuk e di pse, por në ato momente m'u kujtua Hindi, vajza e Ebu Sufjanit, e cila hëngri mëlçinë e Hamzait (r.a) dhe luftoi shumë kundër Islamit. Ajo nuk e njihte të Dërguarin e Allahut, por kur e njohu dhe u afrua tek ai, i besoi atij dhe i tha këto fjalë: "O i Dërguar i Allahut! Pasha Allahun, nuk ka pasur mbi sipërfaqen e tokës njerëz, të cilët kisha dëshirë t'i shikoja të përdhosur dhe të përbuzur më shumë se sa njerëzit e tu. Ndërsa sot, nuk ka mbi sipërfaqen e tokës njerëz, të cilët kam dëshirë t'i shikoj krenarë dhe të nderuar, më shumë se sa njerëzit e tu".

Dashuria e madhe, e cila rridhte nga zemra e Pejgamberit (a.s) i ndërronte zemrat nga një gjendje në tjetrën. Prandaj, a do ta mësojnë thirrësit këtë gjë prej të Dërguarit të tyre, duke zbutur në vend që të përçajnë e duke përgëzuar në vend që të largojnë?!

DUHET USHTRI PREJ THIRRËSISH

Popujt, të cilët ranë në kthetrat e pushtimit të romakëve dhe persianëve ishin pafund të dëshpëruar dhe të pashpresë se një ditë do të shpëtonin prej tyre.

P.sh, çfarë shprese kishte Egjipti, i cili qëndroi 500 vjet nën pushtimin romak, se do çlirohej e do të shpëtonte? Gjendja e tij e keqe dukej sikur ishte kthyer në kader prej të cilit nuk kishin nga t'ia mbanin. Kështu ishte gjendja edhe në brigjet e detit Mesdhe, vendet e të cilit mbetën të pushtuar me vite e shekuj të tërë duke u kthyer në një pellg romak.

Megjithatë, shokët e Muhammedit (a.s) vetëm ata ishin të cilët thyen dyert e këtij burgu dhe u thanë të burgosurve të mjerë "Dilni, tani jeni të lirë".

Ajo që ndodhi në atë kohë, me të vërtetë ishte mrekulli që askush nuk mund ta bënte, përveç se shokët e Muhammedit(a.s.), paqja e Allahut qoftë mbi të. Kjo, sepse ata iu nënshtruan vetëm Allahut dhe u ç'veshën prej dekorimeve të kësaj jete dhe epsheve të dynjasë. Ata u ndikuan prej hapave të Pejgamberit të tyre, i cili jepte dhe nuk merrte, ringjallte dhe nuk mbyste, bënte thirrje për ahiretin dhe mbizotëronte mbi këtë të përkohshmen.

Vetëm të tillë thirrës ia ndryshojnë pamjen botës, të cilët ranë dëshmorë gjatë përhapjes së Islamit, 1/4 e sahabeve. Ata që mbetën gjallë prej tyre e vunë jetën në shërbim të përhapjes së Islamit me moralin e bukur, me adhurimin, me përhapjen e diturisë dhe me shembullin e tyre të mirë. Pra, kush vdiq, vdiq për Allah dhe kush e pat jetën e gjatë, jetoi për Allah, duke patur rezultate të mahnitshme, saqë të gjithë popujt që e pranuan Islamin, jo vetëm u larguan prej idhujtarisë dhe politeizmit të tyre, por u shndërruan në krijesa të tjera. Krijesa që u thoshin çliruesve "Në qoftë se ju vononi, atëherë do ta marrim ne në dorë thirrjen dhe do ngremë lart pishtarin e saj.

E gjithë kjo mirësi e tubuar dhe gjithë ky ndikim i madh shpërtheu prej një zemre të vetëm, zemrës së zotërisë së Mesazhit të Fundit.

Ishte parashikuar plotësisht se çfarë do të ndodhte. Mendo rreth këtij transmetimi prej Pejgamberit (a.s): "Do të vijë një kohë ku një grup njerëzish do të luftojnë dhe atyre u thuhet: A ka në mesin tuaj sahabe, shokë të të Dërguarit të Allahut? Përgjigjen: Po. Atëherë atyre iu hapet rruga. Pastaj do të vijë një kohë tjetër ku përsëri një grup njerëzish do të luftojnë dhe atyre do t'u thuhet: A ka në mesin tuaj shokë të shokëve të të Dërguarit të Allahut? Përgjigjen: Po. Atëherë edhe atyre iu hapet rruga. Pastaj do të vijë një kohë tjetër ku përsëri një grup njerëzish do të luftojnë dhe atyre do t'u thuhet: A ka në mesin tuaj shokë të shokëve të shokëve të të Dërguarit të Allahut? Përgjigjen: Po. Atëherë edhe atyre iu hapet rruga."³⁴

Ky dialog nuk ka ndodhur dhe as historia nuk ka folur për të, por është përshkrim i punës së zemrave të mëdha

34. Transmeton: Buhariu dhe Muslimi

në botë. Ai është përshkrim i ndikimit të nxënësve dhe apostujve të Muhammedit(a.s) në mesin e njerëzve. Dhe, ai është përshkrim i gatishmërisë së popujve për t'i pritur me dashuri, me kënaqësi.

Ata lloj shokësh kanë qenë shkolla besimi dhe fanarë udhëzimi.

Nuk e mohoj faktin se pas tyre erdhën të tjerë që ndoshta edhe ata ecën në rrugë të mbarë dhe ia arritën atij qëllimi, por puna qëndron ashtu siç e përshkruan Kur'ani famëlartë: "Turmë prej të parëve dhe pakicë prej të mbramëve."³⁵

Ajo që unë shikoj më duket se errësira e vjetër është kthyer dhe askush nuk mund t'i davarisë ato re, përveç se një ushtri e madhe prej udhëzuesve të parë, prej atyre, të cilët rifreskojnë rrugën e të parëve çlirues.

35. Sureja Vakia, ajeti: 13-14

SI PËSUAN DISFATË ARABËT

Hebrenjtë i luftuan banorët e Palestinës edhe përpara se të krijonin shtetin e tyre, por kurrë nuk arritën të fitonin kundër tyre. Sikur të mos ishte ushtria angleze, me këmbësori nga toka dhe marinarë nga deti, për hebrenjtë do të ishte e pamundur të qëndronin në tokën e shenjtë.³⁶

Pastaj u erdhi radha ushtrive arabe, sipas një plani të fshehtë ndërkombëtar, pasi hebrenjtë shpallën shtetin e tyre, të përgatitur ushtarakisht duke bindur botën se ata janë të aftë të fitojnë luftën.

Rrethimi i hebrenjve ndodhi befasisht. Tel Avivi po shkonte drejt rënies.

Në këtë moment ndërhyu OKB-ja duke imponuar një paqe të detyrueshme, e cila do t'u nevojitej hebrenjve për të marrë ndihma nga bota e krishterë dhe ajo komuniste.

Lufta rifilloi sërish. Ushtritë arabe ishin plotësisht të afta të fshijnë një herë e përgjithmonë shtetin e sapolindur, por udhëheqësit arab, sipas planit të fshehtë të paravendosur, ndalën luftën. Kështu, Egjipti u mor me lëvizjen islame,

36. Ky artikull është marrë nga libri "Humumun daije" të shejkh Muhamed El-Gazaliut.

ndërsa Iraku refuzoi që ushtrisë t'i japë urdhër për të përparuar drejt Tel-Avivit, edhe pse ishin shumë afër, duke i dhënë kështu mundësinë gjeneralit anglez, Glob, në frontin e Jordanisë t'u dorëzojë hebrenjve Ludin dhe Ramlen. Në të katër anët u hap lajmi se arabët u mundën, pësuan disfatë. Ishte një farsë politike dhe ushtarake. Njerëzit mbetën me gojë hapur, madje ishte kjo farsë, që e ktheu në njohjen ndërkombëtare Izraelin nga ana e OKB-së.

Pastaj udhëheqësit e shteteve të mëdha thanë se Izraeli u krijua me qëllim që të qëndrojë. Por që të qëndrojë duhet të ndryshohet mjedisi përreth tij, pasi si mund të qëndrojë Izraeli duke patur rreth tij Islam?! Ose, si do të qëndrojnë pushtuesit jabanxhi duke patur përreth tyre arabë të lirë?!

Prandaj, Islami le të pikojë gjak deri sa të vdesë. Le të hidhet dhe mbi të drejtat njerëzore deri sa t'u zihet fryma e të treten. Por, kush do t'i kryejë këto punë të mëdha?! Qeveri ushtarake, të cilat do të ngrihen prej disa të rinjve aventurierë?!

Kështu që, përreth Palestinës së plagosur, ose Izraelit grabitqar u ngritën qeveri ushtarake, të cilat Islamit dhe të drejtave themelore kushtetuese i shpallën luftë shfarosëse. Me këtë gjë ata patën sukses, sepse për një çerek shekulli mbështeten pushtetin e individit dhe luftën e eliminimit politik dhe gjithashtu patën sukses duke e bërë thirrjen islame, thirrje kundër ligjeve ekzistuese.

Përmes këtyre qeverive ushtarake të ngritura këtu e atje, Izraeli fitoi dy luftërat e tjera. I fitoi me lehtësi në mungesë të vetëdijes islame dhe të drejtave njerëzore.

Arriti të zgjerojë territorin dhe të imponojë prezencën, madje arriti të përhapë me të madhe gënjeshtrenë e tij të poshtër se ushtria hebrije nuk mposhtet.

PËRSE E URREJNË SHTETIN ISLAM

Nuk e kam menduar të ketë kaq shumë urryes ndaj asaj që Allahu ka zbritur dhe që zemrat e tyre t'i ketë mbuluar gjithë kjo urrejtje dhe zyrtësi! Megjithëse, kolonizatori kulturor ishte më i suksesshme se sa kolonizatori ushtarak, sepse ushtritë që pushtuan tokat islame dikur në një kohë u kthyen nga kishin ardhur, ndërsa mendimet, të cilat na i nguliti armiku dhe na pushtuan mendjet tona vazhduan të veprojnë fort.

I thashë një personi, i cili pretendonte se ishte demokratik se cili është përkufizimi i demokracisë?

Dhe ai m'u përgjigj duke më thënë se përkufizimi i demokracisë është sundimi i popullit për popullin, pra populli është burimi i udhëheqjes.

I kërkoja sërish diçka me shumë duke i thënë: -Duket se përkufizimi ka diçka tjetër që ju nuk e përmendni...

Tha: -Çfarë është ajo diçka?

Iu përgjigja: -Përveç, nëse populli është mysliman... sepse po qe se populli është mysliman, atëherë duhet që ai të mos sundojë vetë për veten e tij dhe të mos jetë ai burimi i udhëheqjes që rregullon çështjet e tij, por atë duhet ta

sundojë dikush tjetër me ligje dhe parime të importuara...

Çdo popull mysliman ka dëshirë që atë ta sundojë Islami, por ky vullnet i tij ndrydhet me çdo lloj arme. Dhe, dashuria e myslimanëve për Akiden, për besimin dhe Sheriatin e tyre nuk ndërpritet asnjëherë, por ju e frenoni këtë dëshirë me mënyra dhe forma që s'kanë të numëruar si: falsifikim votimesh, falsifikim mediatik, falsifikim artikujsh, falsifikim fetvash dhe kur të gjitha këto falsifikime nuk bëjnë dobi, atëherë i vjen rradha shpatës duke i mbyllur gojët dhe duke i spastruar njerëzit...

Njerëzit e lirë nuk kanë vend që rrinë dhe as mendje të qetë...

Më tha: -Sundimi fetar, ai i bën këto që po thua ti, ndërsa sundimi laik jo, asnjëherë.

Atëherë iu përgjigja: -Vendosja e komunizmit, derisa u instalua i kushtoi popujve miliona jetë njerëzish, lumenj të tërë gjaku që kurrë nuk do thaheshin dhe s'pushuan së krijuari legjenda për të drejtat e njeriut... Mos vallë, kjo është demokracia popullore?!

Dhe, këto vende, të cilat janë çliruar prej kryqëzatave perëndimore, po përpiqen të rikthejnë trashëgiminë e tyre shpirtërore e ligjore, personalitetin e tyre material e kulturorë dhe nuk çlirohen nga ndonjë fatkeqësi, përveçse hynë në një tjetër. Ju i dëshironi atyre lirinë e gjakderdhjes dhe të trillimeve, lirinë e shthurjes e të mosbindjes dhe sa herë që dëshirojnë të kapen për librin e Zotit, të ecin në rrugën e Profetit dhe në mënyrën e stërgjyshërve të tyre, dëgjohen sa këtu e sa atje ulërime se liritë janë të kërcënuara. Se, e nesërmja është e mbushur me rreziqe. Dhe, dëgjohej prej atyre që nuk zotërojnë një grimcë nga mbështetja e popullit, se në emër të popullit, refuzon kthimin në Islam.

I thashë një njeriu, njohës i publikut dhe i të drejtave të tij: -Pa dyshim, Islami ua ofron të gjithë atë që ju thoni... Fytyra iu nxi dhe tha: - Nuk e mendoj. E shikova me vëmendje, pastaj i thashë: -A dëshiron të ta them hapur? Ti urren diçka tjetër, urren çdo detyrë që Islami u ka caktuar njerëzve. Ai u caktoi atyre namazin, istigfarin, kërkimin e faljes, përgatitjen për botën tjetër dhe lidhjen e përhershme me Allahun. Këto kuptime ju i mohoni për faktin se ato kanë lidhje me drejtësinë shoqërore, apo drejtësinë politike.

Ndërkohë që Islami është fe dhe shtet, ju e urreni shtetin islam, sepse ju urreni vetë fenë, Islamin.

A JANË FETARË NJERËZ TË TILLË?

I urrej njerëzit e vrazhdë dhe të egër. Sikur ndonjëri prej tyre të ishte tregtar dhe unë të kisha nevojë për të blerë tek ai, nuk do të shkoja kurrë në dyqanin e tij. Dhe, sikur të ishte nëpunës e unë të kem nevojë për të, përsëri nuk do të shkoja në zyrën e tij. Por, fatkeqësia e madhe është atëherë kur ai është imam namazi, apo hatib xhumaje, ose aktivist në thirrje (davet). Me të vërtetë ai është fitne e gjallë që ripërtërihet e ta nxin shpresën.

Në qoftë se feja nuk është sjellje e bukur, fytyrë e qeshur, shpirt tolerant, fqinjësi e mirë dhe jetë tërheqëse, çfarë është ajo?!

Përpara kësaj, në qoftë se feja nuk është nevojë për Allahun, përgjërëm i përhershëm përpara pranisë së Tij, lutje për mëshirën e Tij të madhe dhe aspiratë që mirësia e Tij të përfshijë tërë njerëzit dhe botën mbarë, çfarë është ajo?!

Disa namazli, lëvizja e tyre për t'u rreshtuar në saf (rresht), ngjan sikur mali po lëviz. Dhe, disa predikues (vaiza) flasin sikur vetëm ata janë të pagabueshëm dhe njerëzit, përveç tyre janë gjynahqarë. Ja, një djalosh i ri e mendon veten e tij dërgim kujdestar hyjnor për ta rregulluar njerëzimin, duke i vështuar të mëdhenjtë dhe të vegjlit me një shikim

zhbirues guximtar.

Nuk ka dyshim që zemra e ashpër dhe kulti vetjak i tepruar janë argumenti më i qartë i zemërimit të Allahut dhe largim nga rruga e Tij e drejtë, suratun mustekim... është e lehtë që njeriu të veshë rrobat e ibadeteve mbi trup të ndotur dhe brendësi me të meta.

Sikur një njeri t'i njihte të metat e mia dhe të m'i mbulonte ato, pastaj të vinte tek unë për të m'i treguar gabimet e të më kthente tek Zoti im, patjetër do ta kisha falënderuar dhe do isha lutur për të. Sepse ai më ka bërë një punë të mirë dhe, Allahu e mëshiroftë atë njeri që m'i tregon të metat e mia.

Unë frikësohem për veten time dhe për njerëzit nga ulëritësit, demaskuesit, shpirtligët që u rrinë në prit gabimeve për t'u hedhur ndaj njerëzve ashtu siç hidhet ujku ndaj deleve. Ai në pamje të jashtme duket se është xheloz i të drejtës dhe brenda tij është egërsirë, ku devotshmëria nuk ia ka shkurtuar kthetrat dhe imani nuk ia ka larë turpin dhe as nuk e ka pastruar.

Dikur, në kohë të vjetra havarixhët kanë ecur në këtë rrugë. Historia na tregon se Amare ibn Kard doli në luftë dhe qëndroi duke luftuar aq sa ia kishte shkruar Allahu, pastaj vendos të kthehet dhe duke iu afruar Ehvazit në Persi dëgjoi ezanin dhe u nis andej nga i erdhi zëri për të fal namazin me xhemat. Kur mbërriti, zbuloi se ata ishin Ezarik (fraksion i havarixhëve), të cilët i konsideronit emevitët qafira (jobesimtarë) dhe kush lufton përkrah jobesimtarëve edhe ai është jobesimtar. Me ta parë këtë hero të madh në mesin e tyre i thanë: -Çfarë të ka sjellë këtu, o armik i Allahut?

U tha: -A nuk jeni vëllezërit e mi?

I thanë: -Ti je vëlla i shejtanit, patjetër që do të të vrasim.

U tha: -Përse nuk bëheni razi me mua për atë që i Dërguari i Allahut u bë razi ndaj meje?

I thanë: -Me çfarë ishte razi për ty?

U tha: -Shkova tek ai, ndërkohë që unë isha jobesimtar (qafir), dëshmovava që nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i tij dhe më la të lirë... Por, havarixhët e morën dhe e mbytën.

Nën moton islame ka njerëz që nuk zotërojnë aftësi kuptimi dhe nuk kanë aspak edukim, mashtrohen me lexime, oratori e me kundërshtime në disa situata dhe e shohin fenë si pronë të tyre, ndërsa mohimin (kufrin) pronë të kundërshtarëve, duke lejuar gjakun, pasurinë dhe nderin e tyre.

Ky nuk është Islam dhe me këto mënyra nuk i shërbejnë asnjë feje prej çfarëdolloj feje qofshin.

FJALËSHUMË PËR ISLAMIN PA PUNË FRUTDHËNËSE

Kur shikoj të zotin e një profesioni prej profesioneve të rëndësishme, të paaftë në punën e tij, apo dështak në përsosjen e saj, ndiej keqardhje.

Ndërsa, kur këtë njeri të paaftë e dështak e gjej duke folur për fe dhe fjalëshumë në disa çështje fikhu (dispozita juridike) atëherë zemërohem. Kjo, sepse ky fjalëllëk këtu është perde për të fshehur neglizhencën dhe përsosje e mashtrimit.

Çfarë do të ishte për zanatçin dhe profesionistin ta adhuronin Allahun duke e bërë mirë punën e tyre dhe shfaqjen e saj në formën më tërheqëse?

S'ka dyshim që aftësia profesionale dhe drejtuese është punë e devotshme sikur namazi dhe agjërimi dhe është e pamundur që një popull të zhvillohet, apo një mesazh të ketë sukses, në qoftë se nuk arrin të sigurojë një ushtri prej specialistësh dhe drejtuesish të aftë.

Ai, i cili plaçkën e tij e paraqet në formë të shpifur dhe me pamje të përmbysur nuk i bën dobi të përmend disa dispozita juridike.

Përmendja e këtyre dispozitave nuk është argument i

plotësisë, madje mund të jetë një lapsus në të folur, bisedë rreth një të mete, apo zgjatje e gjuhës ndaj dijetarëve, sikur ai u thotë atyre "Nuk jeni më të mirë, sepse edhe unë e di atë që ju e dini".

Ndoshta mund të thuash që kjo është thirrje për monopol të diturisë fetare dhe kufizim të saj vetëm për një grup të caktuar njerëzish, ndërkohë që Islami e refuzon këtë thirrje, pasi ai nuk ka grup të veçantë klerikësh, apo njerëz të fesë.

Ju përgjigjem: -Thirrja për specializim është tjetër nga thirrja për monopolizim dhe belaja e ymetit islam ka ardhur nga ato grupe pseudo nxënësish që nuk dinë të japin fetva, që nuk i japin të drejtë të vërtetës, nuk e përfundojnë çështjen, nuk dinë të vlerësojnë sasitë, të cilat shërojnë sëmundjen dhe as përcaktimin e diagnozës që ankohet shoqëria. Të tillë njerëz me këtë injorancë veçse i bëjnë dëm dhe jo dobi fesë sonë.

Ragib El-Asfahani e ka ndaluar zgjerimin e panevojshëm në dituri të njerëzve me profesione të ndryshme për çfarë nuk kanë nevojë në aftësinë e zanatit dhe ka menduar se për forcimin e besimit të tyre u mjafton çfarë është në Kur'an, duke i nxitur ato për mirë e duke i ndaluar nga e keqja, si dhe për t'i larguar ata nga çështjet kontradiktore dhe burimet e dyshimeve.

Ai ka thënë "Në qoftë se ndonjëri prej tyre detyrohet nga thënie të kota, bidate të dukshme apo kureshtje për të mësuar dhe për të shqyrtuar e provojmë dhe në qoftë se është me kuptim të mprehtë e imagjinatë të saktë e ndihmojmë duke ia shpjeguar dhe thelluar derisa t'i hiqet meraku. Dhe, në qoftë se është me qëllim të lig, kërkues i debatit dhe sa për t'u dukur e ndalojmë që të mos ia arrijë

qëllimit të tij”.

Përsëri El-Asfahani thotë “Ne duhet t’i drejtojmë këta specialistë dhe prodhues drejt punëve të tyre, pa të cilat ymeti nuk mund të bëjë. Dhe, duhet që të ndërhyjmë mes tyre dhe merakut me pak dituri dhe me zemër të butë...

Pastaj, El-Asfahani na sjell këtë tregim:

Një i paditur prej këtij lloji e pyeti një të urtë për një mesele në fe, por ai u largua dhe nuk i dha përgjigje...

Pyetësi i tha: -A nuk e ke dëgjuar të Dërguarin (a.s): “Kush pyetet për një dituri, të cilën ai e di dhe e fsheh, atij do t’i vihen frena zjarri në Ditën e Kiametit?”

I urti tha: - Si jo, e kam dëgjuar. Por, i lë frenat këtu dhe shkoj. Po të vijë ndonjë njeri, të cilit dituria ime i bën dobi dhe unë e fsheh atë, atëherë le të m’i vënë frenat e zjarrit.

E vërteta është se, disa njerëz flasin për Islamin, e në fakt feja do të dëshironte të heshtnin e të mos iu dëgjohej zëri. Dhe, pikëllimi është se ata janë shtuar në këto ditë të vështira, ku thuajse vrimat janë bërë më të mëdha se arnat.

AKOMA NË GJUMË PREJ SËMUNDJES

Pasi mbajta një bisedë përpara një auditori të madh prita të dëgjoj pyetjet e njerëzve e të shihja se sa kisha ndikuar tek ata. Mendova se pyetjet do të ishin rreth konfliktit të Gjirit Persik, sepse edhe fjala ime ishte për njërin prej qyteteve të këtij Gjiri, për situatën tepër të dhimbshme të saj dhe ndikimet që la pas, të cilat tejkaluan vendet pjesëmarrëse, duke u shpërndarë në gjithë popullatën islame kudo në çdo vend.

Por, pyetja që më befasoi ishte në një drejtim tjetër dhe numri i atyre që pyetën ishte i madh, sa që ishte e pamundur t'i anashkaloja.

Njerëzit më pyetën: -A e dinë shpirtrat se si jemi ne? Dhe, të vdekurit tanë prej të afërmeve dhe miqve a na i shikojnë punët dhe a kërkojnë falje për gjynahet tona?

U vonave në përgjigje duke urryer pyetjen dhe pyetësit. Njerëzit janë të zënë me çfarë ka pas materies dhe jo me vetë materien. Janë të zënë me botën e padukshme dhe jo me botën e dukshme. Sikur ata të kenë përfunduar çështjet e preکشme e tani nuk u ka mbetur gjë tjetër, përveçse të merren me çështje të tjera...

Duke u rënë tërthorazi pyetjeve të tyre u thashë: -Në qoftë se juve ju preokupon kërkimi i faljes për gjynahet, atëherë melekët, siç thotë Kur'ani, kërkojnë falje për ju: "Zoti ynë, çdo gjë e ke përfshirë me mëshirë dhe dituri, falu gjynahet atyre që janë penduar dhe pasuan rrugën Tënde."³⁷ Madje, çështja është edhe më e madhe se kaq, sepse "krijesat më të larta – meleul eala" i vështrojnë banorët e pafat të këtij planeti që bëjnë gjynahe dhe shpresojnë te Mëshiruesi që ata t'i falë: "Qiejt atje lart gati sa nuk pëlcasin dhe melekët i bëjnë tesbih (lavdërojnë) duke falënderuar Zotin e tyre dhe kërkojnë falje për ata që janë në Tokë."³⁸

Pyetësit thanë: -Këtë e dimë dhe nuk po të pyesim për të. Ne po ju pyesim për Pejgamberin tonë, njerëzit e mirë të këtij ummeti, për familjarët dhe të afërmit tanë të mirë. A janë ata të gjallë dhe a e dinë gjendjen tonë? A interesohen për punët tona dhe a bëjnë lutje për ne?

Përsëri u zura ngushtë me këtë pyetje të urryer dhe u thashë se ata janë të gjallë, për këtë nuk ka aspak dyshim. Por, ata janë të gjallë te Zoti i tyre, ndërsa a janë ata që interesohen dhe preokupohen për punët tona, çfarë kemi bërë dhe çfarë kemi lënë pa bërë "Çdo njeri është peng i asaj që ka punuar"³⁹.

Njerëzit në dynja nuk kanë qenë prej atyre që e dinin të fshehtën (gajbin), as që do ta dinë atë pas vdekjes së tyre dhe as që nuk do ta dinë përfundimin e njerëzve të tjerë, përveçse kur ata do të kalojnë pranë tyre në botën tjetër. Prandaj është më mirë për ju, o popullatë myslimane, të rregulloni veten, t'i përvisheni punëve tuaja dhe të drejtoheni nga kënaqësia e Zotit, në vend që të merreni me

37. Gafir: 7.

38. Shura: 5.

39. Tur: 3.

këtë çështje, e cila nuk ju intereson.

Në këtë moment u ngrit një fetar, shejkh me bindje të fortë në veten e tij duke thënë: -Bile, shpirtrat e dinë se në çfarë gjendje jemi dhe na vështrojnë neve... dhe i pari prej këtyre shpirtrave është i Dërguari më i madh, i cili ka thënë: "Jeta ime është më e mirë për ju dhe vdekja ime është më e mirë për ju. Punët tuaja më shfaqen mua dhe kur ju shoh ndonjë të keqe i kërkoj Allahut falje për ju", kjo e shkruar në librin "Er-Rruh – Shpirti" të Ibnul Kajimit, ku ka shumë argumente në lidhje me këtë që po them.

Edhe një herë tjetër të më shikonit se si rrëshqisja në një debat shterpë të atij lloji që e urreja. Por, patjetër duhet të sqaroja, prandaj iu drejtova shejkhut kundërshtues: -Në hadithin e saktë ka ardhur se: "Disa njerëz prej shokëve të të Dërguarit të Allahut, të afërm të tij, tërhiqen larg nga ai, në Ditën e Llogarisë, ndërsa ai thotë: "Shokët e mi, shokët e mi; ku po i çoni shokët e mi?" I thuhet: "Ti nuk e di se çfarë kanë bërë pas teje?" Ky tekst tregon se ai nuk e di gjendjen e njerëzve më të afërm të tij, ndërsa hadithi yt, të cilin e përmende nuk vlen asgjë. Libri "Er-Rruh – Shpirti" i Ibnul Kajimit, po qe se do të vërtetohej se është i tij, është libër opinionesh dhe tregimesh, prej të cilit nuk ndërtohet ndonjë gjykim fetar.

Filloi zhurma, të cilën e kisha frikë, sepse fetaristi, shejkh dhe grupi i tij nuk e pëlqyen thënien time. Nuk më shqetësoi mospëlqimi i tyre, por ajo që më shqetësoi ishte fakti se njerëzit janë në një luginë dhe ne jemi në një luginë tjetër. Debatojnë për çështje në të cilat nuk kanë dobi dhe as nuk kanë përgjegjësi për to, pastaj ndahemi për shkak të tyre të konfliktuar, në një kohë kur armiqtë e Islamit përpiqen ta zhdukin atë së bashku me ymetin e tij.

Ngjarje e ndodhi të mëdha kanë kaluar për ne, të cilat duhet të na kishin zgjuar nga gjumi dhe të na e kishin prishur qetësinë e pavëmendjes. Por, siç duket sëmundjet e vjetra akoma vazhdojnë të na shkatërrojnë e të na konfiktuojnë njëri me tjetrin, duke bërë që disa njerëz të luftojnë për shkak se nuk lejohet që edhe një qime e vetme të hiqet prej mjekrës, e ndërsa harrojnë dredhitë e mashtrimet që tundin e lëkundin shtetet dhe njerëzit.

NJERËZ PA DINJITET...

Ishte me pozitë dhe kishte ndikim, të cilat i përdorte për të deformuar imazhin e Islamit. Luftonte mbrojtësit e tij dhe mundohej të "modernizonte" familjen islame duke ndihmuar kolonizatorin kulturor me gjithë fuqinë që kishte. Pastaj, donte Zoti dhe u zhvesh nga pozita dhe ndikimi që kishte, por në veten e saj i mbeti urrejtja për Islamin, për parimet dhe ligjet e tij.

U nis për pushime turistike, pastaj kur u kthye i gjeti studentet e saj, të cilat kishin vendosur hixhabin dhe një pjesë e madhe e femrave, që anonin nga thjeshtësia dhe urrenin zbulimin dhe "modernizimin". Menjëherë ajo shpalli urrejtjen e saj duke thënë "Prapambetja qenka kthyer. Populli kërcënohet të kthehet prapa dhe gjithë ato energji që kemi harxhuar për femrën, që ajo të përparojë kanë shkuar kot, ose pothuajse kanë humbur...".

Nuk u çudita për çfarë po lexoja, sepse nuk kisha parashikuar prej saj dhe prej shembujve të saj ndonjë pendim të singertë.

Ajo, për të cilën u çudita ndodhi prej asaj që më tregoi një miku im.

Ai më tha: -Kjo grua, së bashku me disa shoqe të saja, ku edhe ato ishin me pozitë të lartë, kishin kërkuar të takojnë Papën e Vatikanit.

Iu kishin thënë:- Nuk ka problem, por rregullat e vizitës janë të tilla, që Papa nuk pranon për vizitë, vetëm femrat e edukuara dhe të mbuluara me hixhab, ashtu siç vishen murgeshat, duke mos u dukur prej tyre, përveç fytyra dhe duart.

Ato të kënaqura dhe të bindura kishin thënë: - Në rregull, nuk ka problem.

Kjo zonjë, e cila kishte përçmuar vajzat e ndershme myslimane të veshura me hixhab, hyri në vizitë me rrobat e plota të mbulesës së murgërisë. Mbaroi takimin duke dalë e gëzuar dhe me ndjenja të zjarra...

Mendova gjatë rreth kësaj sjellje. Vajzat tona ndjejnë thellë mbikëqyrjen e Zotit dhe nxitojnë drejt kënaqësisë së Tij duke veshur rroba, të cilat përputhen me edukatën islame, por bëhen shkak urrejtjeje prej kësaj gruaje dhe shembujve të saj. Por, përse ajo pranoi të veshë rrobat e devotshmërisë kur vendosi të takojë një udhëheqës fetar të një feje tjetër, që kërkoi prej tyre një gjë të tillë?!

E mësova përgjigjen e hidhur. Në mes nesh ka burra e gra, që zgjasin gjuhët e tyre duke folur kundër Islamit me paturpësi dhe kritikojnë njerëzit e tij, ndërsa kur ata ndodhen jashtë vendit të tyre zbatojnë dhe qëndrojnë në kufijtë e caktuar duke u sjellë sipas rregullave të atij vendi. Madje, në qoftë se do të shkonin larg, atje ku adhurohen lopët, do të nxitonin të merrnin me vete edhe kashtë, për t'u afruar me të, te zoti i tyre i shpikur...

Këta tipa burrash dhe grash janë produkt i ateizmit

komunist,⁴⁰ i cili ka boshatisur zemrat e tyre prej besimit duke i dhuruar fuqi të madhe në mos praktikimin e detyrave, në pasimin e epsheve, në zbukurimin e të këqijave dhe në përçmimin e të mirave.

Vetëm prej Islamit ndjehen ngushtë dhe vetëm parimet e tij mundohen të shkatërrojnë...

Gjënë më ulët që kam parë, grua pa dinjitet duke kalëruar në shpinën e një burrë politikan për të arritur atë që dëshiron.

40. Në gjuhën arabe: janë produkt i kolonizimit të gjatë kulturor dhe ushtarak.

NUK ËSHTË PËRHAPUR E KOTA, PËRVEÇ SE NË MUNGESË TË SË VËRTETËS

Kemi mësuar të lexojmë se ateistët kanë njohuri sipërfaqësore kalimtare. Gjatë debateve të mia të shpejta me ta kam qenë gjithmonë i kujdesshëm, ndërsa ata ishin të mashtruar. Nuk kam vënë re në mendjet e tyre asnjë grimcë zgjuarsie, por kam parë tek ata hije mendjemadhësie.

Pas shkëmbimeve të shpejta me ta, u largova që të marr pak ajër, sepse unë i largohem erës së keqe mendore, ashtu siç largohet njeriu normal nga erërat e këqija të ngordhësirave.

Fjala e fundit që i thashë njërit prej tyre ishte "A mendon se procesi i shkëmbimit te klorofili, mes rrezeve të dritës dhe bimëve ndodh me aktmarrëveshje të firmosur ndërmjet këtyre dy elementëve dhe me vullnetin e tyre të plotë? Bimët thithin dyoksidin e karbonit dhe çlirojnë në ajër oksigjenin duke ditur se të dy këto janë të nënshtruar, pra të pavullnetshëm.

A mendon se Hëna dhe Toka kanë rënë dakord që Toka ta largojë hijen e saj në gjysmën e muajit, në mënyrë që Hëna ta marrë komplet dritën e Diellit për t'u bërë Hënë e Plotë?! Të dy këto trupa qiellorë janë të nënshtruar në

orbitat e tyre dhe nuk dinë se çfarë u ndodhë?

A mendon se spermatozoidi i mashkullit, i cili mban karakteristikat e gjinisë dhe të dhënat e trashëgimisë, të gjyshërve dhe të stërggjyshërve qëndron në vezën e femrës dhe ai e di se do të fillojë një projekt për t'u bërë njeri i zakonshëm, apo gjeni?! Ai është më i vogël dhe më i pavlerë se kaq. Ai është një plan i shkëlqyer, të cilin e ka vendosur dikush tjetër. A e di se kush e ka vendosur atë? Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Atij i takojnë Emrat më të Bukur. Atë e lavdëron çdo gjë që është në qiell dhe në tokë dhe Ai është i Gjithëpushtetshmi, i Urti".⁴¹

Më ka mahnitur thënia e gnostikut "Sa i çuditshëm i tëra çudive është dyshuesi në fuqinë e Allahut dhe ai i shikon me sy krijesat e Tij! Sa i çuditshëm i tëra çudive është përgënjeshtuesi në ringjalljen e të vdekurve dhe ai vdes çdo natë dhe ringjallet sërish! Sa i çuditshëm i tëra çudive është besuesi i botës së përherëshme dhe ai nget pas botës mashtruese! Sa i çuditshëm i tëra çudive është mendjemadhi e kryelarti dhe ai është krijuar nga një pikë uji, pastaj bëhet i vdekur dhe mes kësaj e asaj nuk e di se çfarë bëhet me të"!

Asgjë në univers nuk ekziston vetvetiu, por ekzistenca e tyre është prej Krijuesit të qiejve dhe të tokës, ku të gjitha janë të barabarta në këtë pikë, materia, insektet, kafshët me tërë llojet e tyre, njeriu, xhindi dhe engjëlli.

Ekzistenca është një vepër shumë e lartë. A nuk i shikon satelitët artificialë? Ato nuk zënë shumë vend, por për lëshimin e tyre në hapësirë duhen dhe dhjetëra e dhjetëra shkencëtarë dhe punëtorë.

Pra, çfarë mendon për lëshimin e planetëve në orbitat

41. Hashr: 24.

e tyre? Prezencën e tyre kur lindin dhe kur perëndojnë? Si mundet të arrihet e gjitha kjo vetvetiu?!

Me të vërtetë ateizmi është marrëzi.

Ndoshta e ka një kuptim që ajetet e Kur'anit sillen rreth vënies në punë të mendjes në mënyrë që ajo ta njohë Zotin e saj dhe ta lavdërojë e ta falënderojë.

Ndërsa belaja e madhe është se pjesëtarët e Kur'anit i kanë vënë në gjumë mendjet e tyre dhe jetuan pa kuptuar, duke qenë të fikët e tyre mendor shkak për përhapjen e ateizmit dhe pushtetit të ateistëve.

NJË VËSHTRIM I ZGJUAR RRETH HADITHEVE TË TRAZIRAVE

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Dherri (r.a) tregohet se trazirat do të përhapen pas vdekjes së Pejgamberit (a.s) dhe do të acarohen instinktet e vjetra drejt luftërave, të cilat përgjithësisht janë instinkte të fshehura te njerëzit e veçanërisht tek arabët. Patjetër nxitja e njerëzve do të jetë me pretekstin e mbrojtjes së parimeve.

Ebu Dherri: -O i Dërguar i Allahut, a ta marr shpatën e ta vendosi në qafën time?

Pejgamberi (a.s) i tha: - Atëherë ke bashkëpunuar me ta.

Ebu Dherri: -Për çfarë më urdhëron?

Tha: - Qëndro në shtëpinë tënde.

Ebu Dherri: -Po në qoftë se hyjnë në shtëpinë time?

Tha: -Në qoftë se frikësohesh se do të verbojnë rrezet e shpatës, atëherë mbulo fytyrën me rrobë dhe ai do të marrë gjynahin tënd dhe gjynahin e tij.

Në një transmetim tjetër thuhet: "Në qoftë se hyn (trazira) te ndonjëri prej jush, atëherë le të jetë si më i miri i bijve të Ademit", pra le të jetë viktima dhe jo autori.

Duke ndenjmur me një mikun tim po kujtonim këtë hadith për të kuptuar domethënien e tij. Gjëja e parë që na shkoj në mendje, si të përballemi me agresorin? Kush më thyen shtëpinë dhe dëshiron të më vrasë, e vras dhe ai s'ka nderim. Ajeti thotë: "Dhe, të cilët kur i godet një agresor, ata janë triumfues"⁴² dhe hadithi: "Kush vritet për të mbrojtur jetën e tij, ai është shehid, dëshmor".⁴³ Pra, patjetër duhet të ketë rezistencë vdekjeprurëse për keqbërësit dhe kërcënuesit e shenjtërimeve. Nuk ka armëpushim këtu.

Miku im më tha: -Këtu ka një kuptim tjetër, të cilin e shoh prej nga larg dhe do kisha dëshirë ta studionim. Ekzekutimi nuk i zgjidh problemet e brendshme, ashtu si dhe ndërprerja e lidhjeve faqefisnore rritet duke marr hak, ose garantohet duke falë. Kur gjërat ndërlikohen për motive politike, atëherë çelësi i tyre është zgjidhja politike dhe jo derdhja e gjakut të njerëzve...

I thashë mikut tim: -Nuk po e kuptoj se çfarë do të thuash?!

Më tha: -Kur babai shikon se ngatërresa mes vëllezërve ka çuar në humbjen e jetës së njërit prej tyre, atëherë ai nuk thërret për ekzekutim që të marrë hak, sepse kjo gjë përfundon me humbjen e krejt familjes. Ai do të përpiqet t'i qetësojë gjërat, pastaj fillon të shikojë ndreqjen e asaj që ka ngjarë.

Zgjidhja politike, ajo është e vetmja të cilës duhet t'i drejtohem. Ndoshta kjo është ajo që ka pasur për qëllim

42. Sureja Esh-Shura: 39.

43. Shiko kapitullin: "Kush janë Shehidët (dëshmorët) në Sahihun e Muslimit" me shpjegim të Neveviut dhe atë të cilin e transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Seid ibn Zejd ibn Amër ibn Nufejl: "Kush vritet për të mbrojtur pasurinë e tij, ai është shehid; kush vritet për të mbrojtur gjakun e tij, ai është shehid; kush vritet për të mbrojtur fenë e tij, ai është shehid dhe kush vritet për të mbrojtur familjen e tij, ai është shehid." (hadith Hasen Sahih)

Pejgamberi (a.s) kur e ka porositur për një qëndrim negativ në përballjen e trazirës, derisa ndaluesit t'i japin fund betejës duke mbyllur burimin e së keqes.

Porosia e Pejgamberit (a.s) e shuan zjarrin e ndezur kur thotë për trazirat: "Ai që është i ulur është më i mirë se ai që është në këmbë dhe ai që ecë në to është më i mirë se ai që vrapon."

Kur mendoj rreth gjendjes së myslimanëve sot për fitnet (trazirat) e tyre them "Sa i nevojshëm është ky ymet për burra të tillë, të cilët kanë durim dhe maturi, sinqeritet dhe paanësi duke u larguar nga shkaqet e grindjeve, duke refuzuar thirrjet e injorantëve dhe duke kërkuar unitetin e fjalës. I mënjanojnë anash palët konfliktuese derisa të arrihet pajtimi mes njerëzve me një zgjidhje në të cilën prioritet i jepet interesit të përgjithshëm, duke kapërdirë në këtë mënyrë mllëfin e tyre për hatër të Allahut dhe unitetit të fjalës".

RRETHI I SHPËTIMIT

Tradita e njerëzve besimtarë, të cilët në kohë të vështira, i drejtohen me përlujë Allahut duke i kërkuar ndihmë ka kaluar. Ne, nga natyra jone njerëzore jemi të dobët, vetëm në rast se na mbështet i Forti, jemi gabimtarë, derisa Allahu të bëjë mëshirë ndaj nesh, duke na e pranuar pendimin, duke na falur dhe duke na mbrojtur e duke qenë i kënaqur me ne.

Ditët, nëpër të cilat po kalojmë, janë të mbushura me paralajmërime, madje gati sa nuk shpërthejnë rrufetë, të cilat shkrumbojnë në çast çdo gjë. Duhet të na shtyjnë me forcë drejt Allahut, duke i kërkuar mëshirë dhe falje.

Ymeti jonë islam e ka humbur Mesazhin e tij dhe ka përjetuar dy kategori njerëzish:

Kategorinë e parë e ka habitur pasuria e tij ndaj ahiretit, ku ai është i sprovuar me këtë botë. Kategoria e dytë është e humbur, e cili e ka smirë të parën dhe dëshiron të jetë sikur ajo.

Të dy këta kategori janë mashtruar nga lustra e qytetërimit bashkëkohor duke u ngjitur me më të keqen e tij e duke braktisur çdo gjë tjetër, por si ishte përfundimi?

Gjakra që derdhen çdo ditë, ogure të zeza priten, trazira sterrë të errëta dhe ardhmëri e zymtë. Çdo gjë na tërheq me forcë për të shfrytëzuar metoda të reja në jetë, të cilat do të na kthejnë tek Islami, me të cilin Allahu na nderoi dhe na ngarkoi për ta mbajtur dhe për ta përcjellur.

Pasuritë e myslimanëve digjen përpara syve të tyre dhe kursimet u vidhen ditën për diell. Nyjës së fortë i është këputur filli, ndërsa jeta e tyre është shkapërderdhur. A nuk mund ta kujtojmë bisedën e pronarëve të kopshteve të bukura, të cilat Allahu i shkatërroi, kur këta pronarë vendosën të mos i zbatojnë detyrimet ndaj Zotit dhe ndaj robit?!

Ata thanë: "Lavdi i qoftë Zotit tonë, ne ishim të padrejtë." Dhe u kthyen duke qortuar njëri-tjetrin. Thanë: "Të mjerët ne, vërtet ne ishim tiranë!" Shpresë se Zoti ynë do na zëvendësojë me ndonjë edhe më të mirë se ai, ne vetëm te Zoti ynë shpresojmë." (Kalem: 29-32)

Unë, akoma shikoj grupe bijsh të ymetit të prekur nga fatkeqësia që nuk resht duke kërkuar për lezete dhe nuk resht duke qenë kokëfortë në joshjen e saj, nuk ngopet, por me çfarë mund të zgjohet, në qoftë se nuk e zgjojnë gjithë këto gjëma?!

Ne, duhet patjetër t'i presim dallgët e belave me lutje dhe të ngutemi drejt xhamive të nënshtruar duke kërkuar ndihmën.

Unë i shikoj rendësit e epsheve në kësi lloj situatash të vështira si kope bagëtish. Ngurtësia e zemrës, ngrirja e syrit dhe harrimi i ahiretit janë shenja të një zemërimi shkatërrues.

Ajo që kuptohet nga libri ynë famëlartë është se dhimbjet janë kamxhik, i cili kthen të humburin në rrugën

e drejtë. Në qoftë se largohet prej saj dhe frymëzon besimtarin drejt përgjërimeve të ngrohta, kur largohet prej tyre thuhet: "Ne i dërguam të dërguarit Tanë edhe te popujt përpara teje, i trajtuam më skamje e mjerim, ashtu që të përgjëroheshin. E pse të mos përgjëroheshin kur atyre u erdhi dënimi jonë?"(En'am: 42-43)

Me kthimin e mendjes, zgjimin e ndërgjegjes dhe me pendimin e sinqertë pritet falja hyjnore dhe kthimi i begative dhe e mirëqenies.

Por, në qoftë se të dehurit kërkojnë pije, të ndyrët të gjejnë epshe, mendjemëdhenjtë e pasur kundërshtojnë të bien në sexhde dhe të zhyturit në luks që nuk ka gjë t'i ndreqë, atëherë nuk ka rrugë tjetër, veçse t'u bien gjëmat njëra pas tjetrës, pa u kthjellu retë e para ia behin të dytat ... për këta Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an: "Edhe sikur t'i mëshironim ata dhe t'ua kishim larguar fatkeqësitë, ata do të vazhdonin të zhyteshin në zhgënjimin e tyre. Ne i trajtuam ata me dënim, po ata nuk iu përulën Zotit të tyre e as nuk iu drejtuan me lutje. Derisa t'ua hapim një derë dënimi të ashpër, atëherë ata do të mbesin aty me shpresa të humbura."(Mu'minun: 75-77)

Përse i riu mysliman nuk mendon për përmirësimin e rrugës dhe disiplinimin e jetës së tij? Përse të mëdhenjtë nuk mendojnë për studimin e së shkuarës dhe zbulimin e gabimit, me ndreqjen e të cilit afrohen tek Allahu?

Në tragjedinë myslimane të kohës, shoh se armiqtë shtohen dhe nuk pakësohen, forcohen dhe nuk dobësohen, ndërsa ne, fatkeqësia jonë nuk ka të bëjë me pakësimin e armëve, mungesën e pasurisë dhe as me numrin e paktë të njerëzve. Fatkeqësia e ka burimin brenda vetes sonë dhe, në qoftë se nuk ndryshojnë veten këta njerëz edhe gjendja

e tyre nuk do të ndryshojë.

Në qoftë se jemi të kënaqur me veten tonë dhe, ajo është në këtë gjendje, atëherë kjo gjendje e tillë do të mbesë, ashtu si mbet hija e shtrembër prej drurit të shtrembër.

Kjo situatë po ndeshet fatkeqësisht sot në shoqërinë islame, ku shohim çdo ditë mendjemadhësinë e udhëheqësve tanë, gjendjen e ulët të popullit, gjumësinë e opinionit publik, si dhe zënien e dijetarëve me qëllimin për të rrëzuar këtë apo atë çështje. Atëherë, në të tillë situatë si mundet t'i dalë përballë njerëzve një musliman?! Po me Krijuesin e tij si mund të takohet?

KËRKESAT E BESIMIT

Besimi e detyron besimtarin të mbajë disa qëndrime të caktuara, prej të cilave nuk duhet të ndahet dhe as të largohet prej tyre. Dhe, a është të besuarit diçka tjetër, përveç se sjellje e detyruar dhe drejtim i caktuar?

Në fillimet e sures Enfal, Kur'ani refuzon që luftëtarët të hedhin sytë nga preha e luftës dhe të kenë mosmarrëveshje ndërmjet tyre për ndarjen e saj. Kjo çështje i takon vetëm gjyqimit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Ata, nuk kanë të drejtë të japin sugjerime dhe as të shfaqin dëshirat e tyre.

Qëndrimin e vetëm të pranuar e shpjegojnë ajetet e zbritura: "Me të vërtetë, besimtarë janë ata të cilët kur përmendet Allahu, u dridhen zemrat dhe kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi dhe te Zoti i tyre mbështeten. Ata që e falin namazin dhe prej asaj që Ne i kemi furnizuar, ata japin. Të tillët janë besimtarë të vërtetë." (Enfal: 2-4)

Besimi i vërtetë këtu kërkon një qëndrim të vetëm, i cili është përmendja e Allahut, dridhja e zemrave, shtimi i nënshtrimit, mbështetja, namazi dhe dhënia e zekatit. Por, a është ky qëndrim që përsëritet gjatë rasteve dhe ngjarjeve të ndryshme që rrjedhin?

Le të shikojmë fundin e sures dhe do të gjejmë një formë tjetër që kërkohet prej besimtarit ta veprojë. Allahu i Lartësuar thotë: "Dhe ata të cilët besuan, emigruan dhe luftuan në rrugën e Allahut; dhe ata që i strehuan dhe i ndihmuan, të tillë janë besimtarë të vërtetë." (Enfal: 74)

Këtu kemi kërkesa të reja mbi luftimin e rreptë dhe emigrimin asketik të vatanit në njërën anë dhe nevojën e ndihmës, strehimit dhe bashkëpunimit, nga ana tjetër. Kështu që, qëndrimi nuk është i saktë përveç se duke ndërvepruar të gjithë në këto kuptime për të mbështetur të vërtetën. Dhe, vetëm kjo është ai besimi i vërtetë.

Kërkesat e besimit ndryshojnë sipas situatave dhe patjetër që situata ka qëndrimin e saj të veçantë. Përqendrohu dhe mendo pak rreth fjalës së Allahut: "Me të vërtetë, besimtarë janë ata që besuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe nuk u lëkundën, por luftuan me pasurinë dhe me shpirtin e tyre në rrugë të Allahut. Të tillët janë të vërtetë." (Huxhuratë: 15) Bindja e saktë këtu qëndron duke u ruajtur nga rënia në dyshim dhe dhënia e pasurisë dhe e shpirtit. Këtë qëndrim e mbushin situatat nëpër të cilat kalon besimi, sprova ose mirëqenia, ndihma ose dështimi.

Dhe në këtë orientim përmendim fjalën e Allahut: "Me të vërtetë, besimtarë janë ata që besuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe kur janë me të për ndonjë çështje të rëndësishme nuk largohen pa i kërkuar leje." (Nur: 62)

Disa konferenca që organizohen kanë rëndësi për të ardhmen e bashkësisë dhe Mesazhin e saj dhe asnjë besimtar nuk duhet të tregohet përtac ndaj tyre. Por, në qoftë se merr pjesë në to, atëherë duhet t'i bindet kryesisë, duke qëndruar ose duke u larguar, por me lejen e tyre.

Besimi konsiston në disa qëndrime të caktuara, duke

pasur orientimin e tij për çdo çështje. Nuk i pranohet asnjë myslimani që të sillet sipas mendimit të tij, por ai duhet të ndjekë dhe t'i bindet urdhrave të kësaj feje dhe kërkesave të saj, të cilat rriten dhe ndryshojnë sipas rrjedhjes së ngjarjeve. Aty janë dy opsione përpara teje: Besim, ose tërheqje. Prandaj, shiko se cilën metodë do të përqafosh. Ekzistojnë dy rrugë të ndryshme: E drejtë, ose e shtrembër.

Besimi ka të bëjë me qëndrimin. Ka disa njerëz specialistë, të cilët braktisin këto qëndrime për qëndrime të tjera, që për nga dobia janë të pavlefshme. Por, edhe në qoftë se ndonjëherë veshin rroba fetare, arratisjes nga lufta nuk i bën dobi qëndrimi në oborr të xhamisë.

A KA PENDESE?

Namazi me xhemat ka 27 herë shpërblim më të madh se sa namazi vetëm. Sikur mirësia ka disa dukuri të mëdha, me të cilat njihet dhe ua imponon njerëzve për t'u bërë zbatues të këtyre mësimëve që janë themelore për jetën.

Të veprosh thjesh mirë është diçka e mirë, por më e mirë se kjo është kur veprimi i mirë të kthehet në traditë të përhershme, në zakon të përhapur dhe në shtet me pushtet dhe kështu vijohet edhe me gjynahet.

Njeriu i ndarë dhe i izoluar ndoshta mund të kryejë një vepër të ultë e vetëm ai mund të indinjohet prej saj duke mos e ndier askush. Pra, sikur ajo punë të kishte lind e vdekur. Edhe mund të pendohet prej saj dhe atëherë Allahu ia fshin atë, madje edhe engjëjt regjistruet i bën ta harrojnë, sikur të mos kishte ndodhur...

Ndërsa, kur atij i bashkohen të tjerë në kryerjen e asaj vepre, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin në mëkat dhe armiqësi, atëherë e keqja përkeqësohet duke forcuar njëri-tjetrin, zgjerohet ndikimi i saj dhe shumëfishohet përgjegjësia. E gjitha kjo është përhapje e shkatërrimit masiv.

Medito rreth fjalës së Allahut (xh.sh) për popullin e Lutit (a.s): “A po shkoni me burra, bllokoni rrugët dhe bëni vepra të ndyra nëpër klubet tuaja?” (Ankebutë: 29) Këtu krimi ka kaluar çdo kufi dhe patjetër duhet ndërprerja e tij me tërmet, i cili transformon pamjen e tokës dhe fshin gjithë ndyrësirën e përhapur.

Përtacia në kryerjen e detyrave është krim dhe këtë gjë mund ta bëjë një individ duke marrë vetëm ai përgjegjësinë dhe barrën e mëkatit. Por, si do të jetë puna kur gjen një ymet, popull të tërë përtac, neglizhues në reformat e tij, rri shtrirë sikur të ishte i dehur, apo i droguar?! Patjetër përfundimi i tij është në humbje.

Në Islam është e vërtetuar se popujt neglizhues do të pyeten për këtë krim masiv: “Dhe, do të shikosh secilin popull të ulur në gjunjë. Çdonjëri (popull) do të thirret për te libri i tij. Sot do të shpërbleheni për atë që keni punuar. Ky është libri ynë, që flet për ju me të vërtetën.” (Xhathije: 28-29)

Detyra e këtyre popujve është që të aktivizohen dhe të pendohen te Zoti i tyre, ashtu siç pendohet robi dështak, një për një. Më ka mahnitur dr. Dervish Mustafa El-Far, profesor në shkencën e gjeologjisë me fjalën e tij duke thënë: “Planifikuesit, të cilët neglizhojnë investimin e çdo pëllëmbë tokë dhe derdhin kot pikat e ujit që na ndihmojnë për të ngrënë nga të mbjellat e duarve tona, ata kanë nevojë për pendim, toube.”

Mësuesi, i cili nuk i pasuron nxënësit e tij me mësim të veçanta, ai ka nevojë për pendim, toube.

Tregtari i pangopur e i etur për të fituar mizorisht, ka nevojë për pendim, toube.

Liga e shteteve arabe, e cila nuk arriti për 50 vjet të bëjë

ndonjë përparim në unifikimin e njerëzve, qëllimeve, ideve dhe punëve dhe, e cila ishte e paaftë në parandalimin e përçarjeve dhe copëzimeve, ka nevojë për pendim, toubë.

Llafazanët ulëritës, robër të gjërave sipërfaqësore dhe amatorë ngatërresash, që "duan të falënderohen për atë që nuk e kanë vepruar", kanë nevojë për pendim, toubë.

Dhe, çdo zyrtar, apo udhëheqës, i cili praktikon metodat e copëtimit dhe të përçarjeve racore, duke zaptuar e përfutur sa këtu e sa atje, edhe ai ka nevojë për pendim, toubë.

Institutet kërkimore shkencore dhe organizatat e shërbimeve publike të mjaftuara vetëm me emra e lëvdata, të cilat nuk arritën, me gjithë kohën e gjatë të tyre, të pengojnë depërtimin e kulturave dhe varfërinë e qytetërimit, kanë nevojë për pendim, toubë.

Dhe, çdo djall i heshtur, i cili poshtëron njerëzit e pafajshëm dhe i mban ata të shtypur, që ka mundësi t'i mbështesë dhe t'i mbrojë të drejtat e tyre, ka nevojë për pendim, toubë.

Mëkatet shoqërore janë kanceri i popujve dhe sekret i humbjes së tyre. Prandaj, a nuk duhet të largohemi prej tyre dhe të bëhemi ymet i mbarë?!

PASURIA ËSHTË PJESE E SHËNDETIT

E urrej shtrëngimin, por e dua të shumtën e bollëkun, përveç kur ajo vjen nga ndonjë burim, apo drejtim i dyshimtë, atëherë vendosi të agjëroj dhe kënaqem me braktisjen. Në mendje më vjen fjala e kadiut El-Xhurxhani (r.h):

Thonë: -Ky është burim.

U them: -E shikoj, por njeriu i lirë e përballon etjen...

Ndërsa, nga burimi i ëmbël e i freskët nuk ka kuptim të largohesh prej tij, apo ta braktisësh atë. Ai për mua është rreze e mirësisë së dynjasë, për të cilën ne i lutemi Allahut, ose është prej bukurive të jetës, e cila është e drejtë e robërve besimtarë të Allahut.

Kujtoj këtu një nga sahabet kur lutej me këtë dua: "O Zotim im, më jep shumë, sepse e pakta nuk më mjafton".

Kryesorja është që kjo e shumë të vijë prej asaj që Allahu e ka lejuar dhe të mos jetë pengesë për realizmin e detyrave dhe as pengesë për të kuptuar natyrën e jetës së përkohshme në të cilën jetojmë.

Kam për qëllim, përparësinë e banesës së ahiretit në disa qëndrime të ekuilibruara dhe në përzgjedhjen, e cila u paraqitet njerëzve në zgjedhjen e tyre të gjatë këtu...

E di që natyrat e njerëzve janë të ndryshme, p.sh kur Gandhi u pyet "Përse në tren hip në klasin e tretë?"

Tha: - Sepse, nuk ka klas të katërt.

Ka menduar se ky qëndrim i ashpër ia imponon udhëheqësinë Gandit ndaj popullit të mjerë, të cilin kolonizatori e ka poshtëruar dhe rrokullisur në një humnerë të shkretë.

Njerëzit e mendojnë fenë si diçka që e pëlqen dhe kënaqet me të ulëtën, apo anon nga fatkeqja apo vuajtja dhe është largim i qëllimshëm nga bukuritë e jetës.

Kjo është gabim, përveç se kur lufta e detyron popullin të durojë e të vuajë, atëherë kërkohet burrëria që të durojmë, të vuajmë dhe të pranojmë realitetin pa u shqetësuar.

Më ka bërë përshtypje fjala e Ibn Xhevizut: "Akoma vazhdojnë disa grupe asketësh të kritikojnë shumë dijetarë, të cilët bëjnë një jetë të mirë. Injoranca është ajo që i bën ata ta mendojnë këtë gjë, sepse po të kishin pasur sadopak mirësi prej diturisë nuk do t'i kishin kritikuar. Kjo, për arsye se natyrat nuk janë të barabarta. Ndoshta ka njerëz që rregullohen me një mënyrë jete të ashpër, ndërsa ka të tjerë që nuk bëjnë për këtë mënyrë. Nuk i lejohet askujt të detyrojë dikë tjetër, të përballojë çfarë ai përballon. Ne kemi sheriatin, rregullatorin tonë. Në të kemi lehtësimin, por edhe përcaktimin, prandaj nuk duhet të qortohet ai që kufizon veten me këtë rregullator. Mundet që lehtësimi të jetë më i mirë se sa përcaktimi, për shkak të ndikimit dhe përfundimit të tij të mirë..."

Nuk ka aspak dyshim se Islami nuk i shpall luftë trupit të njeriut, madje ai i kërkon ndihmë fuqive të tij për realizimin e detyrave dhe për braktisjen e ndalesave (haramëve). Dhe, as nuk shpall luftë ndaj dynjasë, por e bën atë kapërcyell

për tek ajo që ndodhet pas saj. E, çfarë të keqe ka që ura të jetë e fortë dhe e sigurt?!

Të sëmurët në trup dhe në shpirt nuk u lejohet të pengojnë veprimtarinë njerëzore në emër të fesë, sepse feja, para së gjithash, është shëndet mendor dhe shpirtëror.

KËSHILLË E SINQERTË

E pashë që ishte i shpërvjelur dhe me plot seriozitet i ishte drejtuar xhamisë që të mbante mësim (ders) kundër medhhebit Esh'ari.

I thashë: - Më avash, ka gjëra që janë më të rëndësishme dhe më serioze që mund t'i kryesh, prej së cilës fiton nga Allahu shpërblim të madh.

Tha: - Çfarë do të thuash? Nuk ka gjë më të rëndësishme se sa ajo që kam vendosur të bëj.

I thashë: - O vëlla, ka ajete të qarta, që janë nëna e Librit (baza e Kur'anit). Ato kanë nevojë për kuptimin e mirë, shërbimin e duhur, mbrojtjen e madhe dhe fuqinë mbështetëse, sepse neglizhenca e tyre është e dukshme dhe sulmet për to janë të vazhdueshme.

Tha: - Lufta ndaj bidateve është më e rëndësishme.

I thashë: - Shumë bidate do të zhduken nga jeta kur të bashkëpunojmë për zbatimin e Sunetit dhe zgjerimin e ndikimit të tij, si dhe kurt'i bëjmë njerëzit që të shikojnë përmes tij. Tekstet e qarta, të cilat janë baza e fesë dhe themeli i jetës së saj janë të kërcënuara dhe kanë nevojë për një ndihmës të sinqertë. Prandaj, lëre tani atë për të

cilën opinionet ndryshojnë dhe kontradiktat shpërthejnë. Le të bashkëpunojmë për ndërtimin e shtyllave të thyera. Dhe të siguroj ty që unë nuk fanatizohem për Esh-aritë, apo për Maturiditë. Jam asket ndaj ringjalljes së mendimeve të vdekura dhe dashamirës i tubimit rreth Kur'anit dhe Sunetit dhe kaq...

Por njeriu nuk më kuptoi dhe nuk donte të më kuptonte. Shkoi në xhami dhe e ndezi betejën, e cila akoma nuk është fikur dhe nuk mendoj se do të fiket shpejt.

Në qoftë se sipërfaqja e mendjes është 100 pash te një njeri, atëherë çfarë do të thotë kur kontradiktat të zënë 90 pash prej saj? Çfarë mbetet për shtyllat e fesë, parimet e besimit dhe fushat e rregullimit pas kësaj? Ka disa njerëz që janë çakmakë fitnesh (trazirash), pasi qejfi i tyre në shkatërrim është më parësor se sa dëshira e tyre në ndërtim dhe zjarrtësia e tyre në polemika është më e rëndësishme se sa puna e heshtur. Nuk e besoj se do ta shohin fytyrën e Allahut në mesin e kësaj mjegullie.

Njerëzit e mençur në kohën tonën e ndiejnë se ymeti islam ndryshon nga të tjerët në dy pika shumë delikate:

E para: Në çështjet e kësaj dynjaje në të cilën qytetërimi i ri ka rënë në fusha të gjëra, ku ne vazhdojmë akoma të jemi duke shkelur në fillim të kësaj rruge.

Dhe e dyta: Në kuptimin e mirësisë, bamirësisë dhe drejtësisë, për të cilat janë themeluar organizata të fuqishme që punojnë nën moton e humanizmit të përgjithshëm, duke tërhequr vëmendjen me ato ndihma të pretenduara që ua ofrojnë nevojtarëve dhe nëpunësve të ndryshëm, në kohën që këto fusha janë të bojkotuar prej nesh dhe as që kemi njohuri rreth tyre.

Përse nuk u drejtohen këtyre fushave njerëzit e zjarrtë

fetarë në mënyrë që të mbështesin Mesazhin dhe të ndihmojnë Zotin e tyre?!

Myslimanët përbëjnë pjesën më të madhe të botës së tretë dhe tamam përmbi kokat e tyre bie një padrejtësi e madhe. Shumë pak e vëren ndikimin e tyre në ekonominë botërore, apo në të ardhmen e njerëzimit në këtë planet të pafat.

Prandaj, deri kur do të jetë e zënë mendja fetare me kontradikta të vjetra, e paralizuar që të punojë diçka për ditën e saj të sotme?!

THËNIE TË SHEJKH MUHAMED EL-GAZALI

“N.q.s feja nuk rrjedh në shpirtrat e njerëzve, ashtu siç rrjedh rryma elektrike nëpër tela, duke ndriçuar e duke vënë në lëvizje makineri, atëherë ajo kthehet në iluzione dhe pretendime për të cilat nuk kanë dobi simbolet e as parullat”.

“Unë nuk kam shkruar për personalitetin e Mesazhit të madh, Muhammedit, të birit të Abdullahit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, vetëm pas leximit dhe studimit të cilitdo njeriu të madh.

Unë jam mysliman me plot vetëdije, e di përse kam besuar në Allahun, Zotin e botëve, përse i besova fjalëve të Muhammedit a.s dhe përse pasova librin, i cili iu shpall, madje përse thërras të tjerët në besimin që qenia ime është e kënaqur me të”.

“Myslimani, në ndërgjegjen e të cilit nuk jeton Pejgamberi a.s, ku zemra dhe mendja nuk e pasojnë atë në çdo vepër të tij, nuk i bën aspak dobi të lëvizë buzët

ditë e natë, as edhe me një mijë salavate".

"Ne, nuk duhet t'i fajësojmë të tjerët për shfrytëzimin e shanseve në shërbim të asaj që ata besojnë, por ne duhet të fajësojmë veten tonë, në qoftë se lëmë hapësirë, në të cilën të tjerët zgjerohen. Kush e lë derën e shtëpisë hapur, të mos fajësojë hajdutin për vjedhjen e sendeve të tij".

"Ka shumë njerëz, të cilët jetojnë brenda një mendimi të ngulitur, që i ka sunduar pa ndonjë studim, apo diskutim. Edhe të burgosurit, me iluzionet e tyre shikojnë majtas e djathtas, por nuk gjejnë tjetër, veçse muret që i mbajnë të ngujuar dhe rrethanat e jetës së ngushtë që kanë jetuar, duke injoruar atë që ndodhet përtej atyre mureve".

"Njeriu i fortë duhet t'i lërë mënjane fjalët e njerëzve dhe me fuqitë e veta të çajë rrugën për te qëllimet e tij. Të vendosë në llogarinë e vet se, njerëzit i ka kundër, jo pro tij dhe se ata i ka pengesë e jo ndihmës. Dhe, në qoftë se merr ndonjë plagë, apo e prekë ndonjë lëngatë, atëherë le t'i fshehë dhimbjet e tij dhe të mos presë ndonjë mirësi nga publikimi i tyre të shqetësimeve të tij".

"Detyra e fesë është që kur të shikojë një të rrëzuar ta ndihmojë për t'u ngritur dhe jo të nxitojë për ta diskretituar".

“Është gabim të mendosh se dituria e lavdëruar quhet vetëm studimi i fikhut dhe i tefsirit dhe se ajo që ndodhet përtej tyre është nafile dhe mund ta kryejë kush të dëshirojë vullnetarisht, ose dhe mund mos ta realizojë... ky është një gabim i madh, sepse shkencat e universit dhe të jetës së kësaj bote, rezultatet e vazhdueshme kërkimore për mbretërinë e qiellit dhe të tokës nuk janë më pak të rëndësishme se sa shkencat e pastra fetare. Madje, ndoshta rezultatet e tyre kërkimore kanë lidhje në atë mënyrë që e bën të domosdoshme njohjen e tyre dhe më me vlerë se sa të thelluarit në shkencat e shariatit.

Për këtë na mjafton Kur’ani famëlartë, i cili na vë në dukje mirësinë e shkencës dhe madhështinë e shkencëtarëve, të cilët përqendrohen te dituria e lindur nga vëzhgimi i bimëve, kafshëve dhe dukurive të tjera natyrore. Allahu thotë në Kur’an: “A nuk e shikon që Allahu zbriti nga qielli ujë dhe më të nxorëm fruta me ngjyra të llojllojshme, si dhe prej maleve rrugë të bardha, shkëmbinj të kuq, të zinj shumë dhe me ngjyra të ndryshme, gjithashtu edhe prej njerëzve, krijesa të tjera dhe kafshë me ngjyra të ndryshme?! Me të vërtetë e kanë frikë Allahun, prej robërve të Tij, dijetarët. Allahu është i Madhërishëm, Falës.” (Fatir: 27-28), përsëri thotë: “Edhe në ndryshimin e gjuhëve dhe ngjyrave tuaja në këto ka argumente për shkencëtarët”. (Rum: 22)

Nga Libri: “Moral i Myslimanit”

“Kur shikon kasapin duke dhënë fetva, mos prit asgjë tjetër prej tij, pasi ai s’kërkon gjë tjetër, veçse kurban”.

“Myslimani kur i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk struket brenda kullës me mure të rrethuara, duke lundruar përmes iluzioneve të forta. Kulla e myslimanit është kjo Tokë, sa gjerë e gjatë, duke e mbushur atë me punë precize dhe detyra të kërkuara.

Nuk quhet precizon rregullimi i një pjese të detyrave dhe lënia pas dore e pjesëve të tjera, që ndoshta mund të jenë më të rëndësishme dhe më të larta. Rregullim quhet kryerja e farzeve ajne dhe kifaje (detyrave individuale dhe kolektive) dhe trajtimi i punëve të dynjasë dhe të ahiretit së bashku”.

“Myslimani është i detyruar të takojë të gjithë banorët e tokës me sjellje të mirë e të singertë, të cilët nuk i prek asnjë dyshim. Kështu që singëriteti, toleranca, besnikëria, zemërgjerësia, bashkëpunimi dhe bujaria janë detyrë e çdo myslimani ndaj myslimanit dhe jomyslimanit”.

Nga libri: “Morali i Myslimanit”

“Në qoftë se Islami gjen prej këtij populli të mirë zemra ku të strehohet dhe të zbatojnë mësimet e të realizojnë qëllimet e tij, atëherë prit një rilindje të suksesshme, të ardhme të ndritur dhe mirësi të mëdha,

jo vetëm për Egjiptin, jo vetëm për arabizmin, por për botën mbarë".

Nga libri: "Min huna na'lem"

"Në vendet tona, ka prej atyre të cilët flasin me gjuhë të mprehtë për mbrojtjen e lirisë së ateizmit, për alkoolin dhe për imoralitetin. Ndërkohë, në qoftë se do të flitej për lirinë e besimit, për nderin dhe për zgjuarsinë e të menduarit, ofendohen dhe revoltohen. Por, a nuk e sjellin dështimin dhe turpin, përveç se krijesa të tilla?"

"Ai njeri që ka lidhje të dobët me Kur'anin e madhëruar, që është i privuar nga udhëzimi dhe drita e tij, nuk duhet në asnjë mënyrë të merret me studimin e Sunetit dhe të nxjerri dispozita prej tij, sepse ai zor se mund të udhëzohet në urtësi, duke ditur se ai është i penguar nga burimi i parë i urtësisë, Kur'ani që është libri i Zotit xh.sh. Nuk kam për qëllim lidhjen e dobët, leximin e pakët të tij, por kam për qëllim dobësinë e kuptimit, mungesën e ndjenjave dhe mendjelehtësinë e kuptimit së strategjive të largëta të Librit të shenjtë"!

"Përsosja e besimtarit është thirrja më e goditur që fton njerëzit në besim dhe morali i tij i lartë është forca më magjike që tërheq zemrat e i bashkon ato rreth besimit".

"Zemra e lidhur me Allahun e lartëson njeriun mbi çdo gjë dhe atë nuk mund ta gjuhëzojë frika e as nuk mund ta poshtërojë epshi".

"Ne jemi të urdhëruar për singeritet ndaj fesë tonë, pa marrë parasysh se njerëzit mohojnë fetë e tyre, apo u besojnë.

Në qoftë se çdo njeri kapet për besimin (akiden) e tij, atëherë pse vetëm ne ngarkohemi për tu larguar nga Islami dhe për t'i braktisur mësimet dhe udhëzimet e tij?? Prandaj, një propagandë e tillë që del nga goja e një njeriu, nuk do të thotë se ai është vetëm renegat, por ai është agjent i ndytë, të cilin spiunazhet botërore e kanë ngarkuar për forca armiqësore kundra nesh, për të përhapur mikrobet e poshtërimit dhe të humbjes"!

(nga libri: Huhum daijetin)

“E VËRTETA E HIDHUR”

Lexuesi i sotëm zakonisht mjaftohet me pëlqimin e artikujve të shkurtër, krahas atyre të gjatë, apo shumë të gjatë.

Prandaj, këto janë disa fjalë të shkurtra, apo shkëndija të shpejta që përmbajnë çështje dhe dispozita, të cilat mund të jenë ndreqje të një gabimi të përhapur. Ringjallje të një të vërtete të braktisur, koment i një ngjarje historike, apo bashkëkohore, pohim i një ideje të vyer, ose nxitje të energjive drejt një qëllimi të ndershëm.

Nganjëherë trajtojnë tema të besimit, të moralit, të historisë dhe të fikhut (jurisprudencës) dhe nganjëherë zhyten në realitetin tonë të gjallë për t'i vënë në lëvizje punëtorët e rrugës së Allahut, për të vendosur të drejtën dhe për të shkatërruar të shtrembrën.



ÇMIMI: 400 LEKË